



# burgu dhe rrethinat e tij

manual për legjislacionin përkatës  
perditesuar me ligje ne fuqi ne mars te 2015



Regione Emilia-Romagna  
Assemblea legislativa

Garante delle persone  
sottoposte a misure restrittive  
o limitative della libertà personale

L'ASSEMBLEA  
dei DIRITTI 



**burgu**

**dhe**

**rrethinat e tij**

manual për legjislacionin përkatës  
perditesuar me ligje ne fuqi ne mars te 2015



## Hyrje

Ky libërth dëshiron të jetë një kontribut i vogël për ata që janë në burg, por edhe për ata që punojnë në burg, me qëllim që t'i ndihmojnë të burgosurit për kuptimin e ligjeve italiane e të rregullave që e dispijlojnë jetën brenda burgjeve.

Ndonjëherë koha e qëndrimit në burg mund të ulej, madje heqja e lirisë personale mund të përfundonte, në rast se do të kishte më shumë informacion për çka mund të bëhet brenda e jashtë burgut.

Personat në burg, aq më tepër të huajit, hasin vështirësi në kuptimin e realitetit që i rrethon, shpesh nuk arrijnë t'i ushtrojnë të drejtat e tyre të njohura me ligj. Nuk i njohin mundësitë për studim, formim, punë.

Heqja e lirisë personale nuk duhet të shoqërohet me humbjen e të drejtave të tjera, midis të cilave e drejta për t'u informuar.

Duhet pasur gjithmonë parasysh se trajtimi në burg duhet të jetë gjithnjë në përputhje me humanizmin e të sigurojë respektin e dinjitetit njerëzor, pa diskriminime në bazë të kombësisë, racës, gjinisë, kushteve ekonomike e shoqërore, opinioneve politike e fetare.

Burgu dhe rrethinat e tij mund të konsultohet në 6 gjuhë: italisht, shqip, arabisht, frëngjisht, anglisht, spanjisht.

Duke pasur parasysh reformat e rëndësishme, që janë bërë pas tashmë të famshmit "vendimi Torreggiani" më 8 janar 2013, u vijua me rishikimin e tekstit, që tani rezultoi i përditësuar me ligje në fuqi në mars të 2015.

Desi Bruno

*Garant i personave të cilëve u është hequr liria personale,  
Krahina Emilia-Romanja*



## Rregullat Europiane të Burgjeve

Miratuar nga Komiteti i Ministrave të 46 Shteteve europiane më 11 janar 2006

### Parimet bazë

1. Personat, të cilëve u është mohuar liria, duhet të trajtohen me respekt ndaj të drejtave të tyre njerëzore.
2. Personat të cilëve u është mohuar liria, gëzojnë të gjitha të drejtat që nuk u janë hequr në mënyrë të ligjshme me vendimet e dënimit të tyre ose si pasojë e paraburgimit.
3. Kufizimet për personat të cilëve u është mohuar liria ushtrohen në masën minimale të nevojshme dhe në përpjesëtim me objektivat e ligjshme për të cilat ato janë vendosur.
4. Kushtet në burg, që cenojnë të drejtat njerëzore të burgosurit nuk mund të justifikohen nga mungesa e burimeve.
5. Jeta në burg duhet të përafrohet sa më shumë të jetë e mundur me aspektet pozitive të jetës në shoqërinë e lirë.
6. Qëndrimi në burg duhet të menaxhohet në mënyrë që ta lehtësojë ri-integrimin në shoqërinë e lirë të personave të cilëve u është hequr liria.
7. Bashkëpunimi me shërbimet e jashtme sociale dhe aq sa është e mundur pjesëmarrja e shoqërisë civile në jetën e burgjeve duhen inkurajuar sa më shumë që të jetë e mundur.
8. Personeli i burgut zhvillon një mision të rëndësishëm të shërbimit publik dhe marrja në punë, trajnimi e kushtet e punës duhet t'i mundësojnë aplikimin e standardeve të larta në kujdesin ndaj të burgosurve.
9. Të gjitha strukturat e burgjeve duhet të jenë objekt i inspektimeve të rregullta nga ana e qeverisë, gjithashtu

nga ana e një autoriteti të pavarur.

## Kushtetuta e Republikës Italiane

Nenet kryesore të referimit

### Neni 2

Republika njeh dhe garanton të drejtat e padhunueshme të njeriut, qoftë si individ, qoftë në formacionet shoqërore ku zhvillohet personaliteti i tij, dhe kërkon përmbushjen e detyrave të domosdoshme të solidaritetit politik, ekonomik e shoqëror.

### Neni 3

Të gjithë qytetarët kanë dinjitet shoqëror të njëjtë dhe janë të barabartë përballë ligjit, pa dallim gjinie, race, gjuhe, feje, mendimi politik, kushtesh personale e shoqërore. Është detyrë e Republikës të heqë pengesat me karakter ekonomik e shoqëror, të cilat, duke e kufizuar në fakt lirinë dhe barazinë e qytetarëve, pengojnë zhvillimin e plotë të njeriut dhe pjesëmarrjen efektive të të gjithë punonjësve në organizimin politik, ekonomik e shoqëror të vendit.

### Neni 24

Të gjithë mund t'i drejtohen gjykatës për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

Mbrojtja është e drejtë e padhunueshme në çdo gjendje e shkallë të procedimit.

U sigurohen të varfërve, me vendime të posaçme, mjetet për të vepruar e për t'u mbrojtur përballë çdo juridiksioni. Ligji përcakton kushtet e mënyrat për ndreqjen e gabimeve gjyqësore.

#### Neni 25

Askujt nuk mund t'i ndryshohet gjykatësi i natyrshëm i paracaktuar me ligj.

Askush nuk mund të ndëshkohet përveçse në bazë të një ligji që të ketë hyrë në fuqi para veprës së kryer.

Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

#### Neni 26

Ekstradimi i qytetarit mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht nga konventat ndërkombëtare.

Nuk mund të aplikohet në asnjë rast për vepra penale politike.

#### Neni 27

Përgjegjësia penale është personale.

I pandehuri nuk konsiderohet fajtor deri në dënimin përfundimtar.

Dënimet nuk mund të jenë trajtime në kundërshtim me humanizmin dhe duhet të synojnë riedukimin e të dënuarit.

Nuk lejohet dënimi me vdekje.

#### Neni 111

Juridiksioni zbatohet nëpërmjet procesit të drejtë që rregullohet nga ligji.

Çdo proces zhvillohet në ballafaqim midis palëve, në kushte barazie, përpara një gjykatësi si palë e tretë dhe e paanshme. Ligji siguron kohëzgjatjen e arsyeshme.

Në procesin penal, ligji siguron që personi i akuzuar për një krim të jetë, në kohën më të shkurtër të mundshme, i informuar në mënyrë të rezervuar për natyrën dhe motivet e akuzës së ngritur në ngarkim të tij; të ketë në dispozicion



kohë e kushte të nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij; të ketë mundësinë përpara gjykatësit, që të pyesë vetë ose personat që bëjnë deklaratat për të; të arrijë thirrjen e marrjen në pyetje të personave në mbrojtje të tij, në të njëjtat kushte me ato të akuzës dhe marrjen e çdo lloj mjet prove tjetër në favor të tij; të jetë i asistuar nga një përkthyes, në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në proces.

Procesi penal rregullohet nga parimi i ballafaqimit në formimin e provës. Fajësia e të pandehurit nuk mund të provohet mbi bazën e deklaratave të bëra nga ai që, me dëshirën e tij, i është shmangur gjithmonë vullnetarisht marrjes në pyetje nga ana e të pandehurit ose të avokatit mbrojtës të tij.

Ligji rregullon rastet në të cilat formimi i provës nuk zhvillohet në ballafaqim me miratimin e të pandehurit ose për pamundësi të vërtetuar me natyrë objektive ose për efekt të sjelljes së paligjshme të provuar.

Të gjitha masat juridiksionale duhet të jenë të motivuara. Kundër vendimeve dhe kundër masave ndaj lirisë personale, që merren nga organet juridiksionale të zakonshme ose speciale, pranohet gjithmonë rekurs në Kasacion (Gjykata e Lartë) për shkelje të ligjit. Mund të bëhet përjashtim nga kjo normë vetëm për vendimet e Gjykatave ushtarake në kohë lufte.

Kundër vendimeve të Këshillit të Shtetit dhe të Gjykatës së llogarive, rekursi në Kasacion pranohet vetëm për motive që i takojnë juridiksionit.

## Konventa evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e të lirive themelore -

Firmosur në Romë më 4 nëntor 1950 – Nenet kryesore të referimit

### Neni 2 - E drejta për jetën

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, në rastet kur krimi ndëshkohet nga ligji me këtë dënim.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet e shkaktuar në kundërshtim me këtë nen kur ajo rezulton si pasojë e përdorimit të forcës që bëhet absolutisht e nevojshme:

- a. për të mbrojtur çdo person nga dhuna e paligjshme;
- b. për të kryer një arrest të ligjshëm ose për të ndaluar arratisjen e një personi që mbahet i burgosur ligjërisht;
- c. për të shtypur, në përputhje me ligjin, një trazire ose një kryengritjeje.

### Neni 3 - Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

### Neni 4 - Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose në robëri.

2. Askush nuk mund të shtrëngohet të kryejë punë me dhunë ose të detyruar.

3. Nuk konsiderohet "punë e kryer me dhunë ose e detyruar" në kuptimin e këtij neni:

- a. çdo punë që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë periudhës së lirimimit të tij me kusht;
- b. çdo shërbim i karakterit ushtarak ose, në rastin e

kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, çdo shërbim tjetër që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;  
c. çdo shërbim që kërkohet në rast krizash, ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e bashkësisë;  
d. çdo punë ose shërbim që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.

Neni 5 – E drejta për lirinë dhe sigurinë

1. Çdo person ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën ligjore:

- a. kur burgoset rregullisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
- b. kur arrestohet ose burgoset në mënyrë të rregullt për moszbatim të një urdhri të dhënë në përputhje me ligjin, nga një gjykatë, ose për të garantuar ekzekutimin e një detyrimi të parashkruar nga ligji;
- c. kur është arrestuar dhe burgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar që ai ka kryer një vepër penale, ose kur ka motive të bazuara për të menduar se është e nevojshme që t'i ndalohej që të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;
- d. kur është fjala për heqjen e rregullt të lirisë së një të mituri, e vendosur për mbikëqyrjen e edukimit të tij, ose për heqjen e rregullt të lirisë së tij me qëllim për ta çuar përpara autoritetit kompetent;
- e. kur është fjala për heqjen e rregullt të lirisë së një personi të dyshuar se mund të përhapë një sëmundje ngjitëse, të një të çmenduri, të një të alkoolizuari, të një toksikomani ose të një vagabondi;
- f. kur është fjala për arrestimin ose burgimin e rregullt të

një personi për të ndaluar hyrjen e tij të paligjshme në territor, ose të një personi kundër të cilit është në vijim një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit dhe për çdo akuzë të drejtuar kundër tij.

3. Çdo person i arrestuar ose i burgosur, në përputhje me kushtet e parashikuara në paragrafin 1(c) të këtij neni, duhet të çohet sa më shpejt që të jetë e mundur përpara një gjykatësi ose një magjistrati tjetër të autorizuar me ligj që të ushtrojë funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedurës. Lirimi mund të kushtëzohet me një garanci që të sigurojë paraqitjen e personit të interesuar përpara gjyqit.

4. Çdo person të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim ka të drejtë të paraqesë ankim përpara një gjykate, me qëllim që kjo të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirim nëse burgimi është i paligjshëm.

5. Çdo person, viktimë arrestimi ose burgimi në shkelje të njëres nga dispozitat e këtij neni, ka të drejtë për dëmshpërblim.

Neni 6 - E drejta për proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të shqyrtohet drejtësisht, publikisht e brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrat e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale drejtuar kundër tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në

sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë të gjithë procesit ose një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose të sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur e kërkojnë interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në gjyq, ose në masën e gjykuar rreptësisht e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti mund të dëmtojë interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Në veçanti, çdo i akuzuar ka të drejtë që:

- a. të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton e në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për arsyet e akuzës që bëhet kundër tij;
- b. t'i jepet kohë dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;
- c. të mbrohet vetë, ose të ketë ndihmën e një avokati mbrojtës të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se nuk i ka mjetet për ta shpërblyer mbrojtësin, të mund të ndihmohet falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- d. të marrë në pyetje, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të fitojë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve që e shfajësojnë në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- e. të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 7 - Nuk ka dënim pa ligj

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në çastin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës kombëtare ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më

i rëndë se ai i zbatueshëm në çastin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do ta pengojë gjykimin dhe dënimin e një personi fajtor për një veprim ose mosveprim që, në çastin kur është kryer, konsiderohej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara.

Neni 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij.

2. Nuk mund të ketë ndërhyrje nga autoriteti publik në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse kur kjo ndërhyrje parashikohet me ligj dhe kur përbën një masë që, në një shoqëri demokratike, është e nevojshme për sigurinë kombëtare, për sigurinë publike, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 9 - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë përfshin lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, si edhe lirinë për të shfaqur fenë e vet ose bindjet e veta individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë, ose të bindjeve të veta, nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të ndryshme nga ato që parashikohen me ligj e që përbëjnë masat e nevojshme,

në një shoqëri demokratike, për sigurinë publike, për mbrojtjen e rendit, të shëndetit ose të moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 10 - Liria e shprehjes

1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin një regjim autorizimesh për institucionet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit.

2. Ushtrimi i këtyre lirive, meqë përmban detyra e përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve që parashikohen me ligj dhe që përbëjnë masa të nevojshme, në një shoqëri demokratike, për sigurinë kombëtare, integritetin territorial ose sigurinë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informacioneve konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 11 - Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën e themelimit të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të veta.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të ndryshme nga ato që parashikohen me ligj e që përbëjnë masa të nevojshme, në një shoqëri demokratike, për sigurinë kombëtare, për sigurinë publike,

për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit publik e për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve. Ky nen nuk i ndalon kufizimet e ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave, të vendosura nga ana e pjesëtarëve të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

*Neni 12 - E drejta për martesë*

Burrat e gratë, që kanë mbushur moshën për t'u martuar, kanë të drejtë të martohen e të krijojnë familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.

*Neni 13 - E drejta për rekurs efektiv*

Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një rekurs efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

*Neni 14 - Ndalimi i diskriminimit*

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim, në veçanti ato që bazohen mbi seksin, racën, ngjyrën, gjuhën, fenë, opinionet politike ose të çdo lloji tjetër, origjinën kombëtare ose shoqërore, përkatësinë në një minoritet kombëtar, pasurinë, lindjen ose çdo situatë tjetër.

*Neni 17 - Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës*

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet sikur i jep një Shteti, një grupimi ose një individ, çfarëdo të drejte që të ndërmarrë një veprimtari ose të kryejë një akt që ka për qëllim zhdukjen e të drejtave ose të lirive të njohura në këtë Konventë, ose t'u



*vendosë këtyre të drejtave e këtyre lirive kufizime më të gjera se ato të parashikuara në Konventën në fjalë.*

#### SHËNIM

U mbajtën parasysh përditësimet e mëposhtme legjislative:

- Ligji datë 21 prill 2011, n. 62 "Ndryshime të kodit të procedurës penale e të ligjit 26 korrik 1975, n. 354, e dispozita të tjera në tutelë të marrëdhënies midis grave të burgosura e fëmijëve të mitur.
- Ligji datë 26 nëntor 2010, n. 199 "Dispozita për zbatimin pranë vendbanimit të dënimeve me burgim jo më shumë se 18 muaj" – siç është ndryshuar nga Dekreti Ligj, datë 22 dhjetor 2011, n. 211, i shndërruar, me ndryshime, në Ligj më 17 shkurt 2012, n. 9.
- Dekreti Legjislativ 7 shtator 2010, n. 161 "Dispozita për përshtatjen e së drejtës kombëtare me Vendimin kuadër 2008/909/GAI lidhur me zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve penale që japin dënime me burgim ose masa për heqje lirie personale, me qëllim përmbushjen e tyre në Bashkimin Europian".
- Dekret Ligji datë 23 qershor 2011, n. 89, i shndërruar, me ndryshime, në Ligj datë 2 gusht 2011, n. 129 që përmban dispozita urgjente për plotësimin e zbatimit të direktivës 2004/38/CE për qarkullimin e lirë të qytetarëve komunitarë e për përvetësimin e direktivës 2008/115/CE për riatdhesimin e qytetarëve të parregullt të vendeve të treta.
- Dekret Ligji datë 22 dhjetor 2011, n. 211, i shndërruar, me ndryshime, në Ligj më 17 shkurt 2012, n. 9.
- Ligji datë 1 tetor 2012, n. 172 – Ratifikimi dhe zbatimi i konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e të miturve kundër shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, kryer në Lanzarote më 25 tetor 2007, si dhe normat e përshtatjes së ligjeve të brendshme.
- DPR datë 5 qershor 2012, n. 136 që ndryshoi DPR 230/2000, në lëmin e kartës së të drejtave dhe detyrave të të burgosurit dhe të internuarit.

#### SHËNIM

Ky libërth është përditësuar me ligjet në fuqi deri në muajin Mars 2015. Ndryshimet në krahasim me botimin e parë, janë sinjalizuar në tekst me ngjyrën blu.

### Shkurtime

Në tekst do të përdoren shkurtime e mëposhtme:

- kp = kodi penal
- kpp = kodi i procedurës penale
- op = ligji datë 26 korrik 1975, n. 354 i ashtuquajtur ligji për burgjet



**MASAT KUFIZUESE TË LIRISË PERSONALE – TË DREJATAT E MBROJTJES –  
INFORMACIONE TË SHPEJTA PËR PROCESIN –  
REKURS NË GJYKATËN EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

- Arsyet e burgimit	23
- Seanca e miratimit (neni 391 kpp)	24
- Arrestimi pas urdhëresës për paraburgim	25
- Ndryshimet në tekstin uniq për lëndët narkotike (d.p.r. n°309/1990 - neni 73 paragrafi 5)	30
- Emërimi i avoikatis mbrojtës të besuar	32
- Patronazhi me shpenzimet e shtetit	33
- E drejta për përkthyes për të burgosurit e huaj	34
- Gjykata e rishqyrtimit	36
- Lirimi nga burgu – zgjedhja e vendbanimit	36
- Procesi	36
- Gjykimi i drejtpërdrejtë (neni 558 kpp)	37
- Gjykimet eposaçme të ashtuquajtura alternative	39
- Pezullimi i procedimit me vënien në provë	39
- Pezullimi i procedimit ndaj personave që nuk gjenden	42
- Puna me dobishmëri publike për toksikomanë	43
- Apeli	44
- Rekursi në kasacion (neni 606 e vijuese kpp)	44
- Rekursi në Gjykatën europiane të të drejtave të njeriut	45
- Delegim Qeverisë në lëmin e dënimeve me heqjen e lirisë jo me burg e të reformës së sistemit sanksionues	46
- Dispozita në lëmin e jo padënueshmërisë për lehtësi të vecante të së faktit	47

**FAZA EKZEKUTUESE – ARRESTI PAS URDHRIT PËR EKZEKUTIM – GJYKA TËSI I  
EKZEKUTIMIT**

- Arresti pas urdhrorit për ekzekutim ose për bugosje (neni 656 k.p.p.)	57
-------------------------------------------------------------------------	----

- Gjykatësi i ekzekutimit	60
- Falja	60
- Rivendosja në afat (neni 175 kpp)	61
- Ndreqja e burgimit të padrejtë (neni 314 kpp), rishikimi i vendimit (neni 629 kpp), ndreqja e gabimit gjyqësor	61
- Konventa e Strasburgut	62
- Dekreti legjislativ datë 7 shtator 2010, n. 161	62

## MASAT E SIGURISË DHE RREZIKSHMËRIA SHOQËRORE

- Liria e mbikëqyrur (neni 228 k.p.)	71
- Shtrimi në spitalin psikiatrik gjyqësor (neni 222 k.p.)	72
- Caktimi në një vend kurimi e ruajtjeje (neni 219 k.p.)	73

## GIYKATA E MBIKËQYRJES – PËRFITIMET E BURGUT

- Parimet themelore të trajtimit në burg	75
- Gjykatësi mbikëqyrës dhe gjykata e mbikëqyrjes	76
- Puna e jashtme (neni 21 o.p.)	77
- Lirimi i parakohshëm (neni 54 o.p. e neni 103 d.p.r. 230/2000)	78
- Gjysmëliria (neni 48 o.p., neni 50 o.p., neni 50 bis o.p. e neni 101 d.p.r. 230/2000)	79
- Qëndrimi në shtëpi (neni 47 ter o.p. e neni 100 d.p.r. 230/2000)	80
- Qëndrimi në shtëpi i posaçëm (neni 47 quinquies o.p.)	82
- Mënyra të veçanta kontrolli në ekzekutimin e qëndrimit në shtëpi (neni 58 quinquies o.p.)	83
- Asistenca e jashtme e fëmijëve të mitur (neni 21 bis o.p.)	84
- Vënia në provë tek shërbimet sociale në raste të veçanta (neni 94 d.p.r. 309/1990 e neni 99 d.p.r. 230/2000)	85
- Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për toksikomanët ose të alkoolizuarit (neni 90 e vijues d.p.r. 309/1990)	85
- Vënia në provë tek shërbimet sociale (neni 47 o.p. e nenet nga 96 tek 98 d.p.r. 230/2000)	86
- Pezullimi me kusht i dënimit e ashtuquajtur "falje e vogël" ("indultino" - ligji 207/03)	87
- Lirimi me kusht (neni 176 k.p. e neni 682 kpp)	87

- Dëbimi si masë alternative “jo tipike” e burgimit	88
- Lejet e shpërblimit (neni 30 ter o.p.)	90
- Dhënia e lejeve të shpërblimit përsëritësve (neni 30 quater o.p.)	91
- Leje për arsye të rënda familjare (neni 30 o.p.)	92

## **TË DREJTAT DHE DETYRAT E TË BURGOSURIT**

- Vizita mjekësore e viseda psikologjike	97
- Personeli i burgut	98
- Garanti i të drejtave të personave që u është hequr liria personale (territoriale)	102
- Istitucioni i Garantit kombëtar të të burgosurve	104
- Kërkesa me shkrim	105
- Transferimet (neni 42 o.p.)	105
- Shoqërimi në burg	106
- Bisedat e telefonatat	107
- Posta dhe sendet që lejohen për t’u mbajtur	109
- Blerja, gatimi i ushqimeve e përdorimi i furnelave	109
- Shkolla	110
- Formimi profesional	110
- Puna e brendshme	111
- Veprimtaritë zbatimëse ose sportive	112
- Shoqatat që veprojnë brenda burgut	112
- Qelia, higjiena e parandalimi	112
- E drejta e shëndetit në burg	113
- Ushqimi	114
- Shpenzimet e procesit gjyqësor e të qëndrimit në burg	115
- E drejta e votës	116
- Feja dhe praktikat e kultit (neni 26 o.p.)	117
- Rregullat e sjelljes	117
- Përdorimi i forcës fizike dhe i mjeteve shtrënguese (neni 41 o.p.)	120
- Masa disiplinore mbrojtëse (neni 78 d.p.r. 230/2000)	121
- Procedimi disiplinor (neni 81 d.p.r. 230/2000)	121
- E drejta e ankesës (neni 35 o.p.)	121
- Ankesa juridiksionale (neni 35 bis o.p.)	123
- Ankimi tek gjykatësi mbikëqyrës (neni 69 paragrafi 6 o.p.)	124

- Ndrejje dëmshpërblyese pas shkeljes së nenit 3 të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të lirive themeltare ndaj personave të burgosur ose të internuar (neni 35 ter o.p.) 126

## **TË BURGOSURIT E HUAJ**

- I burgosuri i huaj pa lejeqëndrim 129
- I burgosuri i huaj me lejeqëndrim 131
- Lejeqëndrim për arsye të drejtësisë 131

# MASAT KUFIZUESE TË LIRISË PERSONALE – TË DREJTATAT E MBROJTJES – INFORMACIONE TË SHPEJTA PËR PROCESIN – REKURS NË GJYKATËN EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

## Arsyet e burgimit

Arsyet e burgimit mund të jenë si më poshtë:

1. *Arrestimi në flagrancë të krimit*<sup>1</sup>: do të thotë se personi është kapur në aktin e kryerjes së veprës penale, ose është ndjekur nga forcat e rendit menjëherë pas veprës penale, ose është kapur me sende, ose gjurmë, që bëjnë të mendosh se porsa është kryer një vepër penale,

### SHËNIM

Në rastin kur procedohet me gjykim të drejtpërdrejtë personi dërgohet në burg me kusht që prokurori të ketë urdhëruar me dekret të motivuar që i ar-restuari të çohet në burg të vendit ku është bërë arrestimi (ose, në qoftë se dëmtohen rëndë hetimet, pranë një burgu tjetër të afërt) në rast mungese, padisponueshmërie ose papërshtatshmërie të strukturave të disponueshme për zyrtarët ose për agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer arrestimin ose që e kanë marrë në dorëzim të arrestuarin, ose nëse ka arsye të tjera specifike të nevojshme ose urgjente<sup>2</sup> (neni 558 paragrafi 4bis kpp).

2. *Ndalimi bëhet ngaqë ka prova të rënda se personi ka bërë vepër penale*<sup>3</sup>, do të thotë se forcat e rendit mendojnë se personi ka bërë një vepër e që, edhe lidhur me pamundësinë e identifikimit, ekziston rreziku që të largohet
3. *Arrestimi me urdhëresë të gjykatësit*, do të thotë se gjykatësi mendon se personi ka bërë vepër dhe se, duke ndenjur i lirë, i hetuari mund ta

<sup>1</sup> Teksti i nenit 380 kpp - Arrest i detyrueshëm në flagrancë dhe neni 381 kpp gjendet në shtojcën në fund të kapitullit 1

<sup>2</sup> D.L. datë 22 dhjetor 2011, n. 211, i shndërruar, me ndryshime, në L. 17 shkurt 2012, n. 9 ka futur paragrafët 4 bis e 4ter në nenin 558 kpp

<sup>3</sup> Teksti i nenit 384 kpp - ndalimi i të dyshuarit për një vepër penale gjendet në shtojcën në fund të kapitullit 1.



- përsërisë veprimin kriminal ose të ndotë provat ose të largohet
4. *Arrestimi për shlyerjen e dënimit përfundimtar të dënimit me burg*, do të thotë se vijonte në ngarkim të personit një procedim penal që është përmbyllur me dënim që është bërë përfundimtar.

## SHËNIM

D.L. 26/06/2014 n. 92 konvertuar në L. 11/08/2014 n. 117 e ka ndryshuar nenin 24 të dekretit legjislativ 28 korrik 1989, n. 272 duke parashikuar që paraburgimi, masat e posaçme, sanksionet zëvendësuese, dënimet me burg e masat e sigurisë bëhen sipas ligjeve e me mënyrat e parashikuara për të miturit edhe ndaj atyre që gjatë ekzekutimit e kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç por jo moshën njëzet vjeç, gjithmonë nëse, për ata që kanë mbushur prej kohësh moshën njëzet e një vjeçare, nuk ka arsye të veçanta sigurie të vlerësuar nga gjykatësi kompetent, duke pasur parasysh gjithashtu synimet riedukuese.

## Seanca e miratimit (neni 391 kpp)

Maksimumi brenda 96 orëve nga arresti ose nga ndalimi caktohet seanca e miratimit ku personi pyetet nga gjykatësi i hetimeve paraprake (G.I.P.) me praninë e detyrueshme të avokatit.

Pas marrjes në pyetje e pasi dëgjohen prokurori (që mund edhe të mos paraqitet) dhe avokati mbrojtës, gjykatësi si veprim të parë vendos nëse arrestimi ose ndalimi janë kryer sipas ligjit, në rast pozitiv miraton arrestin ose ndalimin, në rast negativ nuk e miraton.

Në këtë pikë, nëse gjykatësi e ka miratuar arrestin ose ndalimin, magjistrati që bën hetimet (prokurori) mund t'i kërkojë gjykatësit vetë që personi të mbahet në burg ose të lirohet eventualisht me disa kufizime.

Kjo kërkesë bazohet mbi mundësinë e gjykuar për ekzistencën e rrezikut që vetë personi, në pritje të procesit, të mund:

- a) të ndotë provat;
- b) të largohet;
- c) të kryejë vepra të tjera

Në dritën e kësaj kërkesë të formuluar nga prokurori e pasi dëgjohen vërejtjet e kërkesat e mbrojtësit, gjykatësi vendos ta mbajë personin në burg (i ashtuquajtur paraburgim) ose ta zbusë paraburgimin (arrest në shtëpi) ose ta lirojë me

kufizime eventuale (detyrimi për paraqitje tek policia gjyqësore për të firmosur, detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar, ndalimi i daljes jashtë shtetit). Përkundrazi duhet urdhëruar lirimi i menjëhershëm i të arrestuarit ose i të ndaluarit:

- a) në qoftë se arresti ose ndalimi kanë ndodhur jashtë rasteve të lejuara me ligj;
- b) në qoftë se nuk janë respektuar afatet për kryerjen e seancës së miratimit;
- c) në qoftë se gjykatësi mendon se në ngarkim të personit nuk ka prova të rënda fajësie.

Në të njëjtën mënyrë, pas miratimit të arrestit, personi nuk mund të mbahet në burg në qoftë se mund të përfitojë nga pezullimi me kusht i dënimit (d.m.th. nëse gjykatësi mendon se nuk do të dënohet më shumë se dy vjet e se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tjera penale).

Gjithashtu, nuk mund të mbahet në burg, përveç rasteve të jashtëzakonshme kur kërkohet tutela e komunitetit:

- a) gruaja shtatzënë ose nëna që bashkëjeton me fëmijët e vet me moshë nën tre vjeç;
- b) personi me moshë mbi shtatëdhjetë vjeç;
- c) personi me patologji të tillë që e bën gjendjen shëndetësore të papajftueshme me burgimin ose personi me sëmundje Aids të shpallur;
- d) babai me fëmijë nën tre vjeç e nëna të ketë vdekur ose gjithsesi në pamundësi për t'i ndihmuar.

Në rast se G.I.P. (Gjykatësi për Hetimet Paraprake), pasi e ka miratuar arrestin/ndalimin, vendos që personi të mbesë në burg, nxjerr urdhëresë për paraburgim, dhe brenda 10 ditësh nga njoftimi mund të bëhet rekurs tek gjykata e rishqyrtimit, me përbërje kolegjiale prej 3 gjykatësish, duke kërkuar rishqyrtimin, edhe për brendinë, të urdhëresës që vendos masën shtrënguese (neni 309 kpp). Në qoftë se vendimi për kërkesën për rishqyrtim nuk vjen brenda 10 ditëve nga çasti kur autoriteti gjyqësor procedues ia ka transmetuar Gjykatës aktet përkatëse, urdhëresa që vendos masën shtrënguese e humbet efektshmërinë e vet.

## SHËNIM

D.L. 23/12/2013 n. 146 i konvertuar në L. 21/2/2014 n. 94 n. 10 e ka ndryshuar nenin 275bis të Kpp duke parashikuar se, gjatë zbatimit të masës së arrestit në shtëpi, edhe si zëvendësim të masave parandaluese në paraburgim, gjykatësi, me përjashtim kur i konsideron të panevojshme, në lidhje me natyrën e shkallën e kërkesave parandaluese që duhen plotësuar në rastin konkret, urdhëron procedura kontrolli nëpërmjet mjeteve elektronike ose mjete të tjera

teknike, pasi ka kontrolluar disponueshmërinë nga ana e policisë gjyqësore. Dispozita ka të bëjë me aplikimin e të ashtuquajturit “byzlyk elektronik”, d.m.th. një procedurë kontrolli nëpërmjet mjeteve elektronike që gjykatësi vendos në rast se jepet arresti në shtëpi përveçse kur, pasi vlerëson kërkesat parandaluese që duhen plotësuar në rastin konkret, e përjashton këtë nevojë. Përdorimi i byzlykut elektronik varet nga disponueshmëria e vërtetuar e policisë gjyqësore.

Me të njëjtin vendim gjykatësi parashikon zbatimin e masës parandaluese në burg nëse i pandehuri e mohon pranimin e adoptimit të mjeteve e të instrumenteve të lartpërmendur.

## Arrestimi pas urdhëresës për paraburgim

Edhe në këtë rast vlejnë gjërat e thëna më sipër lidhur me ndihmën mbrojtëse nëpërmjet një avokati të besuar ose, në mungesë, të një avokati të caktuar zyrtarisht.

Ligji parashikon që të caktohet marrja në pyetje (e ashtuquajtura pyetja e garancisë) brenda pesë ditëve nga arresti, në rast të kundërt, d.m.th. nëse shkelet ky afat, personi duhet liruar.

Personit i dorëzohet kopje e masës me të cilën gjykatësi ka vendosur arrestin (urdhëresën e paraburgimit).

Tek ajo tregohen të dhënat e mëposhtme:

- 1) gjykatësi që e ka vendosur;
- 2) numrat e procedimit;
- 3) të dhënat e personit të arrestuar;
- 4) faktet që përbëjnë objekt hetimor;
- 5) provat në ngarkim të personit e burimet përkatëse;
- 6) arsyet për të cilat gjykatësi e ka konsideruar të nevojshme masën shtrënguese me burg;
- 7) urdhrin e gjykatësit me datë e firmë;

Gjatë pyetjes së garancisë e në praninë e nevojshme të një avokati, personi mund të shpjegojë mbrojtjen e vet ose, ashtu siç ndodh gjatë pyetjes në seancën e miratimit, mund të vendosë të mos përgjigjet.

Pyetja në fjalë synon të vërtetojë nëse ekzistojnë ende kushtet që çuan në arrest.

Gjykatësi mund edhe të vendosë që personi të lirohet, të vihet në arrest në shtëpi, ose të lirohet me disa kufizime.

Në çdo rast procedimi penal vazhdon të ndjekë rrugën e vet dhe, në përfundim të hetimeve, në qoftë se prokurori mendon se ka marrë elementë të mjaftueshëm

për të mbështetur akuzën në gjykim, kërkon që personi të gjykohet. Edhe në rastin e një lirimi të mundshëm ka rëndësi që personi t'i mbajë lidhjet me avokatin e vet.

Dekreti Legjislativ datë 28 korrik 1989, n. 271 që përmban normat e zbatimit, të koordinimit e normat e përkohshme të kodit të procedurës penale në kapitullin VII lidhur me dispozitat për paraburgimin, tek neni 94 – hyrja në burgje – përcakton që nëpunësi shtetëror që punon në burg nuk mund të marrë e të mbajë asnjë person pa vendimin e autoritetit gjyqësor, ose një njoftimi për dorëzim nga ana e oficerit të policisë gjyqësore.

Paragrafi 1bis parashikon që kopja e vendimit që përbën motivin e paraburgimit të futet në dosjen personale të të burgosurit dhe që drejtori ose operatori i burgut i caktuar prej tij të sigurohet, në rast nevojë, me ndihmën e një përkthyesi, që i interesuari ta njohë saktësisht vendimin për burgim dhe, kur është e nevojshme, ia ilustron përmbajtjen.

## SHËNIM

D.L. 26/06/2014 n. 92 i konvertuar në L. 11/08/2014 n. 117 e zëvendësoi paragrafin 2-bis të nenit 275 të kodit të procedurës penale, në këtë drejtim, duke parashikuar se nuk mund të zbatohet masa parandaluese me burg ose ajo e arrestit në shtëpi nëse gjykatësi mendon se me vendimin mund të jepet pezullimi me kusht i dënimit.

Me përjashtim të sa parashikohet nga paragrafi 3 e duke pasur parasysh zbatimin e neneve 276, paragrafi 1-ter (parashikimi i revokimit të arrestit në shtëpi në rast shkeljeje të urdhrave për ndalimin e largimit nga banesa e vet ose nga një vendbanim tjetër privat me zëvendësimin me masën parandaluese në burg), e 280, paragrafi 3 (masa parandaluese në burg mund të jepet vetëm për vepra penale, të kryera ose në tentativë, për të cilat parashikohet dënimi me burg jo më pak në maksimumin e vet se 5 vjet e për veprën penale të financimit të paligjshëm të partive sipas nenit 7 të L. 02/05/1974, n. 195, ndryshimet vijuese, por kjo dispozitë nuk aplikohet ndaj atyre që kanë shkelur urdhrat lidhur me një masë parandaluese), nuk mund të zbatohet masa e paraburgimit nëse gjykatësi mendon se, në fund të gjykimit, dënimi me burg i dhënë nuk do të jetë më i gjatë se tre vjet.

Kjo dispozitë nuk zbatohet në procedimet për veprat penale sipas neneve 423-bis (zjarri në pyll), 572 (keqtrajtime kundër familjarëve dhe bashkëjetuesve), 612-bis (akte persekutuese) e 624-bis (vjedhja në banesë e vjedhja me thyerje) e kodit penal, si dhe në nenin 4-bis të ligjit 26 korrik 1975, n. 354, e ndryshimet e mëpasshme, e kur, pasi verifikohet papërshtatshmëria e çdo mase tjetër, arresti në shtëpi nuk mund të bëhet për shkak të mungesës së një prej vendeve të ekzekutimit të treguara në nenin 284, paragrafi 1 (banesa e

vet ose vendbanim tjetër privat ose një vend kurimi publik ose asistence, ose atje ku është realizuar, një shtëpi familje e mbrojtur).

Paragrafi 3 i nenit 275 të kodit të procedurës penale parashikon që paraburgimi (masa parandaluese me burg) mund të jepet vetëm kur çdo masë tjetër rezulton e papërshtatshme .

Kur ekzistojnë prova të rënda për fajësinë në lidhje me veprat penale sipas nenit 51, paragrafët 3-bis e 3-quater, si dhe në lidhje me veprat penale sipas neneve 575 (vrasje), 600-bis (prostitucion i të miturve), paragrafi i parë, 600-ter (pornografi e të miturve), përjashtuar paragrafi i katërt, e 600-quinquies (nisma turistike me synimin e shfrytëzimit të prostitucionit të të miturve) të kodit penal, zbatohet paraburgimi, përveç rasteve kur ka elemente nga të cilat rezulton se nuk ekzistojnë kërkesa parandaluese. Dispozitat sipas fjalisë së mësipërme zbatohen edhe në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 609-bis (dhunë seksuale), 609-quater (akte seksuale me të mitur) e 609-octies (dhunë seksuale në grup) të kodit penal, me përjashtim kur ka rrethana lehtësuese që merren parasysh po nga ato.

Kujtojmë se kanë ndërhyrë disa vendime të Gjykatës Kushtetuese (për të cilat do të flitet më pas) që kanë deklaruar paligjshmërinë kushtetuese të nenit 275 paragrafi 3 k.p.p., në pjesën ku, duke ekzistuar kërkesat parandaluese, parashikonte karakterin detyrues të paraburgimit në rastin e disa veprave penale shprehimisht të shënuara (neni 416 bis k.p., neni 630 k.p., neni 609 octies k.p., neni 600 bis paragrafi 1, neni 609 bis, 609 quater k.p., neni 575 k.p., neni 74 D.P.R. n°309/1990, etj...).

Lista e veprave penale, të kryera ose në tentativë, të parashikuara nga paragrafët 3-bis e 3-quater të nenit 51 k.p.p. rezultojnë të jenë këto:

- » neni 416 bis, paragrafi 2, i kodit penal (organizata të llojit mafioz edhe të huaja, duke iu referuar atyre që nxisin, drejtojnë ose organizojnë);
- » neni 416 kp (organizatat kriminale) i krijuar me qëllim që të kryhen veprat penale të parashikuara nga nenet 473 kp (imitime, ndryshime, ose përdorimi i shenjave dalluese të veprave të mendjes ose të produkteve industriale); 474 kp (futja në shtet dhe tregtia e produkteve me shenja false); 600 kp (shndërrimi ose mbajtja në skllavëri); 601 kp (tregti njerëzish); 602 kp (blerja dhe shitja e skllavëve); 416bis kp (organizata të llojit mafioz edhe të huaja); 630 kp (Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim fitimi);
- » veprat penale të bëra duke përfituar nga kushtet e parashikuara nga neni 416bs kp d.m.th. me qëllim lehtësimin e aktivitetit të organizatave të parashikuara nga n njëjti artikull;

- » veprat penale, të kryera ose në tentativë, të parashikuara nga neni 74 i DPR 309/1990 T.U. lëndë narkotike (organizata për trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike ose psikotrope);
- » neni 291 quater i DPR 43/1973 (organizatë kriminale për kontrabandë duhani të përpunuar jashtë shtetit);
- » neni 260 D.L. 152/2006 (aktivitete të organizuara për trafikun e paligjshëm të mbeturinave);
- » vepra penale, të konsumuara ose në tentativë, me qëllime terrorizmi.

## SHËNIM

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë deklaruar karakterin e paligjshëm të nenit 275, paragrafi 3, i kodit të procedurës penale, siç është ndryshuar nga neni 2 paragrafi 1 i D.L. 23 shkurt 2009, n. 11 i shndërruar në L. 23 prill 2009, n. 38, në pjesën ku nuk e përjashton, gjithashtu, hipotezën ku janë marrë elemente specifike, në lidhje me rastin konkret, nga të cilat të rezultojë që kërkesat parandaluese mund të plotësohen me masa të tjera:

- » duke parashikuar se, kur ka prova të rënda fajësie në lidhje me vepra penale të kryera duke përfituar nga kushtet e parashikuara nga neni 416-bis (organizata të llojit mafioz edhe të huaja) të kodit penal ose me qëllim lehtësimin e aktivitetit të organizatave të parashikuara nga i njëjti nen zbatohet masa e paraburgimit, përveç rasteve kur janë marrë elemente nga të cilat rezulton se nuk ekzistojnë kërkesa parandaluese (Gjykata Kushtetuese, vendimi n. 57 i 29 marsit 2013);
- » duke parashikuar se, kur ekzistojnë prova të rënda fajësie në lidhje me veprën penale sipas nenit 416 (organizata kriminale) të kodit penal, krijuar me qëllim kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 473 e 474 të kodit penal, zbatohet masa e paraburgimit, përveç rasteve kur janë marrë elemente nga të cilat rezulton se nuk ekzistojnë kërkesa parandaluese (Gjykata Kushtetuese, vendimi n. 110 i 3 majit 2012);
- » duke parashikuar se, kur ekzistojnë prova të rënda fajësie në lidhje me veprën penale sipas nenit 630 të kodit penal, zbatohet masa e paraburgimit, përveç rasteve kur janë marrë elemente nga të cilat rezulton se nuk ekzistojnë kërkesa parandaluese (Gjykata Kushtetuese, vendimi n. 213 i 18 korrikut 2013);
- » duke parashikuar se, kur ekzistojnë prova të rënda fajësie në lidhje me veprën penale sipas nenit 609-octies të kodit penal, zbatohet masa e paraburgimit, përveç rasteve kur janë marrë elemente nga të cilat rezulton se nuk ekzistojnë kërkesa parandaluese (Gjykata Kushtetuese, vendimi n. 232 i 23 korrikut 2013);
- » duke parashikuar se, kur ekzistojnë prova të rënda fajësie në lidhje me veprën penale sipas neneve 600-bis (prostitution i të miturve), paragrafi i

- parë, 609-bis (dhunë seksuale), 609-quater (akte seksuale me të mitur) të kodit penal, zbatohet masa e paraburgimit, përveç rasteve kur janë marrë elemente nga të cilat rezulton se nuk ekzistojnë kërkesa parandaluese (Gjykata Kushtetuese, vendimi n. 265 i 21 korrikut 2010);
- » duke parashikuar se, kur ekzistojnë prova të rënda fajësie në lidhje me veprën penale sipas nenit 575 (vrasje) të kodit penal, zbatohet masa e paraburgimit, përveç rasteve kur janë marrë elemente nga të cilat rezulton se nuk ekzistojnë kërkesa parandaluese (Gjykata Kushtetuese, vendimi n. 164 i 12 majit 2011);
  - » duke parashikuar se, kur ekzistojnë prova të rënda fajësie në lidhje me veprën penale sipas nenit 74 (organizata me qëllim trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope) të D.P.R. 9 tetor 1990, n. 309 (Teksti unik i ligjeve në lëmin e disiplinës së lëndëve narkotike e psikotrope, parandalimit, kurimit e rehabilitimit të gjendjeve përkatëse të toksikomanisë) zbatohet masa e paraburgimit, përveç rasteve kur janë marrë elemente nga të cilat rezulton se nuk ekzistojnë kërkesa parandaluese (Gjykata Kushtetuese, vendimi n. 231 i 22 korrikut 2011).

## **Ndryshime në tekstin unik për lëndët narkotike (d.p.r. 309/1990 - neni 75 paragrafi 5)**

D.L. 23/12/2013 n. 146 i konvertuar në L. 21/2/2014 n. 94 n. 10 e ndryshoi fillimisht – të cilit siç do të shihet do t'i bëhen ndryshime të mëtejshme nga D.L. 36/2014 konvertuar në L. 79/2014 - nenin 73 paragrafi 5 të D.P.R. 309/90, d.m.th. hipotezën e dhënies së lëndëve narkotike (e sjelljet e tjera të përshkruara në nenin 73, oferta, shitja, kultivimi etj.) që, për modalitetet dhe rrethanat e veprimit ose për cilësinë apo sasinë e lëndëve narkotike, konsiderohet me entitet të lehtë (në këto raste nuk ka detyrim për arrest në flagrancë nga ana e policisë gjyqësore): në veçanti ndryshohet trajtimi sanksionues në drejtim më të favorshëm, duke e ulur maksimumin e ligjit nga 6 vjet në 5 vjet, ndërsa mbetet i caktuar në një vit minimumi i dënimit (me gjobë të pandryshuar nga euro 3.000 në euro 26.000). Por mbi të gjitha hipoteza e lehtësuar bëhet titull autonom vepre penale, i hequr nga gjykimi i krahasimit me rrethana të tjera veçanërisht rënduese, që mund të sillte rreptësi më të madhe të trajtimit sanksionues. Konfigurimi i hipotezës së lehtësuar si titull autonom redukton edhe afatet e parashkrimit.

Ndryshimi duhet të shërbejë, në arsyetimin e ligjvënësit, për reduktimin e mbipopullimit në burg, duke iu referuar në veçanti sjelljeve të shitjes së vogël të bëra nga marrës të lëndëve narkotike, edhe pse kufiri i dënimit të ligjit lejon ende zbatimin e masës së paraburgimit.

## SHËNIM

Gjatë rrugës së konvertimit të dekretit n. 146/2013 Gjykata Kushtetuese (vendimi n. 32/2014) ka deklaruar karakterin e paligjshëm kushtetues të nenit 73 T.U. lëndë narkotike siç është ndryshuar nga ligji Fini-Giovanardi (D.L. n. 272/2005 konvertuar në Ligjin 49/2006) si teprim delegimi sipas nenit 77 Kusht., duke rivendosur disiplinën e parashikuar nga Ligji 162/90 (i ashtuquajtur i Jervolino-Vassalli) e si rrjedhim dallimin midis drogave të lehta e të rënda, si dhe trajtimin e mëparshëm sanksionues, me probleme delikate të së drejtës ndërkohore.

Me D.L. 36/2014 konv. L. 79/2014 u bë edhe një herë ndryshimi i paragrafit të pestë të nenit 73 T.U. lëndëve narkotike, suke përcaktuar se, përveçse kur fakti përbën vepër të rëndë penale, kushdo që kryen një nga faktet e parashikuara nga neni 73 që, për mjetet, modalitetin ose rrethanat e veprimit ose për cilësinë e sasinë e lëndëve, është me entitet të lehtë, dënohet me dënim me burgim nga gjashtë muaj në katër vjet dhe me gjobë nga euro 1.032 në euro 10.329.

Ligjvënësi ka rivënë në këtë mënyrë kuadrin e vjetër ligjor të parashikuar për faktet me entitet të lehtë që kanë si objekt drogat e ashtuquajtura 'të lehta' nga teksti origjinal i T.U. (i ashtuquajtur i Jervolino-Vassalli), duke ia shtrirë ndër të tjera edhe fakteve korresponduese që kanë si objekt drogat 'e rënda', për të cilat t.u. fillestar parashikonte përkundrazi dënimin me burg nga një deri në gjashtë vjet.

Kështu në këto raste është bërë e pazbatueshme, sipas nenit 280 par. 2 k.p.p., masa e paraburgimit për faktet sipas paragrafit 5.

Kufiri i ri maksimal ligjor prej katër vjetësh burg do t'ua hapë mundësinë të pandehurve për faktet sipas paragrafit të pestë që të kërkojnë të pranohen në institutin e ri të pezullimit të procedimit me vënienë në provë sipas neneve të reja 168-bis e të mëpasshme të k.p., të futura nga ligji n. 67/2014.

Me referim të ripërcaktimit të dënimeve të dhëna për vepra penale që lidhen me lëndët narkotike në bazë të normës së deklaruar e paligjshme nga pikëpamja kushtetuese, orientimi i Seksioneve të bashkuara të Gjykatës së Kasacionit është në drejtimin e pranimit, për ata që janë dënuar – me vendim të paapelueshëm – në bazë të zbatimit të normave të abroguara, rimodelimi dhe rikuantifikimi i dënimit të vuajtur, duke ia njohur të dënuarit përfundimtar, të drejtën potestative që të kërkojë rimodelimin e një trajtimi sanksionues, themeluar mbi një dënim, që po e ritheksojmë, është deklaruar i paligjshëm.

## SHËNIM

Rezulton i ndryshuar edhe neni 19 par. 5 në lëmin e procesit të të miturve (DPR 448/1988), në kuptimin që për caktimin e dënimit për zbatimin e masave



parandaluese duhet të mbahet parasysh rrethana ulëse e moshës, përveç veprave penale sipas nenit 73 par. 5 T.U. lëndë narkotike, me qëllim që të ruhet mundësia e zbatimit të masave parandaluese.

Parashikimi i ri duket me karakter të dyshimtë kushtetues, duke krijuar një situatë jo të favorshme në bazë të titullit të pastër të veprës penale, që sidoqoftë dënon fakte me entitet të lehtë.

## Emërimi i avoktit mbrojtës të besuar

Çdo person i arrestuar, i ndaluar, i kapur pas urdhrit për zbatimin e dënimit ose nga një urdhëresë për paraburgim mund të emërojë një avokat mbrojtës të besuar, si në çastin e arrestit ashtu edhe gjatë mbajtjes në burg. Çdo i burgosur mund të emërojë deri në dy avokatë të besuar. Në Itali nuk ekziston mundësia për t'u mbrojtur vetë, e si rrjedhim, deri në emërimin e avoktit, personi ndihmohet nga avokati i caktuar zyrtarisht që shteti duhet të emërojë në mënyrë të detyrueshme.

Emërimi i avoktit mbrojtës të besuar kërkon heqjen e menjëhershme të avoktit të caktuar zyrtarisht. I burgosuri ka të drejtë të flasë menjëherë me avokatin e vet, përveç rasteve kur autoriteti gjyqësor vendos në çastin e arrestimit për një ndalim të përkohshëm jo më shumë se 5 ditë. Si avokati i caktuar zyrtarisht, ashtu edhe ai i besuar duhet të paguhet, përveç rasteve kur personi i burgosur pranohet nën patronazhin falas, me shpenzimet e shtetit, në qoftë se ka gjendje të vështirë ekonomike.

Në çastin e arrestimit në flagrancë të krimit, ose të ndalimit, ngaqë ka prova se ka kryer vepër penale, ose të zbatimit të një urdhërese për paraburgim, i kërkohet menjëherë personit të cilit i hiqet liria që të tregojë një avokat të besuar, në mungesë caktohet zyrtarisht një avokat, emri dhe adresa e të cilit mund të gjenden në aktet që dorëzohen.

### SHËNIM

Kujtojmë se mund të emërohet një avokat i besuar në çdo moment e kjo shkakton humbjen e menjëhershme të së drejtës për avokatin e caktuar zyrtarisht.

Neni 25 i DPR 230/2000 parashikon që pranë çdo burgu të mbahet regjistri i avokatëve të rrethit, që duhet afishuar në mënyrë që të burgosurit e të internuarit të mund ta konsultojnë.

U ndalohej operatorëve të burgut që të influencojnë, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, mbi zgjedhjen e avoktit.

## Patronazhi me shpenzimet e shtetit

Është e drejta që mundëson ndihmën e avokatit dhe të konsulentit teknik, pa paguar shpenzimet për mbrojtjen e për konsulencën. Pranohet në procesin penal, civil, administrativ, kontabël, tatimor e të juridiksionit vullnetar. Pranimi në patronazhin falas vlen për çdo gradë e fazë të procesit.

Mund të pranohet në patronazhin me shpenzimet e shtetit ai që konsiderohet i varfër në çastin e paraqitjes së kërkesës, në rast se kjo gjendje vijon për të gjithë kohën e procesit.

Nëse i interesuari jeton vetëm, shumën e të ardhurave të tij nuk duhet të kalojë shumën 11.369,24 euro (caku i të ardhurave përditësohet çdo dy vjet). Merren parasysh të gjitha të ardhurat e llogaritura për tatimet për të ardhurat e personave fizike (Irpéf) të fituara në vitin e fundit, si rroga e punës së varur (i punësuar), pensioni, të ardhurat nga puna e pavarur (vetëpunësimi), etj.

Gjithashtu, merren parasysh të ardhurat të përjashtuara nga Irpéf (p.sh.: Pensioni i luftës, kompensimi i shoqërimit, etj.), ose që i nënshtrohen ndalesës që në fillim në trajtën e tatimit ose të tatimit zëvendësues.

Nëse i interesuari jeton me familjen, të ardhurat e tij mbledhen me ato të bashkëshortes e të familjarëve të tjerë bashkëjetues. Në të kundërt, merren parasysh vetëm të ardhurat e të interesuarit, në qoftë se ai është në proces kundër familjarëve.

Në gjykimin penal kufiri i të ardhurave rritet me shumën 1032,91 euro për çdo familjar bashkëjetues.

Në proceset penale mund të asistohen qytetarët italianë ose qytetarët e huaj, edhe të mitur, ose apolidë me vendbanim në Itali.

Nuk mund të pranohet në patronazhin me shpenzimet e shtetit, në gjykimet penale ai që rezulton i hetuar, i pandehur ose i dënuar për vepra evazioni fiskal e që mbrohet nga më shumë se një avokat.

Kërkesën për të marrë patronazhin falas mund ta bëjë vetëm i interesuari, përndryshe kërkesa nuk pranohet dhe firma duhet vërtetuar nga funksionari që merr kërkesën ose nga një nëpunës tjetër shtetëror.

Kërkesën mund ta paraqesë i interesuari, ose avokati i tij, edhe me postë rekomandë, para se të fillojë procesi gjyqësor ose gjatë procesit vetë, por efektet fillojnë nga paraqitja e kërkesës, që përcillet nëpërmjet drejtorisë së burgut.

### SHËNIM

Për kërkuesin e burgosur ose të internuar në një burg në gjendje arresti ose qëndrimi në shtëpi ose në qoftë se ruhet në një vend kurimi zbatohet neni 123

kpp<sup>4</sup> (kodi i procedurës penale). Drejtori ose oficeri i policisë gjyqësore, që kanë marrë kërkesën e paraqesin, ose e dërgojnë, me postë rekomandë, në adresë të zyrës së gjykatësit nga i cili varet procedimi.

#### SHËNIM.

Për të burgosurit e huaj është e nevojshme kopja e një dokumenti të identitetit dhe vërtetimi i autoritetit konsullor për të ardhurat që fitohen jashtë shtetit. Në mungesë të përgjigjes së autoritetit konsullor mjafton vetëcertifikimi.

## E drejta për përkthyes për të burgosurit e huaj

I burgosuri që nuk e njeh gjuhën italiane ka të drejtë të ndihmohet falas nga një përkthyes, me qëllim që të kuptojë akuzën që bëhet kundër tij e të ndjekë përmesurjen e akteve në të cilat merr pjesë.

Në të njëjtën mënyrë, ai që nuk e kupton gjuhën italiane ka të drejtën e përkthimit të akteve të procedimit në gjuhën që njeh ose, në mungesë, në anglisht, frëngjisht e spanjisht, e gjithë kjo për të garantuar ushtrimin e plotë të së drejtës së mbrojtjes.

Për këtë pikë, më 2010 ka dalë një Direktivë e Parlamentit europian dhe e Këshillit (direktiva 2010/64/UE) për të drejtën e interpretimit (përkthimit me gojë) dhe përkthimit në procedimet penale.

Kjo Direktivë (duke risjellë parimin e njohjes së ndërsjellë të vendimeve në lëmin penal, neni 6 CEDU e neni 47 i Kartës së të drejtave themelore të Bashkimit europian) merret me të drejtën e interpretimit në të gjitha implikimet e saj: nga asistenca e nevojshme që nga akti i parë i procesit, duke kaluar nga parashikimi i përkthimit të të gjitha akteve të konsideruara themelore për garantimin e së drejtës së mbrojtjes, deri tek detyrimi i shteteve anëtare që të ofrojnë rrugëdalje në rastet e kundërshtimit për cilësinë e interpretimit (përkthimit me gojë) nëse nuk konsiderohet e mjaftueshme për mbrojtjen e paanësisë së procedimit.

Shteti italian e ka zbatuar këtë Direktivë me Dekretin Legjislativ të 4 marsit 2014, n. 32.

Ndryshohet kështu neni 104 k.p.p. në lëmin e bisedave të avokatit me të pandehurin që është në masë parandaluese e neni 143 k.p.p., tani shënuar

---

<sup>4</sup> Teksti i nenit 123 kpp deklaratat e kërkesa të personave të burgosur ose të internuar gjendet në shtojcën në fund të kapitullit 1

“e drejta për përkthimin gojor dhe për përkthimin e akteve themelore”.

Para së gjithash përcaktohet e drejta për asistencën falas e një përkthyesi për të pandehurin në masë parandaluese, i arrestuari dhe i ndaluari që nuk e njohin gjuhën italiane, me qëllim që të flasin me avokatin mbrojtës.

Përveç kësaj, i pandehuri ka të drejtë për asistencën falas të një përkthyesi me qëllim që të kuptojë akuzën kundër tij të formuluar e që të ndjekë kryerjen e akteve dhe zhvillimin e seancave ku merr pjesë.

Gjithashtu sanksionohet edhe një e drejtë specifike për përkthimin me shkrim të akteve themelore të procedimit penal (informacioni i garancisë, informacioni për të drejtën e mbrojtjes, vendime që vënë masa parandaluese personale, njoftimi për mbylljen e hetimeve paraprake, dekretet që vendosin seancën paraprake dhe thirrjen për gjykim, vendimet e dekretet penale të dënimit), brenda një afati të mjaftueshëm që të lejojë ushtrimin e të drejtave dhe të mundësisë së mbrojtjes.

Përkthimi falas i akteve të tjera ose edhe vetëm i një pjese të tyre, që konsiderohen thelbësore për ta mundësuar të pandehurin që të njohë akuzat ndaj tij, mund të vendoset nga gjykatësi, edhe me kërkesë të një pale, me akt të motivuar, e kundërshtueshme së bashku me vendimin.

D.Lgs. n°32/2014 nuk parashikon sanksione të veçanta procesuale për mosrespektimin e këtyre dispozitave.

Megjithatë, është mendim i përhapur, edhe në jurisprudencë, që në këto raste mund të konfigurohet pa vlerë sipas nenit 178 paragrafi 1 shkronja c) k.p.p., e bashkërenditur pra me shkeljen e dispozitave që kanë të bëjnë me asistencën dhe ndërhyrjen e të pandehurit.

## SHËNIM

Siç u kujtua më parë, paragrafi 1 bis i nenit 94 të D.L.v 28 korrik 1989, n. 271 që përmban normat e zbatimit, të koordinimit e normat e përkohshme të kodit të procedurës penale në kapitullin VII lidhur me dispozitatat për paraburgimin, parashikon që kopja e vendimit që përbën motivin e paraburgimit të futet në dosjen personale të të burgosurit dhe që drejtori ose operatori i burgut i caktuar prej tij të sigurohet, në rast nevojë, me ndihmën e një përkthyesi, që i interesuari ta njohë saktësisht vendimin për burgim dhe, kur është e nevojshme, ia ilustron përmbajtjen.

## Gjykata e rishqyrtimit

Kundrejt urdhëresës së paraburgimit të nxjerrë nga Gip ose masës së miratimit të arrestit ose ndalimit pranohet rekursi brenda 10 ditëve nga komunikimi tek një Gjykatë e përbërë nga tre gjykatës (Gjykata e lirisë).

Kjo Gjykatë rishqyrton aktet në bazë të cilave është adoptuar masa kufizuese e lirisë personale dhe vlerëson nëse ekzistojnë kushtet që personi të rrijë në burg ose të lirohet nga burgu (neni 309 kpp).

Në Gjykatën e lirisë mund të bëhet apel edhe për masat e gjykatësit që hedhin poshtë kërkesa eventuale për revokimin ose zëvendësimin e burgimit të formulara nga i burgosuri (neni 310 kpp).

## Lirimi nga burgu – zgjedhja e vendbanimit

Në çastin kur personi lirohet nga burgu, personi ftohet që të bëjë të ashtuquajturën zgjedhje të vendbanimit, domethënë të tregojë vendin ku dëshiron që t'i dorëzohen dokumentet që kanë lidhje me procesin.

Pas zgjedhjes së vendbanimit të gjitha aktet e procesit do të dërgohen në adresën e treguar dhe është e rëndësishme që pranë kësaj adrese të jetë efektivisht personi për të cilin bëhet fjalë ose, në alternativë, dikush që gjithsesi mund t'i marrë aktet.

Meqë të gjitha aktet do të dërgohen pranë kësaj adrese mund të ndodhë që, në rast se oficerët gjyqësorë nuk gjejnë njeri, procesi të zhvillohet pa dijeninë efektive të personit e megjithatë procesi do të jetë gjithsesi i rregullt.

Është e mundur, e në disa raste e preferueshme, që personi të zgjedhë që t'i marrë aktet e procesit vetëm pranë avokatit të tij (e ashtuquajtura zgjedhja e vendbanimit pranë avokatit), por në këtë rast duhet që personi t'i mbajë kontaktet me avokatin e tij.

## Procesi

Në fund të hetimeve, në qoftë se prokurori do t'i quajë të mjaftueshme elementet për mbështetjen e akuzën në gjykim, do të kërkojë që të zhvillohet procesi. Për disa tipologji veprash, zhvillohet fillimisht një seancë (seanca paraprake) përballë gjykatësit për seancën paraprake.

Qëllimi i seancës paraprake është të vërtetojë, nëpërmjet ballafaqimit mes

palëve (prokurori e avokati), nëse ka elemente të mjaftueshme për një proces në gjykatë. Është vendi ku i pandehuri duhet të bëjë, nëse dëshiron, kërkesë për kompromis (patteggiamento) për dënimin, ose kërkesë për gjykim të shkurtuar, duke zgjedhur në këtë mënyrë që ta përcaktojë procedimin po në seancën paraprake.

Në rast se gjykatësi për seancën paraprake (GUP) i konsideron të mjaftueshme për një proces elementet e paraqitura nga akuza, nxjerr një dekret që vendos gjykimin duke treguar datën, orën e Gjykatën ku do të zhvillohet procesi, në të kundërt do të marrë vendim (vendimi për mosvazhdimin e procedimit) për përfundimin e procedimit.

Për vepra të tjera nuk zhvillohet seanca paraprake dhe personi thirret drejtpërdrejt përballë gjykatësit me dekret të thirrjes për gjykim. Edhe në këtë rast, para se të fillojë procesi personi me ndihmën e mbrojtësit të tij mund të vendosë që të gjykohet me formën e zakonshme ose të zgjedhë gjykimin e shkurtuar ose kompromisin.

Mund të ndodhë që të kapërcehet faza e seancës paraprake, sepse personit i dorëzohet vendimi për gjykim të menjëhershëm. Kur prokurori e gjykatësi e konsiderojnë të dukshme provën e fajësisë, nëpërmjet këtij mjeti shmangin seancën paraprake dhe e thërrasin personin drejtpërdrejt në gjykatë.

Pas dorëzimit të vendimit për gjykim të menjëhershëm ka shumë rëndësi që të kontaktohet menjëherë avokati mbrojtës, sepse kërkesa për forma të tjera eventuale të ndryshme që japin të drejtën e uljes së dënimit duhet bërë detyrimisht **brenda 15 ditëve nga dorëzimi i vendimit për gjykimin e menjëhershëm**. Edhe pse kjo kërkesë mund të bëhet personalisht nga i interesuari është më mirë gjithnjë që të konsultohet avokati mbrojtës.

## Gjykimi i drejtpërdrejtë (neni 558 k.p.p.)

Në rastet e arrestit në flagrancë, prokurori mund të kërkojë zhvillimin e procesit të drejtpërdrejtë, i arrestuari çohet drejtpërdrejt përballë gjykatësit të ballafaqimit për miratimin e arrestit dhe gjykimin e njëkohshëm brenda 48 orëve. Seanca e miratimit në këtë rast në gjykatë (në vend që të bëhet përballë gjykatësit për hetimet paraprake). Në rast miratimi të arrestit, procesi bëhet menjëherë më pas. Avokati mund të kërkojë një afat për përgatitjen e mbrojtjes kështu procesi shtyhet për disa ditë.

Është e mundur të zgjidhet një formë alternative e procesit (gjykim i shkurtuar

ose "kompromisi") që në rast dënimi japin të drejtën e uljes së periudhës së dënimit.

Kur gjykatësi nuk e zhvillon seancën, policia gjyqësore që ka bërë arrestin ose e ka marrë në dorëzim të arrestuarin, e njofton menjëherë atë dhe e paraqet në seancën që gjykatësi cakton brenda 48 orëve nga arresti.

Në këto raste (paragrafi 4bis) prokurori vendos që i arrestuari të ruhet në një nga vendet e treguara në paragrafin 1 të nenit 284 kpp (në banesën e vet ose vendbanim tjetër privat, ose në vend publik kurimi ose asistence, ose në rast se ka, në një shtëpi familje të mbrojtur).

Në rast mungese, jo disponueshmërie ose papërshtatshmërie të këtyre vendeve, ose kur ato gjenden jashtë rrethit ku është kryer arresti, ose në rast rrezikshmërie të të arrestuarit, prokurori vendos që të ruhet në struktura të përshtatshme, që janë në dispozicion të oficerëve, ose të agjentëve të policisë gjyqësore, që kanë bërë arrestin, ose që kanë pasur në dorëzim të arrestuarin.

Në rast mungese, jo disponueshmërie ose papërshtatshmërie të këtyre strukturave, ose në qoftë se ka arsye të tjera specifike nevojshmërie, ose urgjence, prokurori merr vendim të motivuar që i arrestuari të dërgohet në burgun e vendit ku është kryer arresti (ose, në qoftë se mund të dëmtohen rëndë hetimet, në një burg tjetër të afërt).

Në rastet e parashikuara nga neni 380 kpp (arrest i detyrueshëm në flagrancë) paragrafi 2, shkronja e bis) dhe f), domethënë për veprat penale të parashikuara nga neni 624bis kp – vjedhje në banesë e vjedhje me marrje, përveç rasteve kur ka rrethana lehtësuese sipas nenit 62 kp, paragrafi i parë numri 4)<sup>5</sup>, e për veprat e parashikuara nga neni 628 kp (vjedhje me dhunë) e nga neni 629 kp (Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë), prokurori vendos që i arrestuari të mbahet në struktura të përshtatshme që janë në dispozicion të oficerëve të policisë gjyqësore që kanë kryer arrestin ose që kanë pasur në dorëzim të arrestuarin. Njëlloj siç u tha më sipër, në rast mungese, jo disponueshmërie ose papërshtatshmërie të këtyre strukturave, ose në qoftë se ka arsye të tjera specifike nevojshmërie ose urgjence, prokurori merr vendim të motivuar që i arrestuari të dërgohet në burgun e vendit ku është kryer arresti (ose, në qoftë se mund të dëmtohen rëndë hetimet, në një burg tjetër të afërt).

---

<sup>5</sup> Rrethana lehtësuese sipas nenit 62 kp, paragrafi i parë numri 4) është kur, në vepra kundër pronës (pasurisë) ose që gjithsesi e prekin pronën, personit të prekur nga vepra i shkaktohet një dëm prone shumë e vogël, ose në veprat e bëra për arsye përfitimi, fakti që është vepruar për arritjen e përfitimit ose arritja gjithsesi e një përfitimi shumë të vogël, edhe kur ngjarja dëmtuese ose e rrezikshme është shumë e lehtë.

## Gjykimet eposaçme të ashtuquajtura alternative

Me qëllim që të përshpejtojë kohën e procesit legjislatori, siç përmendej më lart, ka futur në fillim e më pas ka nxitur përdorimin e gjykimeve të posaçme (në veçanti për atë që na intereson këtu të procesit të shkurtuar e “kompromisin”). Personi i hetuar ose i pandehur drejtpërdrejt ose mbrojtësi, i pajisur kur duhet me prokurë të posaçme, mund të zgjedhin, brenda një afati të prerë (p.sh. në seancën paraprake kur parashikohet zhvillimi i saj ose para hapjes së gjyqit), të përdorin këtë formë të ndryshme të procesit gjyqësor.

Gjykimi i shkurtuar, në qoftë se kërkohet në kohë nga i pandehuri, nuk mund të refuzohet nga gjykatësi, e çon automatikisht në rast dënimi në ulje prej 1/3 të dënimit të dhënë.

Me formën e shkurtuar nuk zhvillohet faza gjyqësore dhe procesi vendoset nga gjykatësi “sipas gjendjes së akteve”, ose në bazë të akteve të pranishme në dosjen e prokurorit, por nuk përjashtohet mundësia e dhënies së pafajësisë dhe vendimi eventual i dënimit mund të apeloher.

I ashtuquajtura kompromis (patteggiamento), (zbatimi i dënimit sipas kërkesës siç e përcakton kodi) qëndron në një formë marrëveshje midis palëve (prokurori e mbrojtja) për vlerësimin e faktit dhe sasinë e dënimit për t’i dhënë, edhe ai sjell ulje deri në 1/3 e dënimit të dhënë e, ndryshe nga gjyqi i shkurtuar, pamundësi për apelim, por vetëm rekurs eventual në kasacion. Në rastin e kompromisit gjykatësit i kërkohet që të bëjë vetëm një shqyrtim të vlerësimit të saktë të faktit të kryer nga palët e për përshtatshmërinë e dënimit për të cilin është rënë dakord, pa asnjë përthellim të mëtejshëm të përmbajtjes e gjithësesi duke ia rezervuar vetes mundësinë që ta refuzojë marrëveshjen në rast se nuk e konsideron korrekt vlerësimin juridik e të përshtatshëm dënimin vetë.

## Pezullimi i procedimit me vënie në provë

Ligji n. 67 i 28 prillit 2014 fut, midis të tjerash, mundësinë edhe për të rriturit që të kërkojnë pezullimin e procedimit me vënie në provë.

Kështu futen nenet 168 bis, ter e quater të kodit penal, si edhe një kapitull të ri V bis në Librin VI të k.p.p. (kushtuar “procedimeve të posaçme”) e një paragraf të ri X bis në Kapitullin I të normave të zbatimit, koordinuese e transitorë të k.p.p.

I pandehuri mund të kërkojë pezullimin e procesit me vënie në provë:

» Në procedimet për vepra penale të dënuara vetëm me dënimin ligjor në



- parà;
- » Në procedimet për vepra penale të dënuara me dënim ligjor me burg jo më shumë se 4 vjet në maksimum (i vetëm, i përbashkët ose alternativ ndaj dënimit me parà);
- » Për veprat penale të shënuara nga paragrafi 2 i nenit 550 k.p.p. (dhunë ose kërcënim ndaj një nëpunësi shtetëror, rezistencë ndaj një nëpunësi shtetëror; vjedhje e rënduar; fshehje gjërash të vjedhura; ...).

Vënia në provë nënkupton zhvillimin e një programi trajtimi të përpunuar në bashkëpunim me Zyrën e zbatimit penal të jashtëm që parashikon përcaktimin e një sërë elementesh, midis të cilave:

- 1) Rregullat e sjelljes për banesën, lirinë e lëvizjes, raportet me shërbimin social, ...;
- 2) Angazhimet e posaçme që i pandehuri merr për të eliminuar ose lehtësuar pasojat e dëmshme ose të rrezikshme të veprës penale, si edhe – nëse është e mundur – dëmshpërblimin e dëmit. Përveç kësaj përcaktohen sjelljet që synojnë nxitjen, gjithnjë nëse është e mundur, e ndërmjetësimit me personin e prekur (duke shfrytëzuar për këtë qëllim qendrat ose strukturat publike ose private të pranishme në territor);
- 3) Përgatitjen e një pune më dobishmëri publike, ose të një shërbimi pa pagesë (me kohëgjatësi jo më të shkurtër se dhjetë ditë) në favor të kolektivitetit, për t’u bërë pranë shtetit, krahinave, provincave, komunave, ndërmarrjeve shëndetësore ose pranë enteve ose organizatave, edhe ndërkombëtare, që veprojnë në Itali, të asistencës sociale, shëndetësore e vullnetare.
- 4) Modalitetet e përfshirjes jo vetëm të të pandehurit, por edhe të bërthamës së tij familjare e të mjedisit të tij të jetës në procesin e reintegrimit social, nëse është e nevojshme dhe e mundur.

Kërkesa për pezullim të procesit me vënie në provë mund të bëhet që gjatë hetimeve paraprake e gjithsesi mund të propozohet deri në formulimin e konkluzioneve sipas neneve 421 e 422 K.p.p. (ose në çastet e tjera të caktuara, në rast se procedohet me një rit të posaçëm) e vendoset nga gjykatësi me urdhëresë, në qoftë se nuk duhet të shpallë vendim për pushimin e çështjes penale sipas nenit 129 k.p.p.

Pezullimi i procedimit me vënie në provë vendoset kur gjykatësi, në bazë të parametrave sipas nenit 133 të k.p., e konsideron të duhur programin e trajtimit të prezantuar e mendon se i pandehuri nuk do të kryejë më vepra të tjera penale (duke vlerësuar edhe përshtatshmërinë e banesës për të siguruar kërkesat e mbrojtjes së personit të prekur).

Pezullimi i procedimit me vënie në provë nuk zbatohet në rastet kur vepra

penale ka karakter të përsëritur e profesional, si dhe kur ka tendencë për të bërë krime (nenet 102, 103, 104, 105 e 108 k.p.).

Në urdhëresën që vendos pezullimin e procedimit me vënie në provë, gjykatësi përcakton afatin brenda të cilit urdhrat dhe detyrimet e përcaktuara duhet të përmbushen. Megjithatë, procedimi nuk mund të pezullohet për një periudhë:

- » Më të gjatë se 2 vjet, kur procedohet për vepra penale për të cilat parashikohet një dënim me burg (i vetëm, i përbashkët ose alternative ndaj dënimit me gjobë);
- » Më të gjatë se 1 vit, kur procedohet për vepra penale për të cilat parashikohet vetëm dënimi me gjobë.

Gjatë periudhës së pezullimit të procedimit me vënie në provë ecuria e parashkrimit të veprës penale pezullohet.

Kundër urdhëresës që vendos për instancën e vënies në provë mund të apelojnë në Kasacion i pandehuri dhe Prokurori, edhe me kërkesë të personit të prekur (cenuar).

Personi i prekur mund ta kundërshtojë në mënyrë autonome për njoftim të munguar të seancës ose sepse, edhe kur është paraqitur, nuk është dëgjuar.

Në rast refuzimi të kërkesës, kjo mund të ripropozohet në gjyq, para deklaratës së hapjes së debatit.

Pezullimi i procedimit me vënie në provë të të pandehurit nuk mund të bëhet më shumë se një herë.

Periudha e provës mund të përmbillet në dy mënyra:

- » Me përfundim pozitiv: shuhet vepra penale për të cilën procedohet (por kjo nuk paragjykon aplikimin e sanksioneve administrative aksesore, atje ku parashikohen me ligj).
- » Me përfundim negativ: gjykatësi vendos me urdhëresë që procesi të vijojë ecurinë e vet.

Pezullimi i procedimit me vënie në provë mund edhe të revokohet, me urdhëresë:

- » Në rast shkeljeje të përsëritur ose të rëndë të programit të trajtimit ose të urdhrave të detyruara, ose të refuzimit për kryerjen e shërbimit të punës me dobishmëri publike;
- » Në rast kryerje, gjatë periudhës së provës, të një vepre të re penale të bërë jo nga pakujdesia ose të një vepre penale me të njëjtën natyrë me atë për të cilën po procedohet.

Urdhëresa e revokimit mund të apelohet nëpërmjet Kasacionit për shkelje të ligjit. Kur revokimi bëhet përfundimtar, procedimi rimerr ecurinë e tij nga çasti

kur kishte mbetur pezull dhe ndërpritet zbatimi i urdhrave dhe detyrimeve të imponuara.

Në rast revokimi ose përfundimi negativ të vënies në provë, Prokurori – duke përcaktuar dënimin për të bërë – zbret një periudhë korresponduese me atë të provës së kryer.

Për qëllimin e zbritjes, 3 ditë prove janë baras me 1 ditë burg o arrest, ose me 250 euro gjobë.

## **Pezullimi i procedimit ndaj personave që nuk gjenden**

Ligji n. 67 i 28 prillit 2014 (e ligji i mëpashtëm n. 118/2014, që përmban disiplinën transitorë) fut, midis të tjerash, në k.p.p. disiplinën e re të "pezullimit të procedimit ndaj personave që nuk gjenden".

Para së gjithash, nga procesi penal eliminohet institucioni "në mungesë".

Dispozitat e reja nyjëtohen kryesisht mbi 3 hipoteza:

1) Njohja e sigurt e seancës së procesit (seanca paraprake ose seanca gjyqësore).

Në këtë rast, procesi zhvillohet në mungesë të të pandehurit.

2) Njohja e supozuar e seancës për njohjen e sigurtë të procedimit.

Në këtë rast, procesi zhvillohet në mungesë të të pandehurit, por urdhëresa që vendos procedimin në mungesë të të pandehurit revokohet edhe zyrtarisht nëse, para vendimit, i pandehuri paraqitet.

Pastaj parashikohen disa rregullime për të pandehurin që jep provën se mungesa i detyrohej mosnjohjes së pafajshme të zhvillimit të procesit.

Në të njëjtën mënyrë procedohet nëse i pandehuri tregon pamundësinë absolute për t'u prezantuar rastësisht, për forcë madhore ose pengesë tjetër legjitime prova e të cilit ka ardhur me vonesë pa fajin e tij.

3) Njohja e munguar e seancës dhe e procedimit.

Në këtë rast, gjykatësi vendos të bëjë një tentativë të parë për njoffimin personal të të pandehurit me anë të policisë gjyqësore.

Nëse kjo nuk rezulton e mundshme (e gjithnjë nëse nuk duhet të shpallet vendim për pushim të çështjes penale sipas nenit 129 k.p.p.), vendoset pezullimi i procesit për mungesë të të pandehurit. Gjatë pezullimit mund të merren prova që nuk mund të shtyhen.

Pasi kalon një vit (por edhe më parë, nëse ndjehet nevoja), gjykatësi vendos kërkime të reja për të pandehurin e kështu bën çdo kalim viti të mëpashtëm.

Në qoftë se kërkimet kanë përfundim pozitiv ose gjithsesi gjendet prova e sigurt se i pandehuri është në dijeni të procedimit të filluar ndaj tij, gjykatësi cakton një seancë të re duke filluar procesin.

Gjatë pezullimit të procedimit për shkak të mungesës së të pandehurit, ecuria e parashkrimit mbetet pezull (me afate të parashikuara nga neni 161 paragrafi 2 k.p.p.).

Personi i dënuar ose i nënshtruar ndaj masës së sigurisë me vendim të paapelueshëm, ndaj të cilit është proceduar në mungesë për gjatë gjithë procesit, mund të kërkojë anulimin e vendimit të gjyqit nëse provon se mungesa i detyrohej mosnjohjes së pafajshme të zhvillimit të procesit.

## **Puna me dobishmëri publike për personat toksikomanë**

Norma e referimit është neni 73 i T.U. lëndët toksike (D.P.R. n°309/1990), në paragrafët 5, 5 bis e 5 ter.

Kur veprat penale të "prodhimit, trafikimit e mbajtjes së paligjshme të lëndëve narkotike ose psikotrope" konsiderohen me "entitet të lehtë" për mjetet, modalitetin ose rrethanat e veprimit ose për cilësinë e sasinë e lëndëve dhe kryhen nga një person toksikoman ose nga marrës i lëndëve narkotike ose psikotrope, gjykatësi – me vendimin e dënimit ose të zbatimit të dënimit me kërkesë të palëve sipas nenit 444 të k.p.p. – me kërkesë të të pandehurit e pasi dëgjohet prokurori, atëherë kur nuk duhet të jepet benefiti i pezullimit me kusht i dënimit, mund të zbatohet, në vend të dënimeve me burg ose me gjobë, atë të punës me dobishmëri publike sipas nenit 54 të d.lgs. n° 274/2000, për një kohëgjatësi që korrespondon me atë të dënimit me burg të dhënë.

Në rast shkeljeje të detyrimeve që lidhen me zhvillimin e punës me dobishmëri publike, dhe duke u larguar nga çka parashikon neni i cituar 54 të d.lgs. n. 274/2000, me kërkesë të prokurorit ose me vendim zyrtar, gjykatësi që procedon, ose ai i ekzekutimit, me formalitetet sipas nenit 666 të k.p.p., duke pasur parasysh entitetin motiveve dhe të rrethanave të shkeljes, vendos revokimin e dënimit me vendosjen e atij të zëvendësuar.

Kundër kësaj mase të revokimit pranohet apelim nëpërmjet kasacionit, që nuk ka efekt pezullues.

Puna me dobishmëri publike mund ta zëvendësojë dënimin për jo më shumë se dy herë.

## SHËNIM

Për efekt të d.l. n°78/2013 e të ndryshimeve që i janë bërë gjatë konvertimit në ligjin n°94/2013, rregullat e përmendura zbatohen edhe në rast të një “vepre të ndryshme” nga ato të treguara, mjaft që të jetë bërë, vetëm një herë:

- » nga toksikoman ose marrës i zakonshëm (i rregullt) i lëndëve narkotike ose psikotrope e në lidhje me gjendjen e vet të vartësisë ose të marrjes së rregullt;
- » për të cilën gjykatësi jep një dënim jo më të gjatë se një vit burg;
- » përveç rasteve kur bëhet fjalë për vepra penale rreptësisht të treguara nga neni 407 paragrafi 2, shkronja a) i k.p.p. (shkatërrim, plaçkitje e masakër, luftë civile, organizatë e llojit mafioz, ...) ose për vepra penale kundër personit.

## Apeli

Vendimet e dënimit mund të kundërshtohen duke i paraqitur në afat arsyet e apelit kancelarisë së gjykatësit që ka dhënë vendimin, edhe nëpërmjet zyrës së amzës në burg.

Gjykatësi i apelit është Gjykata e Apelit.

Arsyet e kundërshtimit mund të kenë të bëjnë si me arsyet e dënimit, ashtu edhe me teprinë e dënimit ose mungesën e njohjes së rrethanave lehtësuese.

Në këtë fazë nuk ka mundësi që të bëhet një marrëveshje, duke rënë dakord me prokurorin e përgjithshëm për pranimin e një ose disa arsyeve të kundërshtimit, me heqjen dorë të arsyeve të tjera, e uljen pasuese të dënimit (kompromisi në apel) pas shfuqizimit të nenit 599 paragrafi 4 kpp për efekt të L. n. 125/2008.

## Rekursi në kasacion (neni 606 e vijuese kpp)

Rekursi në kasacion për të pandehurit parashikohet në rastet e dënimit të shkallës së dytë në disa raste të shkeljes së ligjit ose të defektit të dukshëm në motivimin e vendimit.

Gjykata e Kasacionit, që ka seli në Romë, është gjykimi i ligjshmërisë e nuk mund të merret me themelësinë e vendimit që kundërshtohet, por vetëm me karakterin e rregullt të tij.

Avokati mbrojtës që e propozon rekursin duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e posaçëm.

## Rekursi në Gjykatën europiane të të drejtave të njeriut

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës (1 dhjetor 2009) Bashkimi European merr pjesë në Konventën Europiane për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut e të lirive themelore.

Konventa europiane për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut e të lirive themelore ka krijuar një sistem tutele të të drejtave themelore me natyrë kryesisht gjyqësore të bazuar në Gjykatën europiane të të drejtave të njeriut (për të garantuar, midis të tjerave, ndalimin e torturës – neni 3 -; të drejtën për liri e siguri – neni 5 -; të drejtën për një proces të drejtë – neni 6 -).

Gjykata Europiane me seli në Strasburg, luan një rol ndihmës kundrejt shteteve anëtare që duhet të respektojnë e të tutelojnë të parët në mënyrë efektive të drejtat e liritë e njohura e të përmendura në Konventën me anë të mjeteve të së drejtës kombëtare.

Qytetarët e shteteve anëtare mund t'i drejtohen individualisht, nëse mendojnë se kanë qenë viktime të drejtpërdrejta të një ose të disa shkeljeve nga ana e një ose më shumë shteteve anëtare.

Është thelbësore që, para se t'i drejtohet Gjykatës, pala paditëse të ketë ndjekur të gjitha rrugët e brendshme të rekursit të parashikuara nga ligjet e shtetit që thirret në gjyq që mund ta kishin rregulluar situatën për të cilën është ankuar. Në rast të kundërt, është detyrë e tij të provojë se këto rrugë të rekursit kanë qenë të paefektshme.

**Pjesa e lënduar duhet ta ketë marrë prej kohësh vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, të Gjykatës së Apelit e të Kasacionit italian.**

**Ai që bën rekurs ka gjashtë muaj kohë për t'iu drejtuar Gjykatës nga çasti kur autoriteti më i lartë kombëtar (Gjykata e Kasacionit), ka nxjerrë vendimin për rastin e tij.**

Pasi ta afirmojë shkeljen e bërë ndaj një ose disa të drejtave të garantuara nga Konventa ose nga Protokollat e saj, Gjykata e Strasburgut mund ta dënojë shtetin përgjegjës me dëmshpërblim të dëmeve, me rivendosjen e situatës para shkeljes ose me përbushjen e drejtë nëse nuk është e mundur të hiqen pasojat e shkeljes.

## Delegim Qeverisë në lëmin e dënimeve me heqjen e lirisë jo me burg e të reformës së sistemit sanksionues

Ligji n°67 i 28 Prillit 2014 fut, midis të tjerash, disa parime e kritere drejtuese në lëmin e dënimeve me heqje lirie jo me burg e të reformës së sistemit sanksionues, të cilave qeverisë i takon t'u japë zbatim.

Për sa i përket dënimeve me heqje lirie jo me burg, para së gjithash parashikohet që dënimet kryesore janë burgimi i përjetshëm, burgimi, qëndrimi në shtëpi e arresti në shtëpi, gjoba.

Qëndrimi dhe arresti në shtëpi shlyhen pranë banesës së të dënuarit ose në tjetër vend publik ose privat kurimi, asistence e pritjeje, ("vendbanimi"), me kohëgjatësi të vazhdueshme ose për ditë të veçanta të javës ose me orare të caktuara.

Dispozita të veçanta parashikohen për:

- » Veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me arrest ose heqje lirie jo më të madhe se 3 vjet: në këtë rast, dënimi është ai i heqjes së lirisë në shtëpi ose në arrest shtëpie.
- » Veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me heqje lirie nga 3 deri 5 vjet: në këtë rast, gjykatësi, pasi mban parasysh kriteret e treguara nga neni 133 i k.p., mund të zbatojë heqjen e lirisë me qëndrim në shtëpi.

Në të dyja rastet:

- 1) Dispozitat e shqyrtuara nuk zbatohen në rastet kur veprat penale bëhen zakonisht, në mënyrë profesionale dhe me tendencë për të bërë krime (neni 102, 103, 105 e 108 k.p.).
- 2) Gjykatësi mund të urdhërojë përdorimin e modaliteteve të veçanta të kontrollit të parashikuara nga neni 275 bis k.p.p. (byzylyku elektronik).
- 3) Gjykatësi mund të zëvendësojë dënimet e caktuara me ato të heqjes së lirisë ose të arrestit në burg kur nuk rezulton i disponueshëm një vendbanim i përshtatshëm që të sigurojë ruajtjen e të dënuarit ose kur sjellja e të dënuarit, për shkeljen e urdhrave të imponuara ose për kryerjen e një tjetër vepre penale, rezulton e papajtueshme me vazhdimin e tyre, edhe në bazë të kërkesave të mbrojtjes së personit të prekur nga vepra penale.
- 4) Në rast largimi të paautorizuar nga vendet ku vazhdon ekzekutimi i dënimeve, realizohet vepra penale e arratisjes.
- 5) Pasi dëgjohen i pandehuri dhe prokurori, mund të zbatohet edhe sanksioni i punës me dobishmëri publike (ose një shërbim aktiviteti pa pagesë, jo më pak se 10 ditë, në favor të kolektivitetit për t'u zhvilluar pranë shtetit, Krahinave, Provincave, Komunave ose pranë enteve ose organizatave të

asistencës sociale e vullnetare).

Më tej, ligji i deleguar e përjashton dënueshmërinë për sjellje të sanksionuara me dënimin e vetëm me gjobë ose me dënime heqje lirie jo më të mëdha në maksimum se 5 vjet, kur rezulton lehtësia e veçantë e cenimit dhe karakteri jo i zakonshëm i sjelljes, pa paragjykim për ushtrimin e veprimit civil për dëmshpërblimin.

Ligji i deleguar përcaktonte një afat prej 8 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit për t'i dhënë zbatim delegimit.

Për sa i përket reformës së disiplinës sanksionuese, ligjvënësi ia beson qeverisë detyrën e depenalizimit të një sërë veprash penale të përmbajtura si në k.p. ashtu edhe në legjislacionin e posaçëm.

Në veçanti parashikohet transformimi në akte të paligjshme administrative të të gjitha veprave penale për të cilat parashikohet vetëm dënimi me gjobë, me përjashtim të disa sektorëve (ndërtimi e urbanistika; mjedisi, territori e peizazhi; ushqime e pije; shëndeti e siguria në vendet e punës; ...).

Depenalizimi ka të bëjë edhe me disa vepra penale të k.p. të dënuara me heqje lirie (midis të cilave për shembull vepra penale e akteve të turpshme), si dhe një vepër penale (si ai i klandestinitetit e parashikuar nga neni 10 bis i T.U. imigracioni) me impakt të fortë politik.

Përtej këtyre rasteve, ligjvënësi bën hipoteza dekriminalizimi (pra abrogimin në këtë rast penal pa transformimin kontekstual në akt të paligjshëm administrativ, si në rastin e sharjes (fyerjes).

Ligji parashikon një afat prej 18 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit për ta zbatuar delegimin.

## **Dispozita në lëmin e padënueshmërisë për lehtësi të veçante të faktit**

Në zbatim të delegimit në ligjin n°67/2014, më 18 mars 2015 është botuar në Gazetën Zyrtare (Gazzetta Ufficiale) Dekreti Legjislativ 16 mars 2015 n°28, që përmban "Dispozitat në lëmin e padënueshmërisë për shkak të lehtësisë së veçantë të faktit".

Dekreti ka hyrë në fuqi më 2 prill 2015, duke bërë ndryshime si në kodin penal ashtu edhe në atë të procedurës penale.

Futet një nen i ri 131 bis k.p., në bazë të të cilit:

» Në veprat penale për të cilat parashikohet heqja e lirisë jo më e madhe në



maksimum se 5 vjet, ose dënimi në parà, e vetme ose bashkë me dënimin e parathënë, dënueshmëria përjashtohet kur, për mënyrën e sjelljes e për vogëlsinë e dëmit ose të rrezikut, pasi vlerësohen sipas nenit 133, paragrafi i parë, prekja është me lehtësi të veçantë dhe sjellja rezulton e pazakontë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur ligji parashikon lehtësinë e veçantë të dëmit ose të rrezikut si rrethanë lehtësuese.

- » Prekja (cenimi) nuk mund të konsiderohet me lehtësi të veçantë në rastet e mëposhtme: kur autori ka vepruar për motive të ulëta ose të kota, ose me egërsi, edhe në dëm të kafshëve, ose ka përdorur tortura ose, akoma më shumë, ka përfituar nga gjendja e mbrojtjes së reduktuar të viktimës, edhe duke iu referuar moshës të saj ose kur sjellja ka shkaktuar ose kanë rrjedhur prej saj, si pasoja pa dashje, vdekja ose lëndime shumë të rënda të një personi.
- » Sjellja duhet të konsiderohet “e zakonshme” në rastin kur autori është deklaruar kriminel i zakonshëm, profesionist ose me tendencë pra që të ketë kryer disa vepra penale me të njëjtën natyrë, edhe pse secili fakt, i konsideruar veçanërisht, është me lehtësi të veçantë, gjithashtu në rastin kur bëhet fjalë për vepra penale që kanë si objekt sjellje të shumëfishta, të zakonshme e të përsëritura.
- » Për përcaktimin e “dënimet me heqje lirie jo më shumë se 5 vjet”, nuk merren parasysh rrethanat, me përjashtim të atyre për të cilat ligji përcakton një dënim të llojit tjetër nga ai zakonshëm dhe nga ato me efekt të posaçëm. Në rastin e fundit, për zbatimin e paragrafit të parë nuk merret parasysh gjykimi i balancimit të rrethanave sipas nenit 69.

Nga pikëpamja e procesit, futen rregullat e mëposhtme:

- » Kur, për shkak të lehtësisë së veçantë të faktit, kërkohet arkivimi, prokurori duhet ta njoftojë për këtë gjë personin që i nënshtrohet hetimeve dhe personit të prekur.  
Në njoftim duhet të saktësohet se në një afat prej 10 ditësh, mund të konsultohen aktet dhe të paraqitet kundërshtimi ku të tregohen, me rrezik papranueshmërinë, arsyet e mospëlqimit kundrejt kërkesës për arkivim.
- » Vendimi penal i parëvokueshëm për pezullim të çështjes për shkak të lehtësisë së veçantë të faktit, ka efektshmërinë e vendimit të gjyqit për sa i përket verifikimit të ekzistencës së faktit, të paligjshmërisë së saj penale dhe të pohimit se i pandehuri e ka kryer, në gjykimin civil ose administrativ për kthimin dhe dëmshpërblimin e nxitur ndaj të dënuarit dhe përgjegjësit civil që është cituar ose ka ndërhyrë në procesin penal.

## Shtojca kapitulli 1

### Arresti i detyruar në flagrancë neni 380 kpp

*Oficerët ose agjentët e policisë gjyqësore procedojnë me arrestin e cilitdo që kapet në flagrancë me një vepër të bërë jo me pakujdesi, e kryer ose e mbetur në tentativë, për të cilën ligji cakton dënimin me burg të përjetshëm ose me burgim jo më pak në minimum se pesë vjet e në maksimum me njëzet vjet.*

*2. Edhe jashtë rasteve të parashikuara nga paragrafi 1, oficerët e agjentët e policisë gjyqësore procedojnë me arrestin e cilitdo që kapet në flagrancë të një nga veprat e mëposhtme të bërë jo me pakujdesi, të kryera ose të mbetura në tentativë:*

*a) vepra kundër autoritetit të shtetit të parashikuara në kapitullin I të librit II të kodit penal për të cilat jepet dënimi me burg jo më pak në minimum se pesë vjet ose në maksimum me dhjetë vjet;*

*b) vepra e shkatërrimit ose e plaçkitjes e parashikuar nga neni 419 i kodit penal;*

*c) vepra kundër pacenueshmërisë publike të parashikuara në kapitullin VI të librit II të kodit penal për të cilat jepet dënimi me burg jo më pak në minimum se tre vjet ose në maksimum me dhjetë vjet;*

*d) vepra e skllavërimit e parashikuar nga neni 600, vepra e prostitucionit me të mitur parashikuar nga neni 600-bis, paragrafi i parë, vepra e pornografisë me të mitur parashikuar nga neni 600-ter, paragrafi i parë e i dytë, edhe nëse e lidhur me material pornografik sipas nenit 600-quater.1, e vepra e nismave turistike me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit me të mitur parashikuar nga neni 600-quinquies i kodit penal;*

d-bis) vepra e marrëdhënies seksuale me dhunë e parashikuar nga neni 609-bis, përjashtuar rasti i paragrafit të tretë, dhe vepra e marrëdhënies seksuale me dhunë në grup parashikuar nga neni 609-octies i kodit penal;

e) vepra e vjedhjes, kur ka rrethana rënduese të parashikuara nga neni 4 i ligjit datë 8 gusht 1977, n. 533 të parashikuara nga neni 625, paragrafi i parë, numri 2), rasti i parë, i kodit penal, përveç rasteve kur, në këtë rastin e fundit, verifikohen rrethanat lehtësuese sipas nenit 62, paragrafi i parë, numri 4), i kodit penal;

e-bis) vepra të vjedhjes të parashikuara nga neni 624-bis i kodit penal, përveç rasteve kur verifikohen rrethanat lehtësuese sipas nenit 62, paragrafi i parë, numri 4), i kodit penal;

f) vepra e vjedhjes me dhunë e parashikuar nga neni 628 i kodit penal e shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë e parashikuar nga neni 629 i kodit penal;

g) vepra për prodhim ilegal, futja në shtet, shitja, tjetërsimi, mbajtja në vend publik ose të hapur për publikun të armëve luftarake ose pjesë të tyre, eksplozivësh, armësh klandestine si dhe të disa armëve të zakonshme zjarri përjashtuar ato të parashikuara nga neni 2, paragraf i tretë, i ligjit datë 18 prill 1975, n. 110;

h) vepra që lidhen me lëndët narkotike ose psikotrope që dënohen sipas nenit 73 të tekstit të vetëm të miratuar me D.P.R. 9 tetor 1990, n. 309, përveç rasteve kur verifikohen rrethanat e parashikuara nga paragrafi 5 i të njëjtit nen;

i) vepra të kryera për qëllime terroriste ose kundër rendit kushtetues për të cilat ligji përcakton dënimin me burg minimumi jo më pak se katër vjet e maksimumi deri dhjetë vjet;

l) vepra për promovimin, themelimin, drejtimin e

organizimin e shoqatave sekrete të parashikuara nga neni 1 i ligjit datë 25 janar 1982, n. 17, i shoqatave me karakter ushtarak të parashikuara nga neni 1 i ligjit datë 17 prill 1956, n. 561, i shoqatave, i lëvizjeve ose i grupeve të parashikuara nga nenet 1 e 2, të ligjit të datës 20 qershor 1952, n. 645, i organizatave, shoqatave, lëvizjeve ose grupeve sipas nenit 3, paragrafi 3, i L. 13 tetor 1975, n. 654;

l-bis) vepra për pjesëmarrje, promovim, drejtim e organizim të organizatave të llojit mafioz parashikuar nga neni 416-bis i kodit penal;

m) vepra për promovim, drejtim, themelim e organizim të organizatave kriminale parashikuar nga neni 416 paragrafët 1 e 3 të kodit penal, nëse organizata drejtohet për kryerjen e disa veprave penale midis të cilave ato të parashikuara nga paragrafi 1 ose nga shkronjat a), b), c), d), f), g), i) të këtij paragrafi.

Nëse bëhet fjalë për vepër që ndiqet me padi, arresti në flagrancë kryhet nëse padia propozohet, edhe me deklaratë të bërë gojarisht përballë oficerit ose agjentit të policisë gjyqësore të pranishëm në vend. Në qoftë se personi që ka të drejtë deklaron se e tërheq padinë, i arrestuari lirohet menjëherë.

### Arrestimi fakultativ në flagrancë neni 381 kpp.

Oficerët e agjentët e policisë gjyqësore kanë mundësi të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë me një vepër të bërë jo me pakujdesi, e kryer ose e mbetur në tentativë, për të cilën ligji përcakton dënimin me burg maksimumi me tre vjet ose të një veprë të bërë me pakujdesi për të cilën ligji përcakton dënimin me burg maksimumi jo më pak se pesë vjet.

Oficerët e agjentët e policisë gjyqësore kanë gjithashtu mundësi të arrestojnë cilindo kapet në flagrancë me një nga veprat e mëposhtme:

- a) shpërdorim me përfitim nga gabimi i të tjerëve parashikuar nga neni 316 i kodit penal;
- b) korrupsion për një akt kundër detyrave zyrtare të parashikuar nga nenet 319 paragrafi 4 e 321 i kodit penal;
- c) dhunë ose kërcënim ndaj një zyrtari të shtetit të parashikuar nga neni 336 paragrafi 2 i kodit penal;
- d) tregti e dhënie të ilaçeve të prishura e të lëndëve ushqimore të dëmshme të parashikuara nga nenet 443 e 444 të kodit penal;
- e) korrupsion i të miturve i parashikuar nga neni 530 i kodit penal;
- f) lëndim personal i parashikuar nga neni 582 i kodit penal;
- f-bis) dhunim i banesës parashikuar nga neni 614, paragrafi i parë e i dytë, i kodit penal;
- g) vjedhje parashikuar nga neni 624 i kodit penal;
- h) dëmtim i rëndë sipas nenit 635 paragrafi 2 i kodit penal;
- i) mashtrim i parashikuar nga neni 640 i kodit penal;
- l) përvetësim i kundërligjshëm i parashikuar nga neni 646 i kodit penal;
- l-bis) dhënia, shpërndarja ose mbajtja e materialit pornografik të parashikuara nga nenet 600-ter, paragrafi i katërt, e 600-quater i kodit penal, edhe pse lidhur me materialin pornografik sipas nenit 600-quater.1 të të njëjtit kod;
- m) ndryshimi i armëve e prodhimi i eksplozivëve të palejuar të parashikuar nga nenet 3 e 24 paragrafi 1 i ligjit 18 prill 1975, n. 110;

*m-bis) prodhimi, mbajtja ose përdorimi i dokumenteve false të identitetit të parashikuara nga neni 497-bis i kodit penal.*

*m-ter) vërtetim ose deklaratë e rremë përballë një zyrtari për identitetin ose për të dhënat personale të vetat ose të të tjerëve, parashikuar nga neni 495 i kodit penal;*

*m-quater) ndryshime mashtruese për të penguar identifikimin ose kontrollin e të dhënave personale, të parashikuara nga neni 495-ter i kodit penal.*

*Nëse bëhet fjalë për vepër që ndiqet me padi, arresti në flagrancë kryhet nëse padia propozohet, edhe me deklaratë të bërë gojarisht përballë oficerit ose agjentit të policisë gjyqësore të pranishëm në vend. Në qoftë se personi që ka të drejtë deklaron se e tërheq padinë, i arrestuari lirohet menjëherë.*

*Sipas rasteve të parashikuara nga ky nen vijohet me arrestin në flagrancë vetëm nëse masa justifikohet nga rëndësia e faktit, ose nga rrezikshmëria e subjektit, e nxjerrë nga personaliteti i tij, ose nga rrethanat e faktit. Nuk lejohet arresti i personit të cilit i kërkohet të japë informacione nga policia gjyqësore ose nga prokurori për vepra që lidhen me përmbajtjen e informacioneve ose refuzimit për t'i dhënë.*

## **Neni 384 kpp Ndalimi i të dyshuarit për një vepër penale**

*Edhe jashtë rasteve të flagrancës, kur ka elemente specifike që, edhe lidhur me pamundësinë për të identifikuar të dyshuarin, bëjnë të konsiderohet i themeltë rreziku i ikjes, prokurori vendos ndalimin e personit të dyshuar rëndë për një vepër penale për të cilën ligji përcakton dënimin me burgim të përjetshëm ose me*

burgim minimumi jo më i vogël se dy vjet e maksimumi më i madh se gjashtë vjet, ose për një vepër që lidhet me armët e luftës dhe eksplozivët, ose për një vepër të bërë për qëllime terroriste, edhe ndërkombëtare, ose kundër rendit demokratik.

Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1 e para se prokurori të ketë marrë drejtimin e hetimeve, oficerët e agjentët e policisë gjyqësore procedojnë me ndalimin me iniciativë të vet.

Policia gjyqësore vijon gjithashtu me ndalimin me iniciativë të vet në rast se është identifikuar më pas i dyshuari ose në rast se verifikohen elemente specifike, si mbajtja e dokumenteve të falsifikuara, që e bëjnë të themeltë rrezikun se i dyshuari është gati për të ikur e nuk është e mundur, për situatën me karakter urgjent, të pritet masa e prokurorit.

## Neni 123 kpp Deklaratat e kërkesat e personave në burg ose të internuar.

I pandehuri që mbahet ose është i internuar në një burg për zbatimin e masave të sigurisë ka mundësinë të paraqesë kundërshtime, deklarata e kërkesa me akt që merret nga drejtori. Ato regjistrohen në një regjistër të posaçëm, i komunikohen menjëherë autoritetit kompetent e kanë efektshmëri sikur të ishin marrë drejtpërdrejt nga autoriteti gjyqësor.

Kur i pandehuri është në gjendje arresti ose qëndrimi në shtëpi ose i ruajtur në një vend kurimi, ka mundësi të paraqesë kundërshtime, deklarata e kërkesa me akt të marrë nga një oficer të policisë gjyqësore, i cili kujdeset për transmetimin e menjëhershëm drejt autoritetit kompetent. Kundërshtimet, deklaratat e kërkesat kanë

*efektshmëri sikur të ishin marrë drejtpërdrejt nga autoriteti gjyqësor.*

*Dispozitat e paragrafit 1 u zbatohen denoncimeve, kundërshtimeve, deklaratave e kërkesave të paraqitura nga palët e tjera private ose nga personi i fyer.*





## FAZA EKZEKUTUESE – ARRESTI PAS URDRIT PËR EKZEKUTIM – GJYKA TËSI I EKZEKUTIMIT

### Arrestimi pas urdhrimit të ekzekutimit ose për burgosje (neni 656 kpp)

Siç thuhet më sipër, personi gjendet në rastin e arrestit për faktin se duhet të shlyejë dënimin e përcaktuar me vendim përfundimtar (ose ngaqë kanë përfunduar të gjitha shkallët e gjykimit ose ngaqë nuk është bërë apel ose rekurs sipas afatit).

Pastaj i dorëzohet personit kopja e masës në fjalë, ku edhe në këtë rast shënohet emri i avokatit mbrojtës të besuar ose të caktuar zyrtarisht. Ka rëndësi edhe në këtë rast të kontaktohet sa më shpejt avokati duke pasur parasysh faktin se kundër urdhrimit për burgim pranohen disa rrugëdalje. Është e rëndësishme të kujtojmë pezullimin e urdhrimit të ekzekutimit sipas nenit 656 par. 5 kpp.

#### *Kur është e mundur*

në qoftë se dënimi me burg, edhe nëse përbën mbetjen më të madhe të dënimit, nuk është më i madh se 3 vjet, **katër vjet në rastet e parashikuara nga neni 47 ter paragrafi 1 i ligjit n°354/1975**, ose 6 vjet në rastet e neneve 90 e 94 të tekstit të vetëm të miratuar me dekret të Presidentit të Republikës më 9 tetor 1990, n. 309, e ndryshimet e mëpasshme, prokurori, përveç çka është parashikuar nga paragrafët 7 e 9, e pezullon ekzekutimin. Urdhri i ekzekutimit e dekreti i pezullimit u njoftohen të dënuarit dhe avokatit të emëruar për fazën e ekzekutimit ose, në pamundësi, avokatit që e ka ndihmuar në fazën e gjykimit, me lajmërimin se brenda 30 ditëve mund të paraqitet kërkesë e pajisur me udhëzimet e dokumentacionin e nevojshëm me qëllim që të arrihet dhënia e një prej masave alternative ndaj burgimit sipas neneve 47 (vënia në provë tek shërbimet sociale), 47ter (qëndrimi në shtëpi) e 50 (pranimi i gjysmëlibrisë), paragrafi 1 i L. 26 korrik 1975, n. 354 e ndryshimet e mëpasshme, e sipas nenit 94 (vënia në provë në raste të veçanta) i tekstit të vetëm të miratuar me dekret të Presidentit të Republikës 9 tetor 1990, n. 309, e ndryshimet e mëpasshme, ose pezullimi i ekzekutimit të dënimit sipas nenit 90 të të njëjtit tekst të vetëm. Njoftimi informon gjithashtu se, në rast se nuk është paraqitur kërkesë ose në rast se kërkesa nuk pranohet sipas neneve 90 e vijuese të tekstit të vetëm të lartcitar, ekzekutimi i dënimit do të zbatohet menjëherë.

Paragrafi 7 i nenit 656 kpp (kodi i procedurës penale) thotë se pezullimi për të njëjtin dënim nuk mund të vendoset më shumë se një herë, edhe në qoftë se i dënuari ribën kërkesë të re qoftë lidhur me një masë të ndryshme të posaçme, qoftë lidhur me po atë masë, të motivuar në mënyrë të ndryshme, qoftë lidhur me pezullimin e ekzekutimit të dënimit sipas nenit 90 e vijues të tekstit të vetëm të miratuar me dekret të Presidentit të Republikës më 9 tetor 1990, n. 309, e ndryshimet e mëpasshme, si dhe, në pritje të vendimit të gjykatës së mbikëqyrjes, kur programi i rikuperimit sipas nenit 94 të të njëjtit tekst të vetëm nuk rezulton i filluar brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse ose rezulton i ndërprerë.

#### SHËNIM

D.l. n°78/2013 (i konvertuar në l. n°94/2013) e ka ngritur deri në 4 vjet limitin e heqjes së lirisë të parashikuar për pezullimin e urdhrin të ekzekutimit në rastet e parashikuara nga neni 47 ter O.P. paragrafi 1: ose në rastet kur është e mundur ta kesh qëndrimin në shtëpi për motive humanitare (për personin në gjendje shëndeti veçanërisht të rënda që kërkojnë kontakte konstante me qendrat shëndetësore territoriale, ...).

Në këtë mënyrë zgjidhet një kontradiktë e sistemit të vjetër që parashikonte mundësinë që të kërkohej qëndrimi në shtëpi për dënime deri në 4 vjet, por pezullimi i urdhrin të ekzekutimit për të kërkuar masën nga gjendja e lirisë për dënime deri në 3 vjet. Tani të dy gjërat shkojnë me të njëjtin hap.

Problemi sot ngrihet për vënien në provë tek shërbimi social, nga çasti kur d.l. n°146/2013, i konvertuar në ligj n°10/2014, e ka shtrirë – në disa raste – mundësinë që të kërkohej caktimi në provë tek shërbimi social në rast se dënimi, edhe ai i mbetur, nuk është më i madh se 4 vjet.

#### SHËNIM

D.l. n°78/2013 (i konvertuar në l. n°94/2013) ka parashikuar që prokurori – para se të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit – ia transmeton aktet Gjykatës të Mbikëqyrjes, me qëllim që të vendosë zbatimin eventual të lirisë para kohe.

Në këtë mënyrë, "pragu" i 3 viteve (ose 4 ose 6, në rastet e treguara) për kërkuar masën alternative nga gjendja e lirisë ngrihet me të gjitha ditët e hequra si liri para kohe (e anticipuar).

! Ky rregull NUK u zbatohet të dënuarve sipas nenit 4 bis ligji n°354/1975

#### ***Kur nuk është e mundur:***

Në disa raste pezullimi i ekzekutimit NUK mund të vendoset (as edhe kur dënimi me heqje lirie, edhe nëse përbën mbetjen më të madhe të dënimit, nuk është më i madh se 3 vjet ose 4 vjet ose 6, në rastet e caktuara).

Këto raste parashikohen në paragrafin 9 të nenit 656 k.p.p., mjaft i ripërpunuar

së fundi, në vijim të d.l. n°78/2013, konvertuar në ligjin n°94/2013.

Ndalimi i pezullimit të ekzekutimit mund të bëhet:

- a) kundrejt të dënuarve për veprat penale sipas nenit 4bis<sup>1</sup> të ligjit n. 354/1975; veprën e zjarrit në pyll (neni 423 bis k.p.); vepra penale e keqtrajtimit kundër familjarëve e bashkëjetuesve në hipotezën e parashikuar nga neni 572 paragrafi 2 k.p.; vepra e akteve persekutuese të kryera ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose personit me paaftësi fizike ose me armë ose nga person që ka ndryshuar pamjen (neni 612 bis paragrafi 3 k.p.); veprat e vjedhjes në banesë e vjedhje me marrje (624 bis k.p.).

! Ndalimi nuk bëhet veçse për ata që gjenden në arrest shtëpie të vendosur sipas nenit 89 T.U. lëndë narkotike (D.P.R. n. 309/1990), ose të pandehurve toksikomanë ose të alkoolizuarve që janë duke bërë programe terapeutike.

Në bazë të kësaj dispozite, në vijim të procesit e kur do të ekzistonin premiset për paraburgim, këtyre të pandehurve mund t'u jepet arrest shtëpie: në dy hipoteza, edhe pse bëhet fjalë për të dënuar për një nga veprat sipas nenit 4 bis O.P. (saktësisht, në rast vjedhjeje të rënduar me dhunë dhe shtrengim i rënduar me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë) gjithsesi brenda një strukture rezidenciale e gjithnjë nëse nuk ekzistojnë lidhje me kriminalitetin e organizuar.

- b) ndaj atyre që, për faktin në fjalë të dënimit që duhet kryer, gjenden në paraburgim në çastin kur vendimi bëhet i formës së prerë;

## SHËNIM.

Sot ndalimi NUK bëhet më ndaj të dënuarve të cilëve u është aplikuar karakteri i përsëritjes e parashikuar nga neni 99 paragrafi 4 i kodit penal<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Teksti i nenit 4bis i ligjit datë 26 korrik 1975 n. 354 e ndryshime të mëpasshme gjendet në shtojcën në fund të kapitullit 2.

<sup>2</sup> Teksti i nenit 99 i kodit penal gjendet në shtojcën në fund të kapitullit 2. Sipas nenit 4 paragrafi 2 i D.L. 30 dhjetor 2005, n. 272, i shndërruar, me ndryshime, në L. 21 shkurt 2006, n. 49 dispozita sipas shkronjës c) të paragrafit 9 të nenit 656 të kodit të procedurës penale nuk zbatohet ndaj të dënuarve, toksikomanë ose të alkoolizuar, që janë duke ndjekur, në çastin e depozitimit të vendimit përfundimtar, një program terapeutik rikuperimi pranë shërbimeve publike për asistencën ndaj toksikomanëve ose në kuadrin e një strukture të autorizuar në rastet kur ndërprerja e programit mund të dëmtojë dezintoksikimin. Në këtë rast prokurori përcakton kontrollin për të vërtetuar nëse toksikomani ose i alkoolizuari e ndjek programin e rikuperimit deri në vendim të Gjykatës së mbikëqyrjes dhe revokon pezullimin e ekzekutimit kur vërtetohet se personi e ka ndërprerë

## **Për trajtimin e masave të posaçme shikoni më tutje tek pjesa përkatëse në kapitullin 4.**

### **Gjykatësi i ekzekutimit**

Ligji ia jep kompetencën e njohjes së ekzekutimit të dënimit një gjykatësi që quhet gjykatës i ekzekutimit.

Ky i fundit është kompetent për të gjitha çështjet që kanë lidhje me vlefshmërinë e titullit ekzekutiv për të cilin personi është dënuar. Kodi i procedurës penale parashikon që ky funksion i gjykatësit të ekzekutimit që kryhet nga gjykatësi që ka dhënë vendimin e dënimit ose, në rast se vendimi i dënimit të shkallës së parë është ndryshuar në apel jo vetëm për dënimin, nga gjykatësi i apelit.

Për shembull gjykatësi i ekzekutimit është kompetent për çështjet lidhur me amnistinë, faljen e ligjshmërinë e urdhrin për burgim, zbatimin e veprës së vazhduar, kërkesën për rivendosje në afat në rast se i dënuari nuk ka mundur ta paraqesë kundërshtimin në afatet e caktuara, në rast se janë nxjerrë disa dënime për të njëjtin fakt.

### **Falja**

Më 1 Gusht 2006 hyri në fuqi ligji që lejoi faljen.

Falja është shkak i shuarjes së dënimit (ndryshe nga amnistia, që shuan veprën), në këtë rast në masën prej tre vjetësh e për sa i përket dënimit me parà në masën prej 10.000,00 euro.

Zbatohet për vendimet e dënimit për vepra të kryera deri më 2 maj 2006, me përjashtim të disa veprave (psh. dhunë seksuale, pedofili, mbajtje peng e personit me qëllim shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, organizatë mafioze ose terroriste e të tjera).

Falja i hiqet atij që gjatë pesë vjetëve pas dhënies së përfutimit kryen një vepër jo me pakujdesi për të cilën dënohet me burg më shumë se dy vjet.

Zbatimi i faljes duhet bërë nga gjykatësi i ekzekutimit e mund të çojë lirimin e menjëhershëm në rast se dënimi, për efekt të masës së faljes, rezulton tërësisht i kryer.

Neni 79 i Kushtetutës parashikon që falja dhe amnistia jepen me ligj të miratuar me shumicën e 2/3 të anëtarëve të Dhomës së Deputetëve, në çdo nen të saj dhe në votimin përfundimtar.

Ligji që jep falje ose amnisti përcakton edhe afatin për zbatimin e tyre. Në çdo rast, falja e amnistia nuk mund t'u zbatohen veprave të kryera pas paraqitjes së projekt ligjit.

## Rivendosja në afat (neni 175 kpp)

Në rast se është dhënë vendimi në mungesë ose dekreti i dënimit, i pandehuri rivendoset në afat, sipas kërkesës së vet, për të propozuar kundërshtimin ose kundërvënien, përveç rastit nëse ai ka pasur njohje efektive të procedimit ose të masës e ka hequr dorë vullnetarisht të paraqitet ose të propozojë kundërshtim ose kundërvënie. Për këtë qëllim autoriteti gjyqësor kryen çdo verifikim të nevojshëm.

Kërkesa e përmendur paraqitet brenda tridhjetë ditëve duke filluar nga ajo kur i pandehuri ka marrë dijeni efektive për masën, përndryshe ai e humbet të drejtën.

Për kërkesën vendos me urdhëresë gjykatësi që procedon në çastin e paraqitjes së saj. Në qoftë se janë shpallur vendime ose dënime, vendos gjykatësi që duhet të ishte kompetent për kundërshtimin ose kundërvënien.

Kundër urdhëresës që e refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të propozohet rekurs në kasacion.

Kur e pranon kërkesën për rivendosje në afat për të propozuar kundërshtim, gjykatësi, nëse lipset, urdhëron lirimin e të pandehurit të burgosur e merr të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar efektet e shkaktuara nga skadimi i afatit.

## Ndreqja e burgimit të padrejtë (neni 314 kpp) – Rishikimi i vendimit (neni 629 kpp) – Ndreqja e gabimit gjyqësor

Duhet ditur se në legjisllacionin juridik parashikohen disa rrugëdalje në rast se qëndrimi në burg konsiderohet i padrejtë, me mundësinë që t'i kërkohet gjykatës kompetente të apelit një shumë parash lidhur me periudhën e qëndrimit në burg, me kusht që qëndrimi i personit që ka pësuar paraburgim të mos ketë qenë me dashje ose i kryer rëndë me pakujdesi.

Ka gjithashtu mundësi, në rast se qëndrojnë premiset, të kërkojë rishikimin e vendimit të dënimit që konsiderohet i padrejtë, gjithnjë gjykatës së apelit në rajonin e të cilës gjendet gjykatësi që ka nxjerrë vendimin.

Në rast rishikimi të vendimit me pushimin e çështjes penale, personi të cilit i

është pushuar çështja penale ka të drejtë për një ndreqje të drejtë në lidhje me kohëgjatësinë e vuajtjes së dënimit e me pasojat personale e familjare.

## Konventa e Strasburgut

Për sa i përket të burgosurve të huaj të pranishëm në burgjet italiane duhet sinjalizuar mundësia e parashikuar nga konventa ndërkombëtare e Strasburgut (21 mars 1983), e ratifikuar nga Italia më 1988, që këta të fundit, me pëlqimin e tyre, mund ta vuajnë dënimin në vendin e tyre të origjinës, mjaft që të ketë pranuar Konventën.

Kërkesa për ekzekutimin jashtë shtetit të një dënimi të dhënë nga autoritetet gjyqësore italiane nënkupton që ai të jetë përfundimtar e lidhur me një fakt që të parashikohet nga të dy vendet si vepër penale, dënimi për t'u shlyer duhet të jetë më shumë se 6 muaj e duhet të ketë marrëveshje të të dy shteteve të interesuara.

Në asnjë rast autoritetet italiane nuk mund të lejojnë që ekzekutimi i dënimit të dhënë në Itali të bëhet në një vend ku ekziston rreziku konkret që personi t'i nënshtrohet trajtimeve jo njerëzore ose poshtëruese. Për të burgosurin e huaj që dëshiron të përdorë mundësinë që i ofron konventa e Strasburgut janë në dispozicion formularë të posaçëm pranë zyrës së amzës në burg.

### *Dekreti legjislativ datë 7 shtator 2010, n. 161*

*Dispozita për përshtatjen e së drejtës kombëtare me Vendimin kuadër 2008/909/GAI lidhur me zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve penale që japin dënime me burgim ose heqje lirie personale, me qëllim përmbyshjen e tyre në Bashkimin Europian*

Kjo normativë e re ka si qëllim lehtësimin e ekzekutimit të dënimeve me burg ose të masave për heqjen e lirisë personale në vendlindjet e personave të huaj që i përkasin Bashkimit europian në bazë të parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve të nxjerra nga shtetet anëtare.

Qëllimi është lehtësimi i rivendosjes së të burgosurve në territorin të cilit i përket.

Në rast dënimi përfundimtar me të cilin zbatohen, edhe së bashku, një dënim ose një masë sigurie ndaj një personi fizik, në qoftë se dënimi i mbetur ose masa e sigurisë për t'u shlyer është më shumë se gjashtë muaj e vepra për të

cilën është nxjerrë vendimi i dënimit ndëshkohet me një dënim me kohëgjatësi maksimale jo më pak se 3 vjet, prokurori që merret me ekzekutimin e vendimit mund të vendosë transmetimin jashtë shtetit drejt shtetit anëtar të Bashkimit europian të shtetësisë së personit të dënuar ku ky i fundit jeton, ose drejt shtetit anëtar të Bashkimit europian të shtetësisë së personit të dënuar ku ky i fundit do të dëbohet, pasi të përjashtohet nga ekzekutimi i dënimit ose nga masa e sigurisë, për arsye të një urdhri për dëbim ose largim të futur në vendimin e dënimit ose në një vendim gjyqësor ose administrativ ose në çdo masë tjetër të marrë pas vendimit të dënimit, ose drejt shtetit anëtar të Bashkimit europian që ka pranuar transmetimin, duke kërkuar në këtë rast pëlqimin e personit të dënuar.

Vendimi për transferimin është në kompetencën e gjykatës së apelit sipas nenit 9 të ligjit.

Personi i dënuar nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë procedimi tjetër penal, as të jetë në ekzekutim të një vendimi tjetër dënimi ose zbatimi të një mase tjetër të sigurisë, përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga autoriteti që procedon.

Për sa i përket ekzekutimit të masave të sigurisë personale në burg, prokurori kompetent për transmetimin jashtë shtetit caktohet sipas nenit 658 të kodit të procedurës penale.



## Shtojca kapitulli 2

### Neni 4-bis L. 354/1975

*Ndalimi i dhënies së përfitimeve dhe vërtetimi i rrezikshmërisë sociale të të dënuarve për disa vepra penale.*

*1. Caktimi në punë jashtë, lejet e shpërblimit e masat e posaçme alternative ndaj burgut të parashikuara në kapitullin VI, përjashto lirimin e parakohshëm, mund t'u jepen të burgosurve e të internuarve për veprat e mëposhtme vetëm në rastet kur këta të burgosur e të internuar bashkëpunojnë me drejtësinë sipas nenit 58-ter të këtij ligji: vepra të kryera për qëllime terroriste, edhe ndërkombëtare, ose kundër rendit demokratik duke kryer akte dhune, [vepra sipas nenit 416-bis dhe 416 ter të kodit penal](#), vepra të bëra duke përfituar nga kushtet e parashikuara nga i njëjti nen ose me qëllim lehtësimin e veprimtarisë së shoqatave të parashikuara në të, vepra sipas neneve 600, 600-bis, paragrafi i parë, 600-ter, paragrafi i parë e i dytë, 601, 602, 609-octies e 630 i kodit penal, neni 291-quater i tekstit të vetëm të dispozitave legjislative në lëmin doganor, sipas dekretit të Presidentit të Republikës datë 23 janar 1973, n. 43, e neni 74 i tekstit të vetëm të ligjeve në lëmin e disiplinimit të lëndëve narkotike e psikotrope, parandalimit, kurimit e rehabilitimit të gjendjeve përkatëse të vartësisë nga drogat, sipas dekretit të Presidentit të Republikës datë 9 tetor 1990, n. 309. Përjashtohen dispozitat e neneve 16-nonies e 17-bis të dekret-ligjit 15 janar 1991, n. 8, shndërruar, me ndryshime, nga ligji datë 15 mars 1991, n. 82, e ndryshimet e mëpasshme.*

*1-bis. Përfitimet sipas paragrafit 1 mund t'u jepen*

të burgosurve ose të internuarve për një nga veprat e parashikuara aty, mjafton që të jenë marrë elemente të tilla që ta përjashtojnë aktualitetin e lidhjeve me kriminalitetin e organizuar, terrorist ose subversiv, gjithashtu në rastet kur pjesëmarrja e kufizuar në faktin kriminal, e vërtetuar në vendimin e dënimit, ose vërtetimi i plotë i fakteve dhe i përgjegjësive, i bërë me vendim të përvokueshëm, e bëjnë gjithsesi të pamundur bashkëpunimin e dobishëm me drejtësinë, gjithashtu në rastet kur, edhe pse bashkëpunimi që ofrohet rezulton objektivisht i parëndësishëm, ndaj të burgosurve ose të internuarve të njëjtë të jetë zbatuar një nga rrethanat lehtësuese të parashikuara nga neni 62, numri 6), edhe në rast se dëmshpërblimi të jetë bërë pas vendimit të dënimit, nga neni 114 ose nga neni 116, paragrafi i dytë, i kodit penal.

1-ter. Përfitimet sipas paragrafit 1 mund të jepen, mjaft që të mos ketë elemente të lidhjeve me kriminalitetin e organizuar, terrorist ose subversiv, të burgosurve ose të internuarve për veprat sipas neneve 575, 600-bis, paragrafi i dytë e i tretë, 600-ter, paragrafi i tretë, 600-quinquies, 628, paragrafi i tretë, e 629, paragrafi i dytë, i kodit penal, tek neni 291-ter i tekstit të vetëm të cituar sipas dekretit të Presidentit të Republikës datë 23 janar 1973, n. 43, tek neni 73 i tekstit të vetëm të cituar sipas dekretit të Presidentit të Republikës datë 9 tetor 1990, n. 309, e ndryshimet e mëpasshme, vetëm për rastet e rënduara sipas nenit 80, paragrafi 2, i të njëjtit tekst të vetëm, tek neni 416, paragrafi i parë e i tretë, i kodit penal, i realizuar me qëllimin e kryerjes së veprave të parashikuara nga nenet 473 e 474 të të njëjtit kod, e tek neni 416 i kodit penal, i realizuar me qëllimin e kryerjes së veprave të parashikuara nga vëllimi II, titulli XII, kapitulli III,

seksioni I, i të njëjtit kod, nga nenet 609-bis, 609-quater e 609-octies i kodit penal e nga neni 12, paragrafët 3, 3-bis e 3-ter, i tekstit të vetëm të dispozitave lidhur me disiplinën e imigracionit e normave për gjendjen e të huajit, sipas dekretit legjislativ datë 25 korrik 1998, n. 286, e ndryshimet e mëpasshme.

1-quater. Përfitimet sipas paragrafit 1 mund t'u jepen të burgosurve ose të internuarve për veprat sipas neneve 600-bis, 600-ter, 600-quater, 600-quinquies, 609-bis, 609-ter, 609-quater, 609-quinquies, 609-octies e 609-undecies të kodit penal vetëm në bazë të rezultateve të vëzhgimit shkencor të personalitetit të bërë kolegjisht të paktën për një vit edhe me pjesëmarrjen e ekspertëve sipas paragrafit të katërt të nenit 80 të këtij ligji. Dispozitat sipas fjalisë së mësipërme zbatohen përsa i takon veprës së parashikuar nga neni 609-bis i kodit penal me përjashtim të rasteve kur rezulton e zbatuar rrethana lehtësuese e parashikuar nga ai vetë.

1-quinquies. Me përjashtim të asaj që është parashikuar nga paragrafi 1, për dhënien e përfitimeve ndaj të burgosurve e të internuarve për veprat sipas neneve 600-bis, 600-ter, edhe pse lidhur me materialin pornografik sipas neneve 600-quater.1, 600-quinquies, 609-quater, 609-quinquies e 609-undecies të kodit penal, si dhe sipas neneve 609-bis e 609-octies të po këtij kodi, në qoftë se janë bërë në dëm të një të mituri, gjykatësi mbikëqyrës ose gjykata e mbikëqyrjes vlerëson pjesëmarrjen pozitive në programin e rehabilitimit specifik sipas nenit 13-bis të këtij ligji.

2. Për dhënien e përfitimeve sipas paragrafit 1 gjykatësi mbikëqyrës ose gjykata e mbikëqyrjes vendos pasi merr informacione të detajuara nëpërmjet komitetit provincial kompetent për rendin publik e sigurinë publike në lidhje

me vendin e burgimit të të dënuarit. Në çdo rast gjykatësi vendos pasi kalojnë tridhjetë ditë nga kërkesa për informacione. Në komitetin provincial të lartpërmendur mund të marrë pjesë drejtori i burgut ku mbahet i dënuari.

2-bis. Për dhënien e përfitimeve sipas paragrafit 1-ter, gjykatësi mbikëqyrës ose gjykata e mbikëqyrjes vendos pasi merr informacione të detajuara nga kuestori. Në çdo rast gjykatësi vendos pasi kalojnë tridhjetë ditë nga kërkesa për informacione.

3. Kur komiteti mendon se ka kërkesa të posaçme sigurie ose që lidhjet mund të mbahen me organizatat vepruese në kuadër jo lokal ose jashtëkombëtar, e njofton gjykatësin për këtë dhe afati sipas paragrafit 2 shtyhet me tridhjetë ditë të tjera me qëllim që të merren elemente e informacione nga ana e organeve qendrore kompetente.

3-bis. Caktimi në punë jashtë, lejet e shpërblimit e masat e posaçme alternative ndaj burgut të parashikuara në kapitullin VI, nuk mund t'u jepen të burgosurve e të internuarve për veprat me dashje kur Prokurori kombëtar kundër mafies ose prokurori i rrethit njofton, me iniciativë ose sinjalizim të komitetit provincial kompetent për rendin e sigurinë publike, në lidhje me vendin e qëndrimit në burg ose internim, për aktualitetin e lidhjeve me kriminalitetin e organizuar. Në këtë rast nuk merren parasysh procedurat e parashikuara në paragrafët 2 e 3.

## Neni 99 kp - Përsëritja

Ai që, pasi është dënuar për një vepër të bërë jo me pakujdesi, kryen një tjetër, mund t'i zbatohet një rritje me një të tretën e dënimit për t'i dhënë për veprën e re të bërë jo me pakujdesi.

Dënimi mund të shtohet deri në gjysmë:

1) në qoftë se vepra e re e bërë jo me pakujdesi është e të njëjtës natyrë;

2) në qoftë se vepra e re e bërë jo me pakujdesi është kryer në pesë vjetët e dënimit të mëparshëm;

3) në qoftë se vepra e re e bërë jo me pakujdesi është kryer gjatë ose pas ekzekutimit të dënimit, ose gjatë kohës kur i dënuari i largohet vullnetarisht ekzekutimit të dënimit. Në rastet kur ka disa rrethana midis atyre të treguara në paragrafin e dytë, dënimi rritet përgjysmë.

Nëse përsëritësi kryen një vepër tjetër të bërë jo me pakujdesi, rritja e dënimit, sipas rastit të paragrafit të parë, bëhet përgjysmë e, në rastet e parashikuara në paragrafin e dytë, rritet me dy të tretat.

Në qoftë se bëhet fjalë për një nga veprat e treguara nga neni 407, paragrafi 2, shkronja a), i kodit të procedurës penale, rritja e dënimit për përsëritje është e detyrueshme e, në rastet e treguara në paragrafin e dytë, nuk mund të jetë më pak se një e treta e dënimit për t'i dhënë për veprën e re.

Në asnjë rast rritja e dënimit për efekt të përsëritjes nuk mund të kapërcejë bashkimin e dënimeve që rezultojnë nga dënimet përpara kryerjes së veprës të bërë jo me pakujdesi.

## MASAT E SIGURISË DHE RREZIKSHMËRIA SHOQËRORE

Neni 215 i kodit penal parashikon llojet e masave të sigurisë personale që dallohen në masa me burg e jo me burg.

Janë masa të sigurisë me burg:

- 1) caktimi në një qendër bujqësore ose në një shtëpi pune;
- 2) shtrimi në një vend kurimi e ruajtjeje;
- 3) shtrimi në spitalin psikiatrik gjyqësor;
- 4) shtrimi në reformatorin gjyqësor.

Janë masa të sigurisë jo me burg:

- 1) liria e mbikëqyrur;
- 2) ndalimi i qëndrimit në një ose disa komuna (bashki), ose në një ose disa provinca;
- 3) ndalimi për të shkuar në restorante ose shitore publike pijesh alkoolike;
- 4) dëbimi i të huajit nga shteti.

Kur ligji përcakton një masë sigurie pa ia treguar llojin, gjykatësi vendos që të zbatohet liria e mbikëqyrur përveç rasteve kur, meqë bëhet fjalë për një të dënuar për vepër penale, mendon ta caktojë në një qendër bujqësore ose shtëpi pune.

Masat e sigurisë mund të zbatohen nga gjykatësi në vetë vendimin e dënimit (edhe të pushimit të çështjes penale) vetëm personave të rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore, që kanë kryer një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.

Ligji penal përcakton rastet kur personave të rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore mund t'u zbatohen masa sigurie për një fakt të paparashikuar nga ligji si vepër penale (neni 202 kp).

Mund të jepen edhe me vendim të mëvonshëm në rast se dënohet gjatë ekzekutimit të dënimit, ose gjatë kohës kur i dënuari i shmanget vullnetarisht ekzekutimit të dënimit e, në rastet e përcaktuara nga ligji, në çdo kohë.

Sipas ligjit penal, një person është i rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore, edhe pse nuk mund të merret i pandehur, ose nuk mund të ndëshkohet, kur ka kryer një nga faktet e lart treguara ose kur është e mundshme që të kryejë fakte të reja të parashikuara nga ligji si vepra penale (neni 203 kp).

Karakteristika si person i rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore del nga rrethanat

e treguara në nenin 133 kp<sup>1</sup>.

Masat e sigurisë nuk mund të hiqen nëse personat që u nënshtrohen atyre nuk kanë përfunduar së qeni të rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore (neni 207 kp).

Mund të urdhërohet heqja e masave edhe në qoftë se nuk ka kaluar një kohë sa periudha minimale e caktuar me ligj për secilën nga masat e sigurisë pas vendimit të Gjykatës kushtetuese n. 110/1974.

Pasi kalon periudha minimale, e caktuar me ligj për secilën masë sigurie, gjykatësi rimerr në shqyrtim kushtet e personit që i nënshtrohet atyre, për të përcaktuar nëse është ende i rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore, duke rishqyrtuar rrezikshmërinë.

Në rast se personi rezulton ende i rrezikshëm, gjykatësi cakton një afat të ri për një shqyrtim të mëtejshëm. Megjithatë, kur ka arsye të mendojë se rreziku ka kaluar, gjykatësi mund të procedojë në çdo kohë me kontrolle të reja.

Masat e sigurisë që i shtohen një dënimi me burg zbatohen pasi dënimi është vuajtur ose është shuar (neni 211 kp).

Masat e sigurisë që i shtohen një dënimi jo me burg zbatohen pasi vendimi i dënimit bëhet i parevokueshëm.

Masat e sigurisë me burg zbatohen në vendet e posaçme për këtë qëllim.

Në secilin nga këto vende ekziston një regjim i veçantë edukues ose kurues e pune, duke pasur parasysh prirjet e zakonet që kanë lidhje me veprat penale të personit e, në përgjithësi, me rrezikun shoqëror që rrjedh prej tij (neni 213 kp).

Neni 216 kp parashikon që të caktohen në një qendër bujqësore ose në një shtëpi pune:

- 1) ata që janë deklaruar keqbërës të zakonshëm; profesionistë ose me prirje;
- 2) ata që, meqenëse janë deklaruar keqbërës të zakonshëm, profesionistë

---

Art.133 cp Rëndësia e veprës penale: vlerësimi për efektin e dënimit. Në ushtrimin e pushtetit vetëgjykimor të treguar në nenin e mëparshëm, gjykatësi duhet të mbajë parasysh rëndësinë e veprës, që nxirret:

- 1) nga natyra, nga lloji, nga mjetet, nga objekti, nga koha, nga vendi e nga çdo mënyrë tjetër veprimi;
- 2) nga rëndësia e dëmit ose e rrezikut të shkaktuar personit të lënduar nga vepra;
- 3) nga intensiteti i dëmit ose nga shkalla e fajit.

Gjykatësi duhet të mbajë parasysh, gjithashtu, aftësinë për të kryer vepra penale të fajtorit, që nxirret:

- 1) nga motivet e kryerjes së krimeve e nga karakteri i fajtorit;
- 2) nga rastet e mëparshme të dënimit e të gjykimit e, në përgjithësi, nga sjellja e nga jeta e fajtorit, para se të kryente veprën;
- 3) nga sjellja gjatë ose pas veprës penale;
- 4) nga kushtet e jetës individuale, familjare e shoqërore të fajtorit.

ose me prirje, e duke mos qenë më nën masa sigurie, kryejnë një veprë të re penale, jo me pakujdesi, që të jetë tregues i karakterit të zakonshëm, të profesionalizmit ose të prirjes për të bërë vepra penale;3) personat e dënuar ose që u është pushuar çështja penale në rastet e tjera të treguara shprehimisht në ligj.

Neni 217 kp parashikon caktimin në një qendër bujqësore ose shtëpi pune që zgjat minimumi një vit. Për keqbërësit e zakonshëm, kohëgjatësia minimale është dy vjet, për keqbërësit profesionistë tre vjet, dhe katër vjet për keqbërësit me prirje.

Gjykatësi mbikëqyrës kontrollon zbatimin e masave të sigurisë personale. Kur një masë e sigurisë e ndryshme nga konfiskimi, që nuk përfshihet në rastet e parashikuara nga neni 312 kp (dënim ose largim i të huajit nga shteti), është urdhëruar me vendim, ose duhet të urdhërohet më pas, gjykatësi mbikëqyrës, me kërkesë të prokurorit ose zyrtarisht, sigurohet nëse i interesuari është person i rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore dhe merr masat përkatëse, duke parashikuar, nëse duhet, deklaratën e karakterit të zakonshëm ose profesional të veprës penale (neni 679 kpp).

Kundër masave të gjykatësit mbikëqyrës lidhur me masat e sigurisë e deklaratën e karakterit të zakonshëm ose profesionale të veprës ose të prirjes për të bërë vepra, mund të propozohet apel në gjykatën e mbikëqyrjes nga prokurori, i interesuari ose avokati (neni 680 kpp).

Gjykata e mbikëqyrjes, jashtë rasteve të parashikuara nga neni 579 paragrafët 1 e 3 kpp, gjykon edhe për kundërshtimet kundër vendimeve të dënimit ose të pushimit të çështjes penale lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me masat e sigurisë.

Neni 53 i L. 354/1975 përcakton se të internuarve mund t'u jepet leje prej gjatësi muajsh në periudhën menjëherë para përfundimit të afatit të caktuar për rishqyrtimin e rrezikshmërisë.

Po këtyre mund t'u jepet, për kërkesa të rënda personale ose familjare, një leje jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë; gjithashtu mund t'u jepet një leje jo më shumë se tridhjetë ditë, një herë në vit, me qëllim që të favorizohet ripërshtatja shoqërore.

Gjatë lejes i internuari i nënshtrohet regjimit me liri të mbikëqyrur.

## **Liria e mbikëqyrur (neni 228 k.p.)**

Mbikëqyrja e personit në gjendje lirie të mbikëqyrur i besohet autoritetit të sigurisë publike.



Personit në gjendje lirie të mbikëqyrur i imponohen nga gjykatësi rregulla që të shmangë rastet e veprave të reja penale.

Këto rregulla mund të ndryshohen ose të kufizohen më pas nga gjykatësi.

Mbikëqyrja duhet të ushtrohet në mënyrë që të lehtësojë, nëpërmjet punës, ripërshtatjen e personit në jetën shoqërore.

Liria e mbikëqyrur nuk mund të jetë më pak se një vit.

## **Shtrimi në spitalin psikiatrik gjyqësor (neni 222 k.p.)**

Në rast pushimi të çështjes penale për sëmundje mendore, ose për intoksikim kronik nga alkooli, ose nga lëndë narkotike, ose për shkak të shurdhmemecërisë, urdhërohet gjithnjë shtrimi i të pandehurit në një spital psikiatrik gjyqësor për një kohë jo më pak se dy vjet.

Koha minimale e shtrimit në spitalin psikiatrik gjyqësor është dhjetë vjet, në qoftë se për faktin e kryer ligji përcakton burgimin e përjetshëm, ose pesë vjet në qoftë se për aktin e kryer ligji përcakton dënimin me burg për një kohë minimale jo më pak se dhjetë vjet.

Në rastin kur personi i shtruar në spitalin psikiatrik gjyqësor duhet të vuajë një dënim me kufizim lirie personale, zbatimi i tij shtyhet derisa zgjat shtrimi në spitalin psikiatrik.

Sipas nenit 111 të DPR 230/2000 spitaleve psikiatrike u besohen, përveç atyre ndaj të cilëve zbatohet, në mënyrë përfundimtare ose provizore, masa e sigurisë në fjalë, edhe të pandehurit, të dënuarit e të internuarit që gjenden nga nenet 148 (sëmundje psikike e ardhur papritmas tek i dënuari), 206 (zbatim provizor i masave të sigurisë) e 212 paragrafi i dytë (raste të pezullimit ose transformimit të masave të sigurisë – në rastin e personit që i nënshtrohet masës së sigurisë me burg i cili preket nga sëmundje psikike e ardhur papritmas) të kodit penal.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese n. 253/2003 gjykatësi mund të marrë, në vendin e shtrimit në spitalin psikiatrik gjyqësor, një masë të ndryshme sigurie të parashikuar nga ligji, e përshtatshme për t'i siguruar kura të duhura të sëmurit e për t'i bërë ballë rrezikshmërisë së tij shoqërore.

### **SHËNIM**

Dekret Ligji n°211/2011, si është ndryshuar nga ligji i konvertimit n°9/2012, parashikonte që – brenda 31 Marsit 2013 – masat e sigurisë së shtrimit në spital psikiatrik gjyqësor dhe të caktimit në shtëpi kurimi dhe ruajtja të zbatoheshin vetëm brenda strukturave shëndetësore që përmbushin kriteret strukturore, teknologjike e organizative (edhe lidhur me aspektet e sigurisë) të

përcaktuara me dekret me natyrë jo rregulloreje të Ministrisë së Shëndetësisë, adoptuar së bashku me Ministrin e Drejtësisë e në marrëveshje me Konferencën e përhershme për marrëdhëniet midis Shtetit, Krahinave dhe Provincave autonome.

Afati, fillimisht i shtyrë më 1 Prill 2014, është shtyrë sërish në datën 31 Mars 2015 nga Dekret Ligji n°52/2014, konvertuar – me ndryshime – nga Ligji n°81/2014.

Ky ligj i fundit fut gjithashtu dispozita të tjera kuptimplote:

- » Deri në mbylljen përfundimtare të OPG (Spitalet psikiatrike gjyqësore), gjykatësi duhet ta aplikojë masën e sigurisë së shtrimit në OPG vetëm në rast se nuk ka masë tjetër të përshtatshme që të sigurojë kura të përshtatshme dhe t'i bëjë ballë rrezikshmërisë sociale të autorit të veprës penale. Në të njëjtën mënyrë duhet të veprojë gjykatësi i mbikëqyrjes i thirrur që të verifikojë rrezikshmërinë sociale të subjektit.
- » Verifikimi i rrezikshmërisë sociale duhet të bëhet në bazë të cilësive subjektive të personit e pa marrë parasysh kushtet sipas nenit 1332n°4 k.p. (ose kushtet e jetës individuale, familjare e sociale të fajtorit).
- » Nuk përbën element të përshtatshëm që të mbështesë gjykimin e rrezikshmërisë sociale vetëm mungesa e programeve terapeutike individuale.
- » Ligji i konvertimit fut parimin në bazë të cilit “masat e sigurisë me heqje lirie provizore ose përfundimtare, përfshirë shtrimin në rezidenca për ekzekutimin e masave të sigurisë, nuk mund të zgjasin përtej kohës së caktuar për dënimin me heqje lirie të parashikuar për veprën e kryer, duke marrë parasysh parashikimin ligjor maksimal”.  
Kjo dispozitë nuk aplikohet ndaj veprave penale të dënueshme me burgim të përjetshëm.

Si efekt i një marrëveshjeje të 26 shkurtit 2015 firmosur brenda Konferencës së unifikuar (selia e përbashkët e Konferencës Shteti-Krahinat e të Konferencës Shteti-Qytete e autonomi vendore) caktohet, midis të tjerave, rregullorja për t'u zbatuar brenda rezidencave të reja shëndetësore.

Në veçanti, sqarohet sa më poshtë vijon:

- » “Territorialiteti bazohet mbi rezidencën e verifikuar”. Në rastin e personave pa vendbanim fiks dhe me kombësi të huaj nënkuptohet me siguri çka është disiplinuar në Marrëveshjet e mëparshme të Konferencës së Unifikuar (të 2009 e të 2011).
- » Administrimi i brendshëm i REMS i takon ekskluzivisht personelit përkatës. Ndërsa, “shërbimet e sigurisë e të kontrollit perimetral aktivizohen në bazë të marrëveshjeve specifike me Prefekturat, edhe në bazë të informacioneve në kartelën e të internuarit”.

## Caktimi në një vend kurimi e ruajtjeje (neni 219 k.p.)

I dënuari, për vepra jo me pakujdesi me një dënim të ulur për arsye të sëmundjes psikike ose të intoksikimit kronik nga alkooli ose nga lëndë narkotike, ose për arsye të shurdhmemecërisë, shtrohet në një vend kurimi e ruajtjeje për një kohë jo më të shkurtër se një vit, kur minimumi i dënimit të caktuar me ligj nuk është më i vogël se pesë vjet burg.

Në qoftë se për veprën e kryer caktohet nga ligji dënimi me burg të përjetshëm, ose burgu jo më pak në minimum se dhjetë vjet, masa e sigurisë jepet për një kohë jo më pak se tre vjet.

### SHËNIM

Në këto raste, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese n. 249/1983, masa e shtrimit në një vend kurimi e ruajtjeje e të pandehurit të dënuar për veprë jo me pakujdesi me një dënim të ulur për shkak të sëmundjes psikike duhet t'i bëhet pas kontrollit nga ana e gjykatësit për rrezikshmërinë e vazhdueshme shoqërore që vjen nga vetë sëmundja psikike, në kohën e zbatimit të masës së sigurisë.

Në qoftë se bëhet fjalë për një veprë tjetër, për të cilën ligji përcakton dënim me burg, dhe rezulton që i dënuari është person i rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore, shtrimi në një vend kurimi ose ruajtjeje urdhërohet për një kohë jo më të vogël se gjashtë muaj; megjithatë gjykatësi mund ta zëvendësojë masën e shtrimit me atë të lirisë së mbikëqyrur. Ky zëvendësim nuk ndodh kur bëhet fjalë për të dënuar me dënim të ulur për intoksikim kronik nga alkooli ose nga lëndë narkotike.

Kur duhet të urdhërohet shtrimi në vend kurimi ose ruajtjeje, nuk zbatohet masë tjetër sigurie me burg.

### SHËNIM

Në këtë rast, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese n. 1102/1988, është caktuar që masa e shtrimit në vend kurimi ose ruajtjeje duhet të bëhet pas kontrollit për rrezikshmëri shoqërore që vjen nga sëmundja mendore jo vetëm në çastet kur masa e sigurisë merret, por edhe në çastin e ekzekutimit të saj.

### SHËNIM

Procesi i kapërcimit të Spitaleve Psikiatrike Gjyqësore ka të bëjë edhe me Shtëpitë e kurimit e të ruajtjes.

Për risitë, mund të konsultohen direkt informacionet e dhëna në paragrafin kushtuar OPG.

# GIYKATA E MBIKËQYRJES – PËRFITIMET E BURGUT

## Parimet themelore dhe trajtimin në burg

### *Neni 1 Ligji datë 26 korrik 1975, n. 354 – Trajtimi dhe riedukimi*

Trajtimi gjyqësor duhet të jetë në përputhje me karakterin njerëzor e duhet të sigurojë respektin e dinjitetit të njeriut.

Trajtimi karakterizohet nga paanshmëria absolute, pa diskriminime lidhur me kombësinë, racën e kushtet ekonomike e shoqërore, opinionet politike e besimet fetare.

Në burgje duhet të mbahet rendi e disiplina. Nuk mund të merren shtrëngime të pajustificueshme me kërkesat e parathëna ose, ndaj të pandehurve, jo të domosdoshme për arsyet gjyqësore.

Të burgosurit e të internuarit thirren ose tregohen me emrin e tyre.

Trajtimi i të pandehurve duhet të bazohet rigorozisht në parimin se ata nuk konsiderohen fajtorë deri në dënimin përfundimtar.

Ndaj të dënuarve e të internuarve duhet të zbatohet trajtim riedukativ që të anojë, edhe nëpërmjet kontakteve me mjedisin e jashtëm, drejt rifutjes shoqërore të tyre. Trajtimi zbatohet sipas një kriteri të individualizimit lidhur me kushtet specifike të subjekteve.

### *Neni 15 Ligji 26 korrik 1975, n. 354 - Elemente të trajtimit*

Trajtimi i të dënuarit e të internuarit zhvillohet duke përdorur kryesisht arsim, punë, fe, veprimtari kulturore, zbavitëse e sportive dhe duke i lehtësuar kontaktet e dhura me botën e jashtme dhe raportet me familjen.

Për trajtimin riedukativ, përveç rasteve të pamundura, të dënuarit e të internuarit u sigurohet puna.

Të pandehurit pranojnë, sipas kërkesës së tyre, të marrin pjesë në veprimtari edukative, kulturore e zbavitëse e, me përjashtim të rasteve me arsye të justifikueshme ose të dispozitave të kundërta të autoritetit gjyqësor, që të zhvillojnë veprimtari pune për formim profesional, mundësisht të zgjedhur prej tyre e, gjithsesi, në kushte të përshtatshme me pozitën e tyre juridike.

## Gjykatësi mbikëqyrës dhe gjykata e mbikëqyrjes

Ligji datë 26 korrik 1975 n. 354 disiplinon funksionin e kompetencat e gjykatësit mbikëqyrës e të gjykatës së mbikëqyrjes.

Gjykatësi mbikëqyrës, sipas nenit 69 op (ligji për burgjet), kontrollon organizimin e instituteve të parandalimit e të dënimit dhe i paraqet Ministrit të Drejtësisë kërkesat e shërbimeve të ndryshme, me vëmendje të posaçme ndaj zbatimit të trajtimit riedukativ. Përveç kësaj ushtron kontrollin e drejtpërdrejtë për të siguruar që ekzekutimi i burgut të të pandehurve të zbatohet në përputhje me ligjet e rregulloret dhe mbikëqyr ekzekutimin e masave të sigurisë personale.

Miraton, me dekret, programin e trajtimit ose, në qoftë se shikon tek ai elemente që përbëjnë shkelje të të drejtave të të dënuarit ose të internuarit, e kthen me vërejtje me qëllim që të bëhet një formulim i ri.

Miraton me dekret masën e pranimit në punë jashtë burgut. Gjithashtu, jep gjatë trajtimit dispozita të drejtpërdrejta për të eliminuar shkeljet e të drejtave të të dënuarve e të internuarve.

Ka kompetencë që të vendosë me urdhëresë për kërkesat e të dënuarve që synojnë marrjen e lirim të parakohshëm e për ankimet e paraqitura nga ata vetë kundër masave të administratës së burgut.

Gjykatësi mbikëqyrës vendos gjithashtu me dekret të motivuar për kërkesat e lejeve të paraqitura nga të burgosurit e të internuarit.

Gjykatësi mbikëqyrës është kompetent edhe për zbatimin e heqjen e masave të sigurisë.

Vetë ligji 354/75 parashikon që në çdo rreth të gjykatës së apelit të krijohet një gjykatë e mbikëqyrjes me kompetenca për dhënien e vënies në provë tek shërbimet sociale, e qëndrimin në shtëpi, e gjysmëlirisë dhe e lirisë së kushtëzuar, për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit në rastet e parashikuara nga nenet 146 e 147 kp<sup>1</sup>, si dhe për sa i përket heqjes ose ndërprerjes së këtyre masave, si dhe për ankimet në fushën e lejeve.

Gjykata e mbikëqyrjes përbëhet nga kryetari, nga një gjykatës tjetër mbikëqyrës e nga dy profesionistë ekspertë në psikologji, shërbim social, pedagogji, psikiatri e kriminologji klinike.

### SHËNIM

Lidhur me të kaluarën, Gjykata e Mbikëqyrjes dhe Gjykatësi mbikëqyrës, në disa fusha të kompetencës (si shndërrimi i dënimeve me gjobë, falja e

---

<sup>1</sup> Tekstet e neneve 146 e 147 kp gjenden në shtojcën në fund të kapitullit 4.

borxhit, ekzekutimi i gjysmë burgimit e të lirisë së mbikëqyrur për Gjykatësin e mbikëqyrjes, rehabilitimi dhe vlerësimi i përfundimit të vënies në provë për Gjykatën e mbikëqyrjes) mund ta vendosin pa ballafaqim masën, që mund të kundërshtohet nga i interesuari, e në këtë rast instaurohet procedimi i dhomës së këshillit në ballafaqim midis palëve.

Thjeshtimi synon të rezervojë plotësinë e ballafaqimit me çështjet më të lidhura me të drejtat themelore, ndërsa përdorimi i procedurës më të shpejtë e parashikuar nga neni 667 par. 4 kpp duhet të balancojë ngarkesën më të madhe të punës që bie mbi zyrat e mbikëqyrjes me ndryshimet e bëra nga ligjet e reja.

Ndryshohet neni 51 bis i Ligjit për burgjet, në kuptimin që në rast pasjetimi të një titulli të heqjes së lirisë vazhdimi i masës alternative në zhvillim e sipër t'i besohet Gjykatësit mbikëqyrës, ndërsa Gjykata do të përfshihet vetëm në rast ankimi.

Së fundi, normativa e re ndërhyt mbi disiplinën e përjashtimeve nga urdhrat e zbatuara ndaj të burgosurve me masë alternative, që shpesh rëndojnë mbi ngarkesën e punës së Gjykatës së mbikëqyrjes, ndonjëherë për ndryshime me rëndësi të vogël.

Neni 47 par. 8 i Ligjit për burgjet, siç është ndryshuar, parashikon që përjashtimet e përkohshme për urdhrat autorizohen, me propozim të drejtorit të zyrës së ekzekutimit penale të jashtëm, nga Gjykatësi i mbikëqyrjes edhe në formë gojore në rast urgjence.

## SHËNIM

Edhe i huaji i burgosur pa lejeqëndrim e pa dokument identiteti të vlefshëm mund të pranohet, kur ekzistojnë premiset e tjera, në punë jashtë burgut e në masat të posaçme alternative ndaj burgut.

Identifikimi bëhet sipas të dhënave personale të vendimit përfundimtar.

Zyrat kompetente duhet të lëshojnë kodin fiskal e një autorizim të posaçëm për punë, të vlefshëm derisa të përfundojë masa.

## Puna e jashtme (neni 21 o.p.)

Është mënyrë ekzekutimi i dënimit që lejon daljen nga burgu për zhvillimin e veprimtarive të punës ose për ndjekjen e kurseve të formimit profesional.

Mund të parashikohet për:

- » të dënuarit përfundimtarë për vepra të zakonshme pa asnjë kufizim lidhur me pozitën juridike e periudhën e kaluar në burg;
- » të dënuarit me burg për një nga veprat e treguara në paragrafin 1 të nenit

- 4 bis op pas 1/3 e dënimit e gjithsesi jo para se të mbushen 5 vjet;
- » të dënuarit me burg të përjetshëm pas vuajtjes të paktën të 10 vjetëve.

Është masë me natyrë administrative, dhënë nga drejtori e miratuar nga gjykatësi mbikëqyrës. Në këtë masë duhet të shënohen rregullat për t'u respektuar jashtë burgut.

Të pandehurit pranohen në punën e jashtme pas autorizimit të autoritetit kompetent gjyqësor.

## SHËNIM

D.l. n°78/2013, i konvertuar në ligj n°94/2013, ka shtuar paragrafin 4 ter tek neni 21 O.P., me qëllimin e qartë që ta bëjë më të hapur.

Sot të burgosurit e të internuarit mund të caktohen të bëjnë aktivitetin e tyre vullnetarisht e falas në ekzekutimin e projekteve me dobishmëri publike në favor të kolektivitetit për t'u zhvilluar pranë shtetit, krahinave, provincave, komunave ose pranë enteve e organizatave të asistencës sociale e vullnetare.

Gjithashtu mund të bëjnë aktivitet – vullnetarisht e falas – në ndihmë të familjeve të viktimave të veprave penale që janë kryer prej tyre.

Këto dispozita nuk u aplikohen të burgosurve dhe të internuarve për veprën penale sipas nenit 416 bis k.p. (organizatë e llojit mafioz edhe të huaja) e për veprat penale të bëra duke shfrytëzuar kushtet e parashikuara nga i njëjti nen ose me qëllim lehtësimin e veprimtarisë së organizatave të parashikuara aty.

## Lirimi i parakohshëm (neni 54 o.p. e neni 103 d.p.r. 230/2000)

Lirimi i parakohshëm (para afatit) jepet nga gjykatësi mbikëqyrës.

Konsiston në reduktimin e dënimit baras me 45 ditë, për çdo 6 muaj dënimi të vuajtur. I jepet atij që ka sjellje të rregullt e që ka dhënë prova për pjesëmarrje në veprën e riedukimit.

Njihet edhe për periudhën e kaluar në paraburgim e në arrest në shtëpi.

Kundër vendimit të gjykatësit mbikëqyrës mund të bëhet ankim në gjykatën e mbikëqyrjes brenda 10 ditëve nga njoftimi i refuzimit duke treguar në kërkesë arsyet.

## SHËNIM Lirimi i parakohshëm (para afatit) i posaçëm

Me D.l. 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014 n. 10 është parashikuar

që, për dy vjet nga hyrja në fuqi e dekretit, ulja e dënimit të dhënë me lirimin e parakohshëm të parashikuar nga neni 54 i Ligjit 26 korrik 1975 n. 354 të jetë baras me shtatëdhjetë e pesë ditë për çdo semestër dënimi të ulur, në rast sjelljeje të mirë (e jo më shumë se 45 ditë). Gjatë konvertimit të ligjit janë përjashtuar nga ky përfitim, ndonëse i mbërthyer në dekretin me kërkesa më të rrepta, të dënuarit për veprat të përfshira në nenin 4bis O.p., d.m.th. ato me alarm më të madh social, duke krijuar një denoncim, për disa, për pabarazi në trajtim. Parashikohet gjithashtu që të dënuarit të cilët, duke filluar nga 1 janar 2010, ta kenë përdorur prej kohësh këtë benefit, t'u njihet për çdo semestër ulja më e madhe prej 30 ditësh, me kusht që gjatë ekzekutimit pas dhënies së benefitit të kenë vazhduar të japin prova pjesëmarrjeje në veprën e riedukimit. Kompetenca është gjithnjë e Gjykatës mbikëqyrës.

## **Gjysmëliria (neni 48 o.p., neni 50 o.p., 50bis o.p. e neni 101 d.p.r. 230/2000)**

Gjysmëliria jepet nga gjykata e mbikëqyrjes.

I lejon të dënuarit të kalojë pjesë të ditës jashtë burgut për të marrë pjesë në veprimtari pune, arsimore e gjithsesi të dobishme për rifutjen në shoqëri.

Kërkesat për ta përfitur:

- » i nënshtruar masës së sigurisë (në çdo çast);
- » i dënuar me arrest ose burg jo më shumë se 6 muaj (në çdo çast);
- » i dënuar me dënim më shumë se 6 muaj e të ketë shlyer gjysmën e dënimit (2/3 për veprat sipas nenit 4 bis, paragrafi 1 op);
- » i dënuar të cilit i është zbatuar përsëritja e ribërë ish neni 99 paragrafi 4 kp pas vuajtjes me 2/3 e dënimit e në rastin e të dënuarit për një nga veprat e treguara në paragrafët 1, 1ter e 1quater të nenit 4bis op pas shlyerjes së ¾ të dënimit.
- » i dënuar me burg të përjetshëm e të ketë vuajtur 20 vjet burg.

### **SHËNIM**

Si efekt i d.l. n°78/2013, konvertuar në ligjin n°94/2013, nuk ekziston më rregulli i mëparshëm në bazë të të cilit të dënuarit të cilëve u është aplikuar rrethana e përsëritjes ish neni 99 paragrafi 4 kp mund të hynin në gjysmëliri vetëm pasi shlyerjes të afateve më të gjata (2/3 e dënimit dhe, në rast të dënuari për ndonjë nga veprat penale të treguara në paragrafët 1, 1ter e 1quater të nenit 4bis op, pas shlyerjes së ¾ të dënimit).

Pranimi në regjimin e gjysmëlorisë bëhet lidhur me përparimet e kryera gjatë trajtimit, kur ekzistojnë kushtet për një rifutje graduale të subjektit në shoqëri.



Personi në gjendje gjysmëlirë del nga burgu në mëngjes e futet sipas orareve të treguara në programin e trajtimit të përgatitur nga drejtori i burgut dhe i miratuar nga gjykatësi mbikëqyrës.

Të dënuarit e të internuarit e pranuar në regjimin e gjysmëlirisë caktohen në burgje ose seksione të posaçme të pavarura nga burgjet e zakonshme.

## SHËNIM

Teksti origjinal i d.l. n°78/2013 e rrezonte rregullin e caktuar nga neni 58 quater paragrafi 7 bis O.P., në bazë të të cilit gjysmëliria dhe përfitime të tjera nuk mund t'i jepen më shumë se një herë të dënuarit të cilit i është aplikuar rrethana e përsëritjes e parashikuar nga neni 99 paragrafi 4 k.p. Ligji i konvertimit n°94/2013 nuk e ka konfirmuar heqjen.

## Qëndrimi në shtëpi (neni 47 ter o.p. e neni 100 d.p.r. 230/2000)

Qëndrimi në shtëpi jepet nga gjykata e mbikëqyrjes.

I dënuari përfundimtar që ka mbushur 70 vjeç mund ta vuajë dënimin me qëndrim në shtëpi në banesën e vet ose në një vend tjetër publik kurimi, asistence e pritjeje në rast se nuk është deklaruar keqbërës i zakonshëm, profesional ose me prirje e nuk është dënuar me rrethana rënduese sipas nenit 99 k.p.

Kjo dispozitë nuk i aplikohet atij që ka kryer e nuk është dënuar me rrethanën rënduese (ish neni 99 paragrafi 4 kp). Me përjashtim të atij që ka bërë veprat e parashikuara nga libri II, titulli XII, kapitulli III, seksioni I (vepra kundër personalitetit individual) e nga nenet 609bis (dhunë seksuale), 609 quater (akte seksuale me të mitur) e 609 octies (dhunë seksuale në grup) të kodit penal e nga neni 51 paragrafi 3bis kpp2 e nga neni 4bis op.

Qëndrimi në shtëpi i aplikohet edhe atij që duhet të vuajë një dënim ose mbetje dënimi më të vogël se 4 vjet në qoftë se është:

- » grua shtatzënë; nënë ose baba (i ati duhet të ushtrojë kujdestarinë, kur nëna ka vdekur ose e ka absolutisht të pamundur t'i ndihmojë fëmijët) i fëmijëve nën 10 vjeç me atë nënën e/o atë babën bashkëjetues (edhe në shtëpitë e familjeve të mbrojtura);
- » person në gjendje të posaçme shëndeti që kërkojnë kontakte të vazhdueshme me spitalet territoriale ose me moshë më shumë se 60 vjeç (në qoftë se është i paafte edhe pjesërisht) ose më pak se 21 vjeç për kërkesa të provuara shëndetësore, studimi, pune e familjare;

Si efekt i d.l. n°78/2013, konvertuar në ligjin n°94/2013, këto rregulla i vihen edhe të dënuarit të cilit i është aplikuar rrethana e përsëritjes ish neni 99 paragrafi 4 k.p. (më parë, vetëm nëse dënimi i dhënë me heqje lirie, edhe kur përbente pjesën e mbetur të dënimit më të madh, nuk i kalonte 3 vitet).

Në këto rrethana të dënuarit të cilit i është zbatuar përsëritja ish neni 99 paragrafi 4 kp mund t'i jepet qëndrimi në shtëpi nëse dënimi i dhënë me burg, edhe nëse përbën pjesën e mbetur të dënimit më të madh, nuk i tejkalon 3 vitet.

Mund ta vuajë dënimin me qëndrim në shtëpi personi me dënim ose mbetje të dënimit jo më shumë se 2 vjet pavarësisht nga kushtet e lart përshkuara në qoftë se nuk ekzistojnë premiset për arritjen e vënies në provë tek shërbimi social e gjithnjë në rast se kjo masë është e përshtatshme për shmangien e rrezikut që i dënuari të kryejë vepra të tjera.

Kjo dispozitë nuk u aplikohet të dënuarve për veprat penale sipas nenit 4 bis O.P.

Përkundrazi, si efekt i d.l. n°78/2013 konvertuar në l. n°94/2013, i jepet të dënuarit të cilit i është aplikuar rrethana e përsëritjes ish neni 99 paragrafi 4 k.p. (më parë, jo).

Qëndrimi në shtëpi revokohet nëse sjellja e subjektit, kundër ligjit ose urdhrave të dhëna, duket i papajtueshëm me vazhdimin e masës, si edhe kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara nga ligji.

Largimi nga vendi i caktuar për qëndrimin në shtëpi plotëson veprën penale të arratisjes.

Dënimi për arratisje sjell revokimin e përfitimit, me përjashtim të rastit kur fakti është me entitet të lehtë.

Ky formulim i normës rrjedh nga ndryshimet e bëra nga d.l. n°78/2013, konvertuar në ligj n°94/2013.

Më parë parashikohej që "denoncimi për veprën penale të arratisjes shkakton pezullimin e përfitimit dhe dënimi shkakton revokimin".

Megjithatë, me vendimin n°173/1997, Gjykata Kushtetuese deklaronte karakterin e paligjshëm kushtetues të normës në pjesën kur bënte që të rridhte automatikisht pezullimin e qëndrimit në shtëpi nga prezantimi i një denoncimi për veprën penale të arratisjes.

Teksti origjinal i d.l. n°78 ka ndërhyrë duke e eliminuar të gjithë dispozitën, në

këtë mënyrë jo vetëm duke ndjekur çka kishte përcaktuar Gjykata Kushtetuese, por madje duke eliminuar rregullën në bazë të së cilës qëndrimi në shtëpi revokohet në rast dënimi për arratisje. Ligji i konvertimit u kthye mbrapsht për këtë pikë të fundit, duke ripërcaktuar revokimin automatik të përfitimit në rast dënimi për veprën penale të arratisjes, por me një risi: ose, “përveç rastit kur fakti është me entitet të lehtë”.

## SHËNIM

Teksti origjinal i d.l. n°78/2013 e rrëzonte rregullin e caktuar nga neni 58 quater paragrafi 7 bis O.P., në bazë të të cilit qëndrimi në shtëpi e të tjera përfitime nuk mund t’i jepen më shumë se një herë të dënuarit të cilit i është aplikuar rrethana e përsëritjes e parashikuar nga neni 99 paragrafi 4 k.p. Por ligji i konvertimit n°94/2013 nuk e ka konfirmuar heqjen.

## Qëndrimi në shtëpi i posaçëm (neni 47 quinquies o.p.)

Jepet nga gjykata e mbikëqyrjes.

Kur nuk janë kushtet e parashikuara nga neni 47 ter, mund t’i jepet nënës në burg me fëmijë nën moshën 10 vjeç pas vuajtjes së një të tretës së dënimit (15 vjet në qoftë se dënimi është burgim i përjetshëm), nëse ekziston mundësia e rivendosjes së bashkëjetesës me fëmijët e nuk ka rrezik konkret të kryerjes së veprave të tjera.

Përveç rasteve ndaj nënave të dënuara për disa nga veprat ish neni 4bis op, shlyerja e të paktën një të tretës së dënimit ose të paktën e 15 vjetëve mund të bëhet pranë një burgu me ruajtje të zbutur për të burgosura nëna ose, në qoftë se nuk ka rrezik konkret për kryerjen e veprave të tjera ose të ikjes, në banesën e vet ose në vend tjetër banimi privat, ose në vend kurimi, asistence e pritjeje, me qëllim që të merret me kujdesjen e ndihmën e fëmijëve. Në rast pamundësie për ta vuajtur dënimin në banesën e vet ose në banesë tjetër private, dënimi mund të shlyhet në shtëpitë e familjeve të mbrojtura, kur ekzistojnë.

Në të njëjtat kushte të parashikuara për nënë kjo masë mund të jepet edhe për babanë e burgosur, në qoftë se nëna ka vdekur ose nuk ka mundësi e nuk është e mundur t’i besohen fëmijët të tjerëve përveç babait.

## SHËNIM

Duke iu referuar të burgosurave nëna kujtojmë se neni 11 paragrafi 9 op përcakton se nënave u lejohet t’i mbajnë pranë vetes fëmijët deri në moshën 3 vjeçare.

Ndërkohë ligji datë 21 prill 2011, n. 62 (duke saktësuar se dispozita të tilla

zbatohen duke filluar nga data e zbatimit të plotë të planit të jashtëzakonshëm të burgut, e gjithësi duke filluar nga 1 janari 2014, përjashtuar mundësia e përdorimit të vendeve të disponueshme sipas legjislacionit në fuqi tek burgjet me ruajtje të zbutur) në fushën e masave të paraburgimit ka përcaktuar se kur të pandehurit janë gra shtatzëna ose nëna me fëmijë nën gjashtë vjeç që bashkëjetojnë me të, ose i ati, në rast se nëna ka vdekur ose nuk ka absolutisht mundësi t'i ndihmojë fëmijët, nuk mund të vendoset as të mbahet në paraburgim, përveç rasteve kur ka kërkesa për paraburgim me rëndësi të jashtëzakonshme.

Në këto raste gjykatësi mund të vendosë qëndrimin pranë një burgu me ruajtje të zbutur.

Mund të vendoset arresti në shtëpi në një shtëpi të familjeve të mbrojtura, nëse ka.

I njëjti ligj ka futur në Ligjin datë 26 korrik 1975, n. 354 neni 21-ter. (Vizita të miturit të sëmurë), duke parashikuar që në rast rreziku kërcënues për jetën ose kushtet të rënda shëndetësore të fëmijës së mitur, edhe jo bashkëjetues, nëna e dënuar, e pandehur ose e internuar, ose i ati që gjendet në të njëjtat kushte të nënës, janë të autorizuar, me vendim të gjykatësit mbikëqyrës ose, në rast urgjence absolute, të drejtorit të burgut, të shkojnë, me kujdesin e parashikuar nga rregullorja, ta vizitojnë të sëmurin.

E dënuara, e pandehura ose e internuara, që është nënë e një fëmije nën dhjetë vjeç, edhe nëse nuk bashkëjeton me të, ose i ati i dënuar, i pandehur ose i internuar, në rast se nëna ka vdekur ose nuk ka absolutisht mundësi t'i ndihmojë fëmijët, janë të autorizuar, me vendim që duhet dhënë nga gjykatësi përkatës brenda njëzetë e katër orëve para datës së vizitës e me mënyrat operative të përcaktuar prej tij, të qëndrojnë me fëmijën gjatë vizitave të specializuara për kushtet e rënda shëndetësore.

## **Mënyra të veçanta kontrolli në ekzekutimin e qëndrimit në shtëpi (neni 58 quinquies o.p.)**

Për sa i përket kontrolleve gjatë zhvillimit të qëndrimit në shtëpi, D.L. 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014 n. 10 ka futur një nen të posaçëm në rregulloren legjislative për burgjet, nenin 58 quinquies, që parashikon se Gjykatësi i mbikëqyrës ose Gjykata e mbikëqyrës mund të urdhërojë procedurën kontrolli me anë të mjeteve elektronike ose mjete të tjera teknike, gjithnjë nëse janë në dispozicion të forcave të rendit (sikurse u pa për kontrollet gjatë masës parandaluese të arrestit në shtëpi).

## Asistenca e jashtme e fëmijëve të mitur (neni 21bis o.p.)

Të dënuarat e të internuarat mund të pranohen në kurimin e në asistencën e jashtme të fëmijëve me moshë nën dhjetë vjeç, sipas kushteve të parashikuara në nenin 21.

Në të njëjtat kushte, masa e asistencës së jashtme mund t'i jepet edhe babait të burgosur, në qoftë se nëna ka vdekur ose nuk ka mundësi e nuk është e mundur t'i besohen fëmijët të tjerëve përveç babait.

### ***L. 26 nëntor 2010, n. 199 e ndryshimet e mëpasshme. Dispozitat për ekzekutimin pranë vendbanimit të dënimeve me burg jo më shumë se 18 muaj.***

D.L. 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014 n. 10 ka stabilizuar masën që lejon të vuash pranë vendbanimit heqjen e lirisë jo më të madhe se 18 muaj, që ndryshe nuk do të ishte më e zbatueshme nga 1 janari 2014, meqë është fillimisht e parashikuar deri në zbatimin e plotë të planit të jashtëzakonshëm të burgjeve e gjithsesi jo më tej se 31 dhjetori 2013. Parashikimi i posaçëm ishte futur me ligjin n. 199 /2010 (që e kufizonte dënimin me një vit, pastaj i çuar në 18 muaj nga D.L. n. 211 i vitit 2011 konvertuar në Ligjin n. 9/2012).

Dënimi me heqje lirie jo më i madh se 18 muaj, edhe kur përbën pjesën e mbetur të dënimit më të madh, mund të ekzekutohet pranë banesës së të dënuarit ose tjetër vend publik ose privat kurimi, asistence ose pritjeje (si vendbanim duhet nënkuptuar banesa ose tjetër vend publik ose privat kurimi, asistence ose pritjeje).

Gjykatësi mbikëqyrës vendos pa vonesë për kërkesën në qoftë se i ka informacionet e duhura.

Kjo dispozitë nuk zbatohet:

- a) për subjektet e dënuara për një nga veprat ish neni 4bis i ligjit datë 26 korrik 1975, n. 354, e ndryshimet e mëpasshme;
- b) keqbërësve të zakonshëm, profesionistë e me prirje, sipas neneve c) 102, 105 e 108 të kodit penal;
- d) të burgosurve që i nënshtrohen regjimit të mbikëqyrjes së posaçme, sipas nenit 14bis të ligjit 26 korrik 1975, n. 354, përveç rasteve kur është pranuar ankimi i parashikuar në nenin 14 ter të të njëjtit ligj;
- e) kur ekziston mundësia konkrete që i dënuari mund të ikë ose ekzistojnë arsye specifike e të motivuara për të menduar se i dënuari mund të kryejë vepra të tjera ose kur nuk ekziston përshtatshmëria dhe efektshmëria e vendbanimit edhe në funksion të kërkesave të tutelës së personave të ofenduar nga vepra penale.

Drejtoria e burgut, edhe pas kërkesës së të burgosurit ose të avokatit të tij, i transmeton gjykatësit mbikëqyrës një raport për sjelljen e mbajtur gjatë burgimit, i pajisur me një procesverbal për kontrollin e përshtatshmërisë së vendbanimit.

Masa e refuzimit mund të kundërshtohet para gjykatës së mbikëqyrjes.

## **Vënia në provë tek shërbimet sociale në raste të veçanta (neni 94 d.p.r. 309/1990 e neni 99 d.p.r. 230/2000)**

Kërkesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së mbikëqyrjes.

Mund të pranohet personi toksikoman e/o i alkoolizuar, me dënim ose mbetje dënimi më pak se 6 vjet (4 në qoftë se janë për vepra sipas nenit 4 bis op), që të ketë në vijim e sipër një program rikuperimi ose që dëshiron t'i nënshtrohet një programi (dakord me shërbimin e toksikomanisë të AUSL të tij).

Masa mund të jepet maksimumi dy herë (në marrëveshje me shërbimin e toksikomanive të AUSL të territorit ku ka rezidencën).

Masa mund të jepet edhe më shumë se 2 herë.

D.L. 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014 n. 94 n. 10 e ka ndryshuar nenin 94 të D.P.R. 309/90, duke hequr paragrafin e 5-të që parashikonte se vënia në provë në raste të veçanta nuk mund të vendosej më shumë se dy herë. Ky ndryshim, duke hequr ndalimin e dhënies së vënies në provë terapeutike tek shërbimi social pas herës së dytë, kërkon të favorizojë gjithsesi rikuperimin e personave toksikomanë, më të ekspozuar ndaj mospësuksit të masës alternative si efekt i brishtësisë së gjendjes së tyre.

## **Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për toksikomanët ose të alkoolizuarit (neni 90 e vijues d.p.r. 309/1990)**

Gjykata e mbikëqyrjes mund ta pezullojë ekzekutimin e dënimit për pesë vjet atij që duhet të vuajë një dënim ose një mbetje dënimi jo më shumë se 6 vjet (4 në qoftë se janë të dënuar për vepra sipas nenit 4 bis op) për vepra të kryera në lidhje me gjendjen e toksikomanisë/varësisë nga alkooli nëse personi i është nënshtuar me përfundim pozitiv një programi terapeutik e socio – rehabilitues pranë një strukture publike ose të autorizuar sipas ligjit.

Në këtë rast dënimi mbetet i pezulluar për 5 vjet e shuhet, me çdo efekt tjetër penal, në qoftë se nuk kryhet vepër jo me pakujdesi e dënueshme me burgim (përndryshe revokohet).

## **Vënia në provë tek shërbimet sociale (neni 47 o.p. e nenet nga 96 tek 98 d.p.r. 230/2000)**

Kërkesa i drejtohet gjykatësit mbikëqyrës e jepet nga gjykata e mbikëqyrjes. Në qoftë se dënimi ose mbetja e dënimit është më pak se tre vjet, pasi vlerësohen rezultatet e vëzhgimit të personalitetit, subjekti mund t'i besohet shërbimit social për periudhën e dënimit që duhet shlyer ende, në rastet kur mund të mendohet se masa kontribuon për rifutjen e fajtorit e të sigurojë parandalimin e përsëritjes: në këtë periudhë do të ndiqet nga zyra e ekzekutimit penal të jashtëm.

Përfundimi pozitiv i periudhës së kaluar në besim e shuan dënimin e çdo efekt tjetër penal me vendim të gjykatës së mbikëqyrjes.

Mund të jepet lirimi i parakohshëm në qoftë se ka dhënë prova për rifutjen efektive në shoqëri.

Gjykata e mbikëqyrjes, në rast se i interesuari gjendet në kushte të vështira ekonomike, mund ta deklarojë të shuar edhe dënimin me parà që nuk është marrë ende.

### **SHËNIM**

Pranë parashikimit të caktuar të dënimit të caktuar me 3 vjet burgim, edhe si dënim i mbetur, për të hyrë në masën alternative, D.L. 23/12/2013 n.146 konv. L. 21/2/2014 n. 10 ka futur mundësinë që të arrihet përfitimi edhe kur caku i dënimit, edhe të mbetur, është baras me 4 vjet, të gjitha herët kur është e mundur të vlerësohet pozitivisht sjellja e mbajtur nga i dënuari gjatë vitit të mëparshëm, pavarësisht nga fakti se periudha ka kaluar në shlyerje të dënimit me heqje lirie, në masë parandaluese ose në liri.

Me qëllim që të nxitet përdorimi i vënies në provë parashikohet atribuimi i pushtetit në favor të gjykatësit mbikëqyrës, në qëllim që të zbatohet në mënyrë urgjente vënien në provë tek shërbimi social, kur ekziston një paragjykim i rëndë në vazhdimin e gjendjes së heqjes së lirisë e nuk ka rrezik largimi, me përjashtim kur vendos Gjykata e Mbikëqyrjes.

## **Pezullimi me kusht i dënimit e ashtuquajtur “falje e vogël” (“indultino” - ligji 207/03)**

Ai që ka vuajtur të paktën gjysmën e dënimit e duhet të shlyejë ende maksimumi 2 vjet për një dënim të bërë përfundimtar para datës 22 gusht 2003, mund të përftojë të ashtuquajturën “falje e vogël”, d.m.th. të dalë nga burgu para kohe, por duke iu nënshtruar detyrimeve me natyrë të ndryshme. Ka kufizime (për shembull nuk mund të kërkohet nga ata që janë dënuar për vepra penale të caktuara). Vendos gjykatësi mbikëqyrës.

### **E RËNDËSISHME:**

Në qoftë se nuk konsiderohet i drejtë vendimi, duhet bërë ankim në gjykatën e mbikëqyrjes brenda 10 ditëve nga çasti kur merret akti që refuzon kërkesën, duke treguar edhe arsyet.

## **Lirimi me kusht (neni 176 o.p. e neni 682 kpp)**

Mund t'i njihet atij që ka vuajtur të paktën 30 muaj e gjithsesi të paktën 1/2 e dënimit të dhënë në rast se pjesa e mbetur e dënimit nuk i kalon 5 vjetët (nëse përsëritës të paktën 4 vjet dënim e jo më pak se 3/4-at; nëse i dënuar me burgim të përgjithshëm vitet e vuajtura duhet të jenë të paktën 26).

Për ta fituar personi duhet të ketë mbajtur, gjatë kohës së dënimit, një sjellje të tillë që ta konsiderojë të sigurtë pendesën. Varet nga përmbushja e detyrimeve civile që rrjedhin nga vepra sipas neneve 185 e vijuese të k.p. (kthime e dëmshpërblim), përveç rasteve kur tregohet pamundësia për t'i përmbushur. Vendos gjykata e mbikëqyrjes.

Ndaj të dënuarit që i jepet lirimi me kusht mbetet pezull ekzekutimi i masës së sigurisë në burg të cilës vetë i dënuari i është nënshtruar me vendim dënimi ose me masë të mëpasshme.

Lirimi me kusht revokohet, në qoftë se personi kryen vepër ose kundërvajtje me të njëjtën natyrë, ose shkel detyrimet që lidhen me lirinë e mbikëqyrur. Në këtë rast koha e kaluar në liri me kusht nuk përlogaritet në kohëzgjatjen e dënimit dhe i dënuari nuk mund të ripranohet në lirim me kusht.

Pasi kalon e gjithë koha e dënimit të dhënë, ose 5 vjet nga data e masës së lirim me kusht, në qoftë se bëhet fjalë për të dënuar me burgim të përgjithshëm, pa ndodhur asnjë shkak për revokim, dënimi mbetet i shuar e revokohen masat e sigurisë personale, të urdhëruara nga gjykatësi me vendimin e dënimit ose



me vendim të mëpasshëm.

## Dëbimi si masë alternative “jo tipike” e burgimit

Qytetari i një shteti jo anëtar i Bashkimit europian, i pranishëm në Itali në mënyrë të parregullt, i burgosur për një dënim përfundimtar me dënim – ose mbetje dënimi për të vuajtur – më pak se dy vjet (me përjashtim të veprave veçanërisht të rënda), mund të bëjë kërkesë për dëbim nga territori kombëtar drejtuar gjykatësit mbikëqyrës.

Gjykatësi mbikëqyrës mund të procedojë sipas vendimit të tij.

Bëhet fjalë për një sanksion alternativ ndaj burgut, parashikuar në nenin 16, paragrafi 5, i Tekstit të vetëm për imigracionin (Dekreti Legjislativ datë 25 korrik 1998, n. 286, e ndryshimet e mëpasshme).

Dëbimi nuk mund të bëhet në rastet kur dënimi u përket një ose disa veprave veçanërisht të rënda (ato që janë renditur hollësisht në nenin 407, paragrafi 2 shkronja a) i kodit të procedurës penale, ose shkatërrim, plaçkitje e masakër; luftë civile; organizatë e llojit mafioz; organizatë kriminale me qëllim kontrabandën e cigareve; vrasje (edhe në tentativë); vjedhje me dhunë e shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë (edhe në tentativë); mbajtje peng e personit; terrorizëm e subversion; trafik ose mbajtje armësh lufte; trafik e mbajtje lëndësh narkotike, në grup ose të rënduar; vepra lidhur me prostitucionin e të miturve e me pedo-pornografinë; veprat penale seksuale; gjithashtu për vepra penale të parashikuara nga T.U. për imigracionin të shënuara në nenin 12, paragrafët 1, 3, 3 bis, 3 ter).

Dëbimi vendoset nga gjykatësi mbikëqyrës, me dekret të motivuar, të cilin i huaji mund ta kundërshtojë brenda dhjetë ditëve tek gjykata e mbikëqyrjes.

Deri në mbarimin e afatit, ose, në qoftë se është bërë kundërshtimi (ku mund të thuhet se gjendet në kushte në të cilat nuk mund të dëbohet), deri në vendimin e gjykatës së mbikëqyrjes dëbimi nuk mund të realizohet.

Paraprakisht është e nevojshme që të vërtetohet përfundimisht identiteti i tij e që autoritetet e vendlindjes të kenë lëshuar dokumentet e nevojshme për riatdhesimin.

Pra në qoftë se qytetari i huaj e ka kërkuar dëbimin, mund të nevojitet që ai vetë t'i gjejë dokumentet eventuale të identitetit, për ta ulur kohën e vendimit të kërkesës.

Ky dëbim duhet bërë gjithnjë me shoqërim të menjëhershëm në kufi, e qytetari i huaj mbetet në burg derisa nuk është e mundur të bëhet dëbimi, d.m.th. deri sa të merren dokumentet e udhëtimit.

Në rast se dënimi është vuajtur tërësisht në burg, ky dëbim nuk mund të bëhet më (por kuestori gjithsesi mund të urdhërojë dëbimin administrativ të të huajit

të parregullt).

Që kur ky dëbim është bërë, të huajit i ndalohet hyrja në Itali për dhjetë vjet; pas dhjetë vjetësh, në qoftë se qytetari i huaj nuk ka hyrë në Itali, dënimi shuhet (ose konsiderohet si i vuajtur tërësisht). Në të kundërt, në qoftë se i huaji rihyn në mënyrë të paligjshme para mbarimit të afatit prej dhjetë vjetësh e rifillon menjëherë ekzekutimin e dënimit (qytetari i huaj çohet në burg për të vuajtur pjesën e mbetur që ishte zëvendësuar me dëbim).

#### SHËNIM

Ekziston edhe hipoteza e dëbimit që vendoset gjatë procedimit sipas nenit 16 par. 1 Teksti i vetëm për imigracionin nga gjykatësi në çastin e vendimit ose në rast kompromisi, në rastin kur nuk mund të jepet pezullimi me kusht i dënimit dhe dënimi vetë të mos kalojë dy vitet – dëbimi në cilësinë e sanksionit zëvendësues të burgimit.

#### SHËNIM

Nuk mund të dëbohen (neni 19 D.L.v 286/1998) qytetarët ekstrakomunitarë që mund të persekutohen, në vendin e tyre, për arsye racore, fetare, politike, ose për kushte shoqërore ose personale, ose në qoftë se ekziston rreziku që qytetarët të dërgohen në një vend tjetër ku mund të persekutohen. Nuk mund të dëbohen qytetarët e huaj të mitur nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, ose të pajisur me kartë qëndrimi të lëshuar nga autoritetet italiane, ose bashkëjetues me kushërinj ose bashkëshort italianë, ose gra shtatzëna ose me fëmijë të lindur prej më pak se gjashtë muajsh.

#### SHËNIM

D.L. 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014 n. 10 ka ndikuar edhe mbi disiplinimin e dëbimit si sanksion alternativ ndaj heqjes së lirisë, i apelueshëm ndaj të burgosurve qytetarë të shteteve që nuk bëjnë pjesë në Bashkimin europian. Në realitet bëhet fjalë për një masë që nuk i ka veçoritë e masës alternative, duke qenë se mund të bëhet me nismën e vet, pa pëlqimin e të interesuarit e pa vlerësimin e çështjes. Mund të jetë një mjet i dobishëm për deflacionin e burgjeve.

Ndryshimi ka të bëjë me nenin 16 par. 5 Dekreti Legjislativ n. 286/1998.

Parashikohet një procedurë që ka si qëllim identifikimin e plotë të të huajit që nga arrestimi, me qëllim që të lehtësohet vendimi i autoritetit gjyqësor e të mundësohet dëbimi, që ka si premisë identifikimin e saktë të të huajit, kontroll shpesh jo i thjeshtë edhe për mungesë të bashkëpunimit të vendeve të prejdhjes.

Kjo duhet të shmangte zhvillimin në CIE të procedurave të identifikimit.

Shtrihet zona aplikuese e sanksionit, që parashikon pikërisht dëbimin për të

burgosurit e huaj që nuk bëjnë pjesë në BE, kur dënimi i mbetur është baras ose më pak se 2 vjet burgim, edhe për veprat penale më pak të rënda të parashikuara nga Teksti Unik në lëmin e imigracionit dhe për veprat penale, të kryera ose në tentativë, të grabitjes së rënduar (neni 628, paragrafi i tretë, kp) dhe shtërngimit të rënduar me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë (neni 629, paragrafi i dytë, kp).

Zgjidhet çështja, shumë e diskutueshme në jurisprudencë, për mundësinë për të vendosur dëbimin, pasi është shkrire grumbullimi i dënimeve, në rastin kur ka tituj të veprave penale penguese. Në rast bashkëfajësie veprash penale ose unifikimi të dënimeve të ndërthurura, edhe në këto raste do të jetë e mundur të vendoset dëbimi, kur është shlyer pjesa e dënimit lidhur me dënimin për vepra që nuk e lejojnë, me rritjen e përdorimit të këtij mjeti ligjor.

## Lejet e shpërblimit (neni 30 ter o.p.)

Lejet e shpërblimit mund të kërkohen nga të dënuarit që kanë pasur sjellje të rregullt e që nuk rezultojnë të rrezikshëm nga pikëpamja shoqërore me qëllim që të kultivojnë interesa afektive, kulturore e pune.

**Kërkesa** - i duhet drejtuar gjykatësit mbikëqyrës i cili, pasi merr mendimin e detyrueshëm por jo detyrues të drejtorit të burgut, mund të japë leje shpërblimi me kohëgjatësi jo më shumë se 15 ditë e në çdo rast për jo më shumë se 45 ditë për çdo vit shlyerje dënimi.

Përvoja e lejeve të shpërblimit është pjesë përbërëse e programit të trajtimit e duhet ndjekur nga edukatorët e asistentët socialë të burgut në bashkëpunim me operatorët socialë të territorit.

**Kërkesat (kushtet)** – kjo pjesë e normativës për lejet e shpërblimit është ndryshuar nga d.l. n°78/2013, konvertuar nga ligji n°94/2013.

Sot, dhënia e lejeve pranohet për:

- a) të dënuarit me arrest ose me burg jo më shumë se katër vjet (më parë ishin 3), edhe kur bashkohet me arrestin.
- b) të dënuarit me burg më shumë se 4 vjet (më parë ishin 3), pas vuajtjes të paktën e çerekut të dënimit e me përjashtim të asaj që parashikohet për të dënuarit sipas nenit 4 bis O.P.
- c) të dënuarit me burg për veprat penale të treguara në nenin 4 bis paragrafi 1, 1ter e 1quater O.P., pas vuajtjes së gjysmës së dënimit e

gjithsesi jo më shumë se 10 vjet.

d) të dënuarit me burg të përjetshëm pas vuajtjes të paktën të 10 vjetëve.

D.l. n°78, konvertuar nga ligji n°94/2013 e ka shtuar edhe kohëgjatësinë e lejeve të shpërblimit për të miturit (kalohet nga 20 deri 30 ditë për çdo leje të veçantë e nga 60 në 100 ditë gjithsej në çdo vit vuajtje dënimi).

Vendimi për lejet e shpërblimit mund të ankimohet brenda 24 orëve nga komunikimi në gjykatën e mbikëqyrjes.

## **Dhënia e lejeve të shpërblimit përsëritësve (neni 30 quater o.p.)**

Ky nen është futur nga ligji datë 5 dhjetor 2005 n. 251 (i ashtuquajtur ish Cirielli) e përcakton se lejet e shpërblimit mund t'u jepen të burgosurve, të cilëve u është zbatuar përsëritja e parashikuar në nenin 99 paragrafi 4 k.p. vetëm pas shlyerjes së një periudhe kohore më të madhe kundrejt asaj të të burgosurve të tjerë.

Teksti origjinal i dekret ligjit n°78/2013 ka parashikuar më pas abrogimin e kësaj dispozite, por ligji i konvertimit ka futur sërish kufizimet fillestare.

Si rrjedhim, lejet e shpërblimit mund t'u jepen të burgosurve të cilëve u është aplikuar rrethana e përsëritjes në kushtet e mëposhtme:

- a) të dënuarve me arrest ose me burg jo më shumë se katër vjet, edhe në rast se është i bashkuar me arrestin, pas vuajtjes së një të tretës së dënimit;
- b) të dënuarve me burg më shumë se 4 vjet, pas vuajtjes së gjysmës së dënimit e përveç rasteve të parashikuara për të dënuarit sipas nenit 4 bis O.P.
- c) të dënuarve me burg për veprat penale të treguara nga neni 4 bis paragrafi 1, 1 ter e 1 quater O.P. pas vuajtjes së dy të tretave të dënimit dhe, gjithsesi, të jo më shumë se pesëmbëdhjetë vitet.
- d) të dënuarve me burg të përjetshëm, pas vuajtjes së dy të tretave të dënimit e, gjithsesi, të jo më shumë se pesëmbëdhjetë vitet.

## Leje për arsye të rënda familjare (neni 30 o.p.)

Në rast rreziku kërcënues për jetën të një familjari ose të një bashkëjetuesi, gjykatësi mbikëqyrës mund t'u japë të dënuarve e të internuarve leje për t'i bërë vizitë të sëmurit, me kujdesin e parashikuar nga rregullorja e me shoqërues.

Për të pandehurit, gjatë procedimit të shkallës së parë, leja mund të jepet nga gjykatësi nga i cili varet procesi, pas vendimit të shkallës së parë nga kryetari i gjykatës së apelit.

Lejet mund të jepen në raste të jashtëzakonshme për ngjarje familjare me rëndësi të veçantë.

I burgosuri që nuk kthehet në burg në mbarim të lejes pa arsye të motivuar dënohet me masë disiplinore në qoftë se mungesa zgjatet për më shumë se 3 orë e jo më shumë se 12 orë.

Në rastet e tjera dënohet për veprën e arratisjes ish neni 385 kp.

## Shtojca kapitulli 4

Neni 146 kp Shtyrja e detyrueshme e ekzekutimit të dënimit

Ekzekutimi i dënimit, që nuk është me gjobë, shtyhet në qoftë se:

- 1) bëhet kundrejt gruas shtatzënë;
- 2) bëhet ndaj nënës me fëmijë me moshë nën një vjeç;
- 3) bëhet ndaj personit të prekur nga sëmundja AIDS e shpallur ose nga pamjaftueshmëria e rëndë imunitare të vërtetuara sipas nenit 286-bis, paragrafi 2, i kodit të procedurës penale, ose nga sëmundje tjetër veçanërisht e rëndë për shkak të së cilës gjendja e tij shëndetësore rezultojnë të papajtueshme me gjendjen e burgut, kur personi gjendet në një fazë të sëmundjes aq të përparuar sa nuk reagon më, sipas vërtetimeve të shërbimit shëndetësor të burgut ose të jashtëm, ndaj trajtimeve të disponueshme e terapive kuruese.

Në rastet e parashikuara nga numrat 1) e 2) të paragrafit të parë shtyrja nuk bëhet ose, në qoftë se është lejuar, hiqet nëse shtatzënia ndërpritet, në qoftë se nëna deklaroheq që e ka humbur të drejtën e kujdestarisë së fëmijës sipas nenit 330 të kodit civil, fëmija vdes, braktiset ose u besohet të tjerëve, gjithnjë nëse ndërprerja e shtatzënisë ose lindja kanë ndodhur përtej dy muajve.

Neni 147 kp Shtyrja fakultative e ekzekutimit të dënimit.

Ekzekutimi i dënimit mund të shtyhet në qoftë se:

- 1) paraqitet kërkesë për falje, dhe ekzekutimi i dënimit nuk duhet shtyrë sipas nenit të mëparshëm;
- 2) dënimi që kufizon lirinë personale duhet kryer ndaj atij

që gjendet në kushtet e sëmundjes së rëndë fizike;  
3) dënimi që kufizon lirinë personale duhet kryer ndaj nënës me fëmijë nën moshën tre vjeç.

Në rastin e treguar në n. 1, ekzekutimi i dënimit nuk mund të shtyhet për një periudhë më shumë në tërësi se gjashtë muaj, duke filluar nga dita kur vendimi u bë i përvokueshëm, edhe pse kërkesa për falje bëhet më vonë.

Në rastin e treguar në numrin 3) të paragrafit të parë masa revokohet, në qoftë se nëna deklorohet se e ka humbur të drejtën e kujdestarisë së fëmijës sipas nenit 330 të kodit civil, fëmija vdes, braktiset ose u besohet të tjerëve e jo nënës.

Masa sipas paragrafit të parë nuk mund të merret ose, në qoftë se merret, revokohet nëse ekziston rreziku konkret i kryerjes së veprave penale.

### Vepra të përmendura në nenin 51 paragrafi 3-bis kpp

Veprat, e kryera ose të mbetura në tentativë, sipas neneve 416, paragrafi i gjashtë (organizatë kriminale me qëllim vënien ose mbajtjen në skllavëri ose në robëri; trafikim i njerëzve; blerje e shitje e sklllevërve; nxitje e organizim i imigracionit klandestin në rrethana të veçanta), 416, i realizuar me qëllim kryerjen e veprave të parashikuara në nenet 473 (falsifikim, ndryshim ose përdorim markash ose shenjash dalluese ose patentash shpikjesh, modelesh e vizatimesh) e 474 (futje në shtet e tregti produktesh me shenja false) , 600 (vënie e mbajtje në skllavëri), 601 (trafikim njerëzish), 602 (blerje e shitje sklllevërish), 416-bis (organizatë e llojit mafioz edhe të huaj) e 630 (mbajtje peng e personit me qëllim shtërëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë) e kodit penal, për veprat e kryera duke përfutuar nga kushtet e

parashikuara në nenin e parathënë 416-bis ose me qëllim që të lehtësohet veprimtaria e organizatave e parashikuar në të njëjtin nen, si dhe për veprat e parashikuara në nenin 74 (organizatë me qëllim trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike ose psikotrope) të tekstit të vetëm të miratuar me dekret të Presidentit të Republikës 9 tetor 1990, n. 309, në nenin 291-quater (organizatë kriminale me qëllim kontrabandën e cigareve të përpunuara të huaja) të tekstit të vetëm të miratuar me dekret të Presidentit të Republikës datë 23 janar 1973, n. 43, e në nenin 260 (veprimtari organizative për trafikun e paligjshëm të mbeturinave) të dekretit legjislativ datë 3 prill 2006, n. 152.





## TË DREJTAT DHE DETYRAT E TË BURGOSURIT

Kontakti i parë me burgun zhvillohet në zyrën e amzës, ku merren shenjat e gishtave, shënohen të dhënat personale e bëhen fotografitë.

Gjithashtu, subjekti duhet të deklarojë nëse ka probleme bashkëjetese me të burgosurit e tjerë me qëllim që të mbrojë pacenueshmërinë personale.

Më pas tërhiqen paratë, ora, rripi, të gjitha sendet me vlerë (unaza, varëse, etj.) e sendet e tjera që kanë nevojë për kontroll: më vonë, me anë të kërkesës me shkrim në adresë të drejtorit, mund të arrihet kthimi i rripit e i orës në qoftë se nuk kanë vlerë të madhe.

Paratë e tërhequra do të regjistrohen në një “librezë” me llogari rrjedhëse, në të cilën tregohet shuma që i burgosuri ka e që do të përditësohet me të gjitha tërheqjet e derdhjet e mëpasshme. Paratë mund të merren nëpërmjet mandapostës ose depozitës e përdoren për të blerë artikuj ushqimorë; për të telefonuar, etj

### Vizita mjekësore e biseda psikologjike

Zhvillohet një vizitë mjekësore ku është mirë që personi t'i referojë mjekut në mënyrën më të detajuar të mundshme, duke dorëzuar edhe dokumentacionin përkatës, për:

- » marrjen e mundshme e të zakonshme të barnave;
- » problemet e mundshme të shëndetit, të alergjisë o tjetër;
- » vartësitë e mundshme nga lëndët narkotike e/o alkooli;
- » intolerancat e mundshme ushqimore ose nevojën për dieta specifike.

Pas vizitës mjekësore zhvillohet një bisedë me psikologun për të nxjerrë problematikat e mundshme për situatën e burgut që po jeton.

Me vizitën mjekësore e bisedën me psikologun mbarojnë veprimet e hyrjes dhe personi shoqërohet në qelinë e tij.

Në këtë pikë agjenti i policisë së burgut do t'i japë për firmë të burgosurit një letër ku përshkruhen kushtet e qelisë: është nevoja që të kontrollohen nëse efektivisht të gjitha sendet janë në kushtet e përshkuara, sepse dëmet e

mundshme që vihen re më vonë, gjatë ose në fund të burgimit do t'i ngarkohen të burgosurit.

Sapo hyn në burg, edhe në rast transferimi, i burgosuri ka të drejtë t'i informojë familjarët se gjendet në një burg të caktuar e kjo mund të bëhet me telegram, ose me letër.

**Shpenzimet postare janë në ngarkim të të burgosurit por, në qoftë se ky nuk ka para të mjaftueshme, merret administrata me dërgimin e letrës ose të telegramit. Sendet e nevojshme (pulla e letra, ose dërgimi i telegramit) duhen kërkuar me kërkesë të posaçme me shkrim ku duhet specifikuar mungesa e parave.**

Në qoftë se i porsaardhuri është pa avokat të besuar, mund të emërojë një avokat nëpërmjet zyrës së amzës ku gjen edhe regjistritin e avokatëve të rrethit. Zyra e amzës i komunikon konsullatës ose ambasadës së vendlindjes të të burgosurit të huaj praninë në burg pasi merr pëlqimin e të burgosurit vetë, pëlqim që nuk kërkohet për vendet për të cilat komunikimi është i detyrueshëm.

## Personeli i burgut

Brenda burgut ka disa figura profesionale:

- » drejtori;
- » zv/drejtorët;
- » komandanti i repartit të policisë së burgut;
- » përgjegjësi i edukimit dhe edukatorët;
- » psikologu;
- » psikiatri;
- » operatorët e Ser.T. (Shërbimi Territorial për toksikomanitë);
- » kapelani e operatorët fetarë;
- » përgjegjësi i sektorit shëndetësor, mjekët e infermierët;
- » përgjegjësi i sektorit administrativo-kontabël e llogaritarët;

### *Drejtoria*

Përbëhet nga drejtori e nga stafi i zv/drejtorëve: kanë përgjegjësinë e drejtimit e të administrimit korrekt të burgut.

Drejtori i burgut siguron mbajtjen e sigurisë e të respektit të rregullave nëpërmjet personalit të burgut (neni 2 D.P.R. 30 qershor 2000, n. 230) dhe ushtron pushtetin lidhur me organizimin, koordinimin e kontrollin e zhvillimit të veprimtarive të burgut. Vendos gjithashtu, për nismat e duhura për sigurimin e zhvillimit të programeve në burgje, për ndërhyrjet jashtë burgut e për direktivat

që i duhen dhënë operatorëve të burgut (neni 3 p. 2 D.P.R. 30 qershor 2000, n. 230)

Mund të kërkohet, me letër ose “kërkesë të vogël”, që të flitet me drejtorin ose zv/drejtorët për t’u paraqitur atyre problemet personale ose ankimet për kushtet e veta në burg.

### ***Policia e burgut***

Shërbimi i sigurisë dhe i ruajtjes në burgje i besohet policisë së burgut (neni 2 p. 2 D.P.R. 30 qershor 2000, n. 230))

Policia e burgut, gjithashtu, pret e siguron ekzekutimin e masave shtrënguese të lirisë personale, merr pjesë, edhe në kuadrin e grupeve të punës, në veprimtarinë e vëzhgimit e të trajtimit riedukues të burgosurve e të atyre që vuajnë një masë sigurie në burg, kryen shërbimin e përkthimit e shërbimin e kontrollit në vendet e jashtme të kurimit të të burgosurve e ata që vuajnë një masë sigurie në burg.

### ***Edukatori profesionist e trajtimi***

Është figura që përgatit, organizon e koordinon veprimtaritë e brendshme lidhur me shkollën, punën, nismat kulturore, zbavitëse e sportive, në bashkëpunim me operatorët e tjerë.

Në kuadrin e ekipit të vëzhgimit e të trajtimit, merr pjesë në përcaktimin e rrugës që synon kërkimin nga ana e të burgosurit të dimensionit të vet brenda kontekstit shoqëror. Vëzhgimi drejtohet nga një ekip, i përbërë nga shumë anëtarë, të cilët veprojnë sipas një qasje të integruar e që, zakonisht, janë drejtori i burgut, edukatori, asistenti social, eksperti ish neni 80 op (psikologu, kriminologu etj.) e agjentët e policisë së burgut. Gjithashtu, bashkëpunojnë në veprimtaritë e vëzhgimit e të trajtimit shëndetësor, vullnetarët, kapelani e mësuesit në kuadrin e një grupi të zgjeruar i quajtur Grupi i vëzhgimit dhe i trajtimit (G.O.T.). Edukatori e zhvillon punën e vet duke e koordinuar veprimin e tij me atë të gjithë personelit të ngarkuar me veprimtaritë e riedukimit dhe bashkëpunon gjithashtu në mbajtjen e bibliotekës e në shpërndarjen e librave, revistave e gazetave (neni 82 p. 3 op)

Siç përcaktohet në nenin 1 op, trajtimi në burg duhet të jetë:

- » në përputhje me humanizmin
- » respektues për dinjitetin e personit
- » nuk duhet të ketë asnjë formë diskriminimi
- » me synim riedukimin e integrimin shoqëror
- » i zbatuar sipas kriterit të individualizimit në lidhje me karakteristikat specifike e kushtet e subjektit.

Në veçanti neni 13 i ligjit të lartpërmendur thotë se trajtimi duhet të ketë

parasysh nevojat e personalitetit të secilit subjekt, që në bazë të vëzhgimit shkencor përpilohet programi i trajtimit, i cili mund të plotësohet ose të ndryshohet sipas kërkesave që verifikohen gjatë ekzekutimit.

Udhëzimet e përgjithshme e të veçanta të trajtimit, zhvillimet e rezultate e tij të mëpasshme, futen në dosjen personale të të burgosurit.

Neni 15 op përcakton elementet e trajtimit në arsim, punë, fe, veprimtari kulturore, zbavitëse e sportive, kontaktet e duhura me botën e jashtme dhe marrëdhëniet me familjen e nënvizon se me objektivin e trajtimit riedukues të dënuarit e të internuarit i sigurohet puna, përveç rasteve kur nuk është e mundur. Mënyrat e trajtimit që duhen ndjekur në çdo burg disiplinohen nga rregullorja e brendshme (neni 16 op)

Ligji i datës 1 tetor 2012, n. 172 ka futur në ligjin e 26 korrikut 1975, n. 354 neni 13bis – Trajtimi psikologjik për të dënuarit për krime seksuale në dëm të të miturve – që parashikon se personat e dënuar për krimet sipas neneve 600bis (prostitucion me të mitur), 600 ter (pornografi me të mitur), edhe kur ka të bëjë me material pornografik sipas nenit 600quater.1 – pornografi virtuale), 600 quinquies (nisma turistike për shfrytëzimin e prostitucionit të të miturve), 609 quater (akte seksuale me të mitur), 609 quinquies (korrupsion i të miturve), 609 undecies (joshje e të miturve) i kodit penal, si dhe nenet 609bis (dhunë seksuale) e 609 octies (dhunë seksuale në grup) të të njëjtit kod penal, në qoftë se bëhen në dëm të personit të mitur, mund t'i nënshtrohen trajtimit psikologjik me qëllim rikuperimin e mbështetjen. Pjesëmarrja në këtë trajtim vlerësohet nga gjykatësi mbikëqyrës ose nga gjykata e mbikëqyrjes, që vlerëson pjesëmarrjen pozitive të programit të rehabilitimit specifik, sipas nenit 4bis, paragrafi 1 quinquies, të këtij ligji, në kuadrin e dhënies së përfitimeve të burgut.

### ***Operatori i Ser.T (Shërbimi Territorial për toksikomanitë)***

Është punonjës i AUSL por çdo ditë zhvillon veprimtarinë e vet edhe në burg për ndihmën e të burgosurve që kanë probleme vartësie nga drogat ose alkooli. Ky operator zhvillon asistencë shëndetësore e rehabilituese, nëpërmjet bisedave orientuese e përgatitëse të programeve terapeutike, edhe të bashkërenduara me Ser.T. përkatës.

### ***Zyrat e ekzekutimit penal të jashtëm***

U.E.P.E. merret me marrëdhëniet e të burgosurit me mjedisin e tij të jashtëm (familjar, të punës, të banimit, etj.) e me problematikat e mundshme që mund të ekzistojnë në këtë kontekst. Në këtë drejtim nxit kontaktet me burimet e jashtme dhe shërbimet territoriale për ta ndihmuar personin që të përballojë vështirësitë që lidhen me to, si në rastin e pranimit të përfitimeve ligjore (masat

e posaçme), ashtu edhe në rastin e daljes nga burgu, duke zhvilluar, gjithashtu, veprime në favor të familjeve të personave në burg. Në rast pranimit të masave të posaçme i dënuari që do t'i përfitojë, do të ndiqet jashtë, nga Zyra e ekzekutimit penal të jashtëm.

Të afërmit e të burgosurve mund t'i drejtohen drejtpërdrejt zyrës UEPE për të kërkuar ndërhyrjen e asistentëve socialë.

Përveç kësaj, U.E.P.E. është kompetente, për çka parashikon ligji, ndaj të dënuarve që hyjnë në masa të posaçme drejtpërdrejt nga gjendja e lirisë.

Këto zyra sipas ligjit 72 op :

- » zhvillojnë, me kërkesë të autoritetit gjyqësor, kërkime për marrjen e informacioneve të dobishme lidhur me zbatimin, ndryshimin, shtyrjen dhe revokimin e masave të sigurisë;
- » zhvillojnë hetime socio-familjare për zbatimin e masave të posaçme;
- » i propozojnë autoritetit gjyqësor programin e trajtimit për t'ua zbatuar të dënuarve që bëjnë kërkesë për vënien në provë tek shërbimi social e për qëndrim në shtëpi;
- » kontrollojnë zbatimin e programeve nga ana e atyre që janë pranuar në masat e posaçme duke propozuar ndërhyrje të mundshme ndryshuese ose revokuese;
- » ofrojnë konsulencë për favorizimin e trajtimit në burg, me kërkesë të drejtorisë së burgut

### ***Asistenti social***

Asistenti social ushtron veprimtaritë e përmendura në paragrafin e mësipërm në kuadrin e qendrave të shërbimit social; kryejnë detyra kontrolli e ndihme për ata që u nënshtrohen masave të posaçme alternative të burgut, mbështesin e ndihmojnë ata që janë në liri të mbikëqyrur, marrin pjesë në aktivitetet ndihmëse ndaj të liruarve (neni 81 op), e bëjnë pjesë në ekipin e vëzhgimit e të trajtimit me figura të tjera profesionale.

### ***Psikologu***

Është figurë profesionale që aktivizohet nga drejtoria e burgut në funksion të vëzhgimit e të trajtimit. Psikologu është një nga ata ekspertë profesionistë që administrata mund t'i përdorë për aktivitetet e vëzhgimit e të trajtimit të caktuara në nenin 80 op.

Gjithashtu, janë të pranishëm, por jo të punësuar në administratën e burgut:

### ***Asistentët vullnetarë***

Janë persona të përshtatshëm për asistencën dhe edukimin që, me propozim të gjykatësit mbikëqyrës e me autorizimin e administratës së burgut, veprojnë nën koordinimin e drejtorisë së burgut, duke u dhënë mbështetje morale të

burgosurve e duke bashkëpunuar në kuadrin e veprimtarive trajtuese duke pasur parasysh rifutjen e ardhshme shoqërore. Merren gjithashtu me problematika si: veshjet, dokumentet e martesës, arkëtimi i çeqeve, dokumentet e pensionit e mund të bashkëpunojnë për veprimtaritë zbavitëse e kulturore nën drejtimin e drejtorit të burgut. Këto veprimtari të zhvilluara nga vullnetarët nuk mund të paguhen.

Asistentët vullnetarë mbajnë kontakte të rregullta me figurat e tjera profesionale, në veçanti me edukatorët, e mund të bashkëpunojnë me qendrat e shërbimit social për vënien në provë, për gjendjen e gjysmëlibrisë e për ndihmën ndaj të liruarve e familjeve të tyre (neni 78 op).

Asistentët vullnetarë të burgut mund të kontaktohen nëpërmjet kërkesës së posaçme.

### ***Ndërmjetësit kulturorë***

Është figurë e garantuar nga bashkëpunimi me entet vendore, në veçanti me komunën, bashkinë e krahinën.

Krijon lidhje me ata që u përkasin kulturave të ndryshme, si të burgosur ashtu edhe operatorët në kuadrin e veprimtarisë së vëzhgimit e të trajtimit; mbështet të burgosurit e huaj sipas nevojave specifike që ata paraqesin (gjuha, kuptimi i ligjeve, feja, dokumentet administrative, etj.).

Krijohet sportel i posaçëm brenda burgut.

Me kërkesë me shkrim mund të kërkohet bisedë me operatorët e burgut, me gjykatësin mbikëqyrës e me përgjegjësën krahinor të burgjeve; këtyre të fundit, përfshirë drejtorin, mund t'u dërgohen kërkesa e ankesa me shkrim.

## **Garanti i të drejtave të të burgosurve e të personave që u është hequr liria personale (territoriale)**

Është figurë profesionale që aktivizohet kur sinjalizohet një situatë që përmban shkeljen e një të drejte ose mosushtrimin e saj, duke ndërhyrë pranë institucioneve kompetente me qëllim që të nxiten ndërhyrjet e dobishme. Neni 67 op përfshin garantët e të drejtave të të burgosurve midis kategorive të personave që mund të hyjnë e të vizitohen burgjet pa autorizim.

Garanti gjithashtu, zhvillon veprimtari të sensibilizimit publik për temën e të drejtave njerëzore e për qëllimet riedukuese të dënimit, duke e afruar bashkësinë vendore me burgun

### *Neni 67 ligji 26 korrik 1975, n. 354 - Vizitat në burgje*

Burgjet mund të vizitohen pa autorizim nga:

- a) Kryetari i Këshillit të Ministrave e Kryetari i Gjykatës kushtetuese;
- b) Ministrat, gjykatësit e Gjykatës kushtetuese, Nënsekretarët e shtetit, anëtarët e Parlamentit e anëtarët e Këshillit të lartë të Drejtësisë;
- c) Kryetari i Gjykatës së Apelit, prokurori i përgjithshëm i Republikës pranë gjykatës së apelit, kryetari i gjykatës dhe prokurori i Republikës pranë gjykatës, gjykatësit e mbikëqyrjes, në kuadrin e juridiksionit përkatës;
- d) Këshilltarët e komisarit i qeverisë për krahinën, në kuadrin e zonës të tyre;
- e) Prifti i zakonshëm për ushtrimin e detyrës së vet;
- f) Prefekti e kuestori i provincës; mjeku provincial;
- g) Drejtori i përgjithshëm për qendrat e parandalimit e të dënimit dhe gjykatësit e funksionarët që delegohen prej tij;
- h) Inspektorët e përgjithshëm të administratës së burgut;
- i) Inspektori i kapelanëve;
- l) Oficerët e policisë së burgut;

**I bis) garantët e të drejtave të të burgosurve sido që të quhen;**

l ter) anëtarët e Parlamentit europian

### *Neni 67 bis ligji datë 26 korrik 1975, n. 354 Vizitat në dhomat e sigurisë*

Dispozitat sipas nenit 67 zbatohen edhe për dhomat e sigurisë.

Me **ligjin krahinor datë 27 shtator 2011, n. 13 që ka ndryshuar ndryshimin e ligjit krahinor të 19 shkurtit 2008, n. 3, krahina Emilia-Romanja** ka krijuar Zyrën e Garantit krahinor të drejtave të të burgosurve e të personave të cilëve u është hequr liria personale veprimtaria e të cilëve synon të garantojë, në përputhje me parimet kushtetuese e në kuadrin e kompetencave krahinore, të drejtat e personave që gjenden në burgje, në burgjet për të miturit, në strukturat shëndetësore, ngaqë i nënshtrohen trajtimit shëndetësor të detyrueshëm, në qendrat e pritjes së parë, në qendrat e ndihmës së përkohshme për të huajt e në vende të tjera ku liritë personale shtrëngohen ose kufizohen.

Garanti promovon nisma për përhapjen e kulturës së të drejtave të të burgosurve, në bashkëpunim me asesorët krahinorë kompetentë e me subjekte publike e private. Vepron gjithashtu në bashkëpunim e lidhje me asesorët krahinorë kompetentë e me subjektet publike e private të interesuara, si dhe me organizmat e garancisë që janë në nivel komunal.

Në kuadrin krahinor janë të pranishëm 5 garantë komunalë në Bolonja, Ferrara, Parma, Piacenza e Rimini.



Për sinjalizime të mundshme, adresa e Garantit të personave të cilëve u është hequr liria personale i Krahinës Emilia-Romanja, avokati Desi Bruno, është: Viale Aldo Moro, 50 - 40127 BOLOGNA

## Institucioni i Garantit kombëtar të të burgosurve

D.L. 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014 n. 10 ka themeluar pranë Ministrisë së Drejtësisë, Garantin e personave të burgosur ose të cilëve u është hequr liria personale (që në çastin e redaktimit të këtij shënimi nuk është ende emëruar), edhe në vijim të ratifikimit të Protokollit shtesë ndaj Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër torturës e trajtimeve çnjerëzore e degraduese realizuar me Ligjin datë 9 nëntor 2012 n. 195, që ia imponon çdo shteti anëtar që të pajiset me një organ kontrollues (vigilance), edhe pse me karakteristika pavarësie nga pushteti politik të ndryshme nga ato të përvijuaru në normativën e re.

Garanti përbëhet nga një kolegji prej tre anëtarësh, midis të cilëve një Kryetar, që rrinë në këtë post për pesë vjet, që nuk mund të shtyhen, të zgjedhur midis personave që sigurojnë pavarësi e kompetencë në disiplinat që lidhen me mbrojtjen e të drejtave njerëzore e që nuk mund të kenë sërish poste me zgjedhje, institucionale ose partiake.

Emërimi, pas ndryshimit të bërë gjatë konvertimit të D.L. n. 146, bëhet me dekret të Presidentit të Republikës.

Zyra përdor burime të vëna në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë, përfshirë personeli, dhe parashikohet një rregullore e mëpasshme për të disiplinuar strukturën e përbërjen e Zyrës së Garantit.

Garanti kombëtar do të koordinohet me Garantët territorialë të krijuar prej kohësh dhe do të zhvillojë funksionet e kontrollit në të gjitha vendet ku gjenden personat të cilëve u është hequr liria personale, pa autorizim, përfshirë CIE, Qendrat e identifikimit e të dëbimit.

Do të mund të konsultojë, me pëlqimin e të interesuarit, dosjet personale, e t'u kërkojë informacione administratave të interesuara, si dhe t'i kërkojë gjykatësit mbikëqyrës një urdher për paraqitjen e dokumentacionit në rast se mungojnë përgjigjet nga ana e administratës në fund të tridhjetë ditëve, të bëjë rekomandime në rast shkeljesh të vërtetuara të normave ligjore ose pasi vërtetohet themelësia e ankimeve të bëra në bazë të nenit 35 O.P., me administratën e interesuar që, në rast mohimi, e komunikon mospëlqimin e motivuar brenda afatit të tridhjetë ditëve.

Garanti u paraqet Dhomës së Deputetëve e Senatit dhe Ministrisë së Brendshme e të Drejtësisë një raport vjetor për aktivitetin e zhvilluar.

## Kërkesa me shkrim

Kërkesa me shkrim është një formular me të cilin i burgosuri i paraqet drejtorisë të gjitha nevojat për marrëdhëniet me të tjerët. Ky formular i duhet kërkuar nëpunësit të seksionit, duhet përpiluar në pjesët e rezervuara për kërkuesin dhe i duhet dërguar drejtorisë duke e futur në kutinë e posaçme në çdo seksion.

Me formularin mund të kërkohet që:

- » të bëhet një telegram ose letër rekomandë;
- » të tërhiqet një pako postare;
- » të merren nëpërmjet bisedave ato sende që kanë nevojë për autorizim;
- » një ndihmë, nëse personi nuk ka më parë;
- » të merren hua libra në bibliotekë;
- » të ndryshohet qelia ose seksioni;
- » të bëhen biseda me familjarë ose me bashkëjetuesit, në takim ose në telefon;
- » të bëhen biseda me operatorët e burgut e të tjerë;
- » të ndiqen veprimtari sportive, zbavitëse e kulturore ose të llojit tjetër;
- » të kërkohen kopje të akteve e të vendimeve.

## Transferimet (neni 42 o.p.)

Kërkesat për transferim në një burg tjetër duhet t'i drejtohen nëpërmjet burgut:

- » përgjegjësit krahinor të burgjeve, kur kërkohet transferim në një burg tjetër të së njëjtës krahinë;
- » departamentit të administratës së burgjeve, kur kërkohet transferimi në një burg jashtë krahinës.

Kujtojmë se transferimet bëhen për arsye sigurie të rënda e të provuara, për nevojat e burgut, për arsye drejtësie, shëndeti, studimi e familjare e që duhet favorizuar kriteri i çuarjes së të burgosurve në burgje pranë vendbanimit të familjeve (neni 42 op).

### SHËNIM

Sipas nenit 62 të dpr 230/2000 menjëherë pas hyrjes në burg, si në rastin kur vjen nga gjendje lirie, si në rast transferimi, të burgosurit e të internuarit i kërkohet nga ana e operatorëve të burgut nëse dëshiron t'ia njoftojë faktin ndonjë të afërmi ose personi tjetër e, në rast se është dakord, nëse dëshiron të përdorë postën e zakonshme apo telegramin. Deklarata përpilohet në proces verbal. Komunikimi i shkruar në letër në zarf të hapur ose në formular telegrami e që kufizohet vetëm me lajmin për hyrjen në burg ose transferimin e bërë, i

paraqitet drejtorisë që merret menjëherë me përcjelljen e tij, në ngarkim të të interesuarit. Në qoftë se bëhet fjalë për të mitur ose për të burgosur ose të internuar pa parà, shpenzimi është në ngarkim të administratës. Nëse bëhet fjalë për person të huaj, hyrja në burg i komunikohet autoritetit konsullor në rastet e mënyrat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

## Shoqërimi në burg

Përsa i përket shoqërimit në burg, që ligji e përkufizon si veprimtari të shoqërimit me forcë të personave në burg nga një vend në tjetër, të personave të burgosur, të internuar, të arrestuar ose gjithsesi në kushte shtrëngimi të lirisë personale. Në shoqërimin individual në burg përdorimi i prangave në duar është i detyrueshëm kur e kërkon rrezikshmëria e personit ose rreziku i ikjes ose kur rrethanat mjedisore e bëjnë të vështirë shoqërimin në burg (neni 42 bis op). Në të gjitha rastet e tjera përdorimi i prangave në duar ose i çdo lloji tjetër mjeti shtrëngimi fizik është i ndaluar.

Vlerësimi lidhur me rrezikshmërinë ose rrezikun e ikjes bëhet në çastin e shoqërimit në burg nga autoriteti gjyqësor që procedon ose nga drejtoria kompetente e burgut, të cilët japin rregullat e duhura. Në shoqërimet kolektive në burg është gjithnjë i detyrueshëm përdorimi i prangave modulare të shumëfishta të parashikuara në dekretet e ministrisë.

Gjatë shoqërimit në burg duhet të merren masat e nevojshme për të mos i lënë personat e burgosur përballë kuriozitetit të publikut e çdo lloj publiciteti, si dhe për t'u evituar atyre siklete të kota. Mosrespektimi i kësaj dispozite përbën sjellje që duhet vlerësuar nga pikëpamja disiplinore.

Siç konfirmohet nga qarkorja M.G.G.AFF.PEN. më 8 prill 1993, n. 558 – Shoqërimi i subjekteve në gjendje kufizimi të lirisë personale – neni 42bis op – ligji frymëzohet nga arsyeja për ta bërë shoqërimin në mënyrat më respektuese të të drejtave njerëzore, me veprimtarinë shoqëruese me forcë që të mos jetë, as mos të duket si poshtëruese ose cënuesë të dinjtetit të njeriut. Duhet shmangur përhapja, mbi të gjitha nëpërmjet mjetit televiziv, të skenave që tregojnë të pandehur ose të hetuar në pranga që sulmohen pikërisht nga fotografë e operatorë televizivë në rastet e shoqërimit të tyre në burgje ose në sallat e drejtësisë.

## Bisedat e telefonatat

Të burgosurit e të internuarit mund të kenë biseda e korrespondencë me të afërmit e me persona të tjerë, si dhe me garantin e të drejtave të të burgosurve, edhe me qëllim kryerjen e akteve juridike.

Bisedat rregullohen nga neni 18 i ligjit për burgjet e nga neni 37 i rregullores që përmban normat e burgjeve dpr 230/2000; kurse telefonatat disiplinohen nga neni 39 i të njëjtës rregullore.

Mund të bëhen gjashtë biseda mujore me të afërm ose bashkëjetues, me nga një orë secilin. Vetëm ata që kanë të afërm me vendbanim në një komunë të ndryshme nga ajo e burgut e që në javën e mëparshme nuk kanë bërë biseda të zakonshme mund ta zgjasin orarin. Të burgosurit e nenit 4 bis të ligjit 354/1975 paragrafi i parë fjalë e parë mund të bëjnë katër biseda në muaj.

Bisedat mund të bëhen me një numër maksimal prej tre vetash një herë. Me të afërm nënkuptohen sipas nenit 307 paragrafi 4 i kodit penal: paraardhësit, pasardhësit, bashkëshorti, vëllezërit e motrat, të afërmit të së njëjtës shkallë (por përjashtohen nga kjo listë të afërmit nëse bashkëshorti ka vdekur e nuk kanë pasur fëmijë), xhaxhallarët, dajat, e nipat. Për bashkëjetues nënkuptohen ata që rezultojnë të regjistruar në të njëjtën gjendje familjare. Të burgosurit e zakonshëm mund të bëjnë biseda me të afërmit deri në shkallën e katërt ndërsa të burgosurit sipas nenit 4 bis të ligjit 354/1975 paragrafi i parë fjalë e parë mund të bëjnë biseda me të afërmit deri në shkallën e tretë.

Në raste të veçanta (duke specifikuar arsyen e kërkesës së posaçme) bisedat mund të lejohen edhe me persona të tjerë.

Derisa nuk është zhvilluar procesi i shkallës së parë, autorizimi për biseda jepet nga autoriteti gjyqësor që procedon; më pas jepet nga drejtori i burgut ku gjendet i burgosuri.

Një familjar mund të paraqitet në burg duke sjellë me vete kartën e vet të identitetit e një dokument që të vërtetojë shkallën e lidhjes farefisnore (certifikatën e gjendjes familjare ose një certifikatë historike të lëshuar nga komuna). Qytetarët italianë mund ta vetëcertifikojnë lidhjen e farefisnisë në hyrje. Për qytetarët e huaj, burgu duhet të marrë një deklaratë nga konsullata që të vërtetojë shkallën e lidhjes farefisnore.

Parashikohen gjithashtu biseda të mëtejshme ose mundësia për ta kaluar ditën ose pjesë të ditës së bashku me familjen e vet për të mbajtur marrëdhëniet familjare, që jepen nga drejtori pasi konsultohet me grupin e vëzhgimit e të trajtimit (neni 61 dpr 230/2000).

Pasi i jepet autorizimi për bisedë qytetarit të huaj, që paraqitet në burg për t'i bërë vizitë një familjari në burg, nuk i duhet kërkuar më asnjë dokument që të tregojë praninë e tij të rregullt në Itali.

Biseda me familjarët në burg konfigurohet si ushtrim i një të drejte, si nga ana e të burgosurve ashtu edhe nga ana e të afërmeve, e jo si përdorim i një shërbimi publik.

Personeli i policisë së burgut nuk duhet t'i kërkojë të huajit që futet në burg paraqitjen e asnjë lloji dokumenti që vërteton ekzistencën e kriterëve që legjitimojnë praninë në territorin italian, as qytetari i huaj nuk është i detyruar të tregojë në asnjë mënyrë rregullsinë e qëndrimit të tij. Mosdetyrimi i verifikimit për qëndrimin e rregullt të të huajit në hyrje të burgut nuk përjashton që oficeri ose i ngarkuari me shërbim publik, që në çdo lloj mënyre vihet në dijeni për ekzistencën e veprës penale të imigracionit klandestin, nuk është i detyruar, në përgjithësi, t'ia denoncojë pa humbur kohë veprën autoritetit gjyqësor.

### ***Autorizimi për telefonata me telefona celularë në raste të veçanta***

Qarkorja e Dap 0177644 e datës 26 prill 2010 – Ndërhyrje të reja për uljen e shqetësimeve nga gjendja e heqjes së lirisë e për të parandaluar dukuritë autoagresive – e nxjerrë nga Drejtoria e përgjithshme e të burgosurve dhe e trajtimit, ka vendosur se u lejohet vetëm të burgosurve të zakonshëm, që i përkasin rrethit të sigurisë së mesme, kontakti telefonik me telefona celularë, nëse ekzistojnë kushte të caktuara: vetëm me verifikimin që në 15 ditët e mëparshme i burgosuri të mos ketë bërë biseda ose thirrje telefonike. Në këtë mënyrë i burgosuri me anë të kërkesës së posaçme ku duhet të tregojë pamundësinë e kontakteve telefonike me numra fiks dhe numrin e celularit të të afërmeve të vet, duke dhënë dokumentet e duhura për të provuar titullarin e numrit, mund të autorizohet që ta bëjë telefonatën me numra celularë. Në rast se i burgosuri nuk mund t'i japë dokumentet që vërtetojnë titullarin e numrit të të afërmit, do të fillojnë menjëherë kontrollet sipas praktikës me qëllim që të vërtetohet titullari i numrit në fjalë. Në çdo rast, pasi kalojnë pesëmbëdhjetë ditë nga prezantimi i kërkesës, pasi konstatohet se i burgosuri efektivisht nuk ka bërë biseda as telefonata me numra fiks gjatë periudhës së 15 ditëve, do të autorizohen thirrjet drejt celularëve, pasi bëhet vetëcertifikimi nga ana e të burgosurit ku vërtetohet se numri i telefonit celular është i familjarit të vet, pavarësisht nga marrja e të dhënave që eventualisht u kërkohen organeve kompetente për të konfirmuar titullarin e numrit telefonik. Autorizimi natyrisht do të revokohet në qoftë se nuk do të vërtetohet më pas karakteri i vërtetë i deklaratave të bëra nga i burgosuri.

E njëjta qarkore pohon se, në kuadrin e sigurimit të tutelës së plotë të të drejtës së mbrojtjes, i burgosuri ka mundësinë të bëjë telefonata me avokatin e vet që i shtohen numrit të caktuar si kufi për telefonata me familjarët e vet, siç parashikohet në lëmin e takimeve

## Posta dhe sedet që lejohen për t'u mbajtur

Mund të merren katër pako në muaj me anë të bisedave familjare, me peshë jo më shumë se 20 kg në muaj.

Pakot mund të dërgohen edhe me postë, por në këtë rast mund të dorëzohen vetëm nëse 15 ditët e mëparshme nuk ka pasur asnjë takim.

Mund të dërgohet e të merret postë pa kufizim, në rast se personi nuk ka mjetet e nevojshme për të shkruar, administrata duhet t'ia japë. Mund të dërgohen edhe letra në zarf të mbyllur, por duhet shkruar qartë emri i marrësit (kujt i dërgohet) e, nga ana tjetër e zarfit, emri e mbiemri i vet.

Gjithsesi, mund t'i bëhen kufizime lirisë së korrespondencës për arsye hetimore, si dhe për arsye sigurie ose rendi të burgut (me mënyrat e kufizimet sipas nenit 18 ter op).

Nuk mund të bëhen kufizime kur korrespondenca u drejtohet anëtarëve të Parlamentit, përfaqësive diplomatike ose konsullore të vendit të vet, organizmave të mbrojtjes së të drejtave njerëzore, avokatëve.

### ***Neni 18 ter paragrafi 2 ligji 26 korrik 1975, n. 354 – Kufizime e kontrollë të korrespondencës***

Nuk mund t'i bëhen kufizime korrespondencës me letër ose telegrame në qoftë se u drejtohet avokatëve mbrojtës, autoritetit gjyqësor, autoriteteve të treguara në nenin 35 op (drejtori i burgut, si dhe inspektorët, drejtori i përgjithshëm për institutet parandaluese e burgjet, Ministri i Drejtësisë, gjykatësi mbikëqyrës, autoriteti gjyqësor e shëndetësor që viziton burgun, presidenti i juntës krahinore, kryetari i shtetit), anëtarëve të Parlamentit, përfaqësive diplomatike ose konsullore të shtetit të të cilit të interesuarit janë qytetarë dhe organizmave ndërkombëtarë administrativë ose gjyqësorë që kanë si detyrë mbrojtjen e të drejtave të njeriut ku Italia bën pjesë.

## Blerja, gatimi i ushqimeve e përdorimi i furnelave

Lejohet gatimi i ushqimeve në qeli me furnelë me gaz e llojit kamping, me

përjashtim të seksioneve ku të burgosurit vihen për arsye shëndetësore (shiko repartet e infermierisë e qendrat diagnostikuese e terapeutike)

Mund të blihen vetëm sende ushqimore e ndihmuese të renditura në listën e posaçme të tarifave nëpërmjet formularit të veçantë.

Qarkorja e Dap 21 tetor 2011 e nxjerrë nga shefi i Departamentit për shumën që mund të shpenzohet nga të burgosurit e të internuarit për blerjet e korrespondencën e të atyre që mund të dërgohen nga familjarët e bashkëjetuesit i ka ngritur caqet e shpenzimit për blerjet e korrespondencën deri 800,00 euro në muaj (200,00 euro në javë), për të blerë të gjitha produktet e futura në listën e pazarit, ato me anë të kërkesës së shkruar, për të dërguar telegrame e për të bërë telefonata.

Për dërgimet ndaj familjarëve e bashkëjetuesve shuma mujore është 350,00 euro.

## Shkolla

Brenda në burg mund të ndiqen kurse të ndryshme shkollore në nivel të **shkollës së detyrueshme e të shkollës së mesme**. Lejohet gjithashtu, për të burgosurit që bëjnë kërkesë, të zhvillohet përgatitja privatisht për marrjen e diplomës së shkollës së mesme dhe universitare.

Organizohen gjithashtu **kurse të gjuhës italiane**.

Puna në burg është në përputhje me ndjekjen e kurseve shkollore.

Në burgje favorizohet **konsultimi i librave** nga ana e të burgosurve në bibliotekat e seksioneve përkatëse; administrimi i këtij shërbimi u besohet edukatorëve që bashkëpunojnë me asistentët vullnetarë e përfaqësuesit e të burgosurve. Hyrja në lokalet e bibliotekave bëhet në ditët e oraret e caktuara për secilin seksion.

## Formimi profesional

Në burgje organizohen kurse formimi profesional.

Për këto kurse të burgosurve u jepet informacion nëpërmjet afishimit, në hapësirat e posaçme në seksione, të njoftimeve për llojin, numrin e pjesëmarrësve, kërkesat minimale për pranim (për shembull njohja e gjuhës italiane ose koherenca e kursit që dëshiron të ndjekë me përvojën e vet profesionale të mëparshme) e kohëzgjatja e kurseve. Për të marrë pjesë në kurse duhet përpiluar kërkesë e

posaçme. Përzgjedhja e pjesëmarrësve do të bëhet nga Drejtoria e burgut, që do të ketë parasysh edhe përvojat profesionale, formuese e shkollore të mëparshme të personit.

Në fund të kurseve të formimit profesional, nëse përfundimi rezulton pozitiv, normalisht lëshohet një vërtetim për frekuentimin e për veprimtarinë e kryer e personi futet në listën e punës së kualifikuar të përshtatshme me formimin e zhvilluar.

## Puna e brendshme

Caktimi i të burgosurve në punë brenda burgut bëhet në bazë të listave të caktuara në dy lista të posaçme:

- » njëra për futjen në **punë të përgjithshme**;
- » njëra për futjen në **punë të kualifikuar** (murator, punëtor krahu, bojaxhi, kuzhinier, tipograf, etj.)

Në çastin e hyrjes, çdo i burgosur regjistrohet në listën (klasifikimin) e përgjithshme e nga ai çast fillon të llogaritet vjetërsia e papunësisë së tij. Futja në listën e punës së kualifikuar bëhet në bazë të profesionalizmit, të aktiviteteve të bëra më parë e të dokumentuara, të qëndrimit profesional të vërtetuara nga operatorët e kualifikuar, të pozicionit juridik. Nuk është i mundur pranimi në disa kualifikime.

Për t'u pranuar në veprimtari pune i duhet bërë kërkesë drejtorisë, duke specifikuar, nëse personi dëshiron të pranohet në listën e punës së përgjithshme ose në atë të punës së kualifikuar. Kriteret në bazë të të cilave zgjidhen personat janë:

- » **ngarkesat familjare**
- » **profesionalizmi dhe titujt e studimit**
- » **kualifikimi profesional**
- » **varfëria**
- » **koha e papunësisë që llogaritet nga fillimi i burgut.**

Në rast se i burgosuri nuk i respekton detyrat e veta e detyrat e veta të punës, përjashtohet nga listat, përveç rasteve kur paraqet arsye të justifikuar e të vërtetuara siç duhet. Duke paraqitur kërkesë i burgosuri mund të ripranohet në lista klasifikuese. Si përjashtimi ashtu edhe ripranimi i mundshëm në veprimtarinë e punës vendoset nga drejtori i burgut, pasi dëgjon mendimin e edukatorëve, të personelit e të ekspertëve.

Të burgosurit që punojnë për personat në ngarkim duhet të marrin edhe **çeçet**



**familjare** sipas ligjit. Këto çeqe u derdhen drejtpërdrejt personave në ngarkim.

## Veprimtaritë zbavitëse ose sportive

Në burg zhvillohen veprimtari kulturore, sportive e zbavitëse; ato futen në kuadrin e trajtimit riedukues.

Për zhvillimin e këtyre aktiviteteve drejtoria mund të bashkëpunojë me asistentët vullnetarë.

Për t'u pranuar në veprimtaritë e ndryshme i burgosuri duhet të paraqesë kërkesë me shkrim.

## Shoqatat që veprojnë në burg

Shoqatat që veprojnë në burg në bashkëpunim me burgjet janë të ndryshme e veprojnë si brenda, nëpërmjet laboratorëve, ashtu edhe jashtë nëpërmjet pritjes së personave.

Të burgosurit mund t'i kontaktojnë këto shoqata me kërkesë me shkrim me synim që të bisedojnë me një vullnetar.

## Qelia, higjiena e parandalimi

Qelia duhet mbajtur e pastër e kur i burgosuri nuk është në gjendje ta bëjë këtë detyrë, për arsye shëndetësore, merren (ish neni 6 dpr 230/2000) të burgosurit e ngarkuar me zhvillimin e këtyre detyrave për të cilat paguhen. Materiali që duhet për pastrimin e qelisë duhet të vihet në dispozicion falas nga ana e administratës së burgut (ish neni 8 dpr 230/2000 e neni 8 i ligjit 354/1975), çdo i burgosur mund të blejë me shpenzimet e veta artikuj të tjerë pranë dyqanit të brendshëm.

Neni 5 op parashikon gjithashtu që ndërtesat e burgut të jenë të pajisura me lokale për zhvillimin e veprimtarive së bashku.

Në burg, hapësirat e reduktuara e bashkëjetesa e detyrueshme mund të shkaktojnë rreziqe serioze për shëndetin.

Pra është e domosdoshme të ndiqen me vëmendje të madhe normat elementare të higjienës për ta ulur rrezikun e infektimit të shkaktuar nga mikroorganizmat (baktere, viruse protozoike), kërpudha e parazitë.

Rregullat për t'u respektuar janë shumë të thjeshta:

» duhen kërkuar detersivë e detergjentë, që jepen nga Administrata e

burgut, të nevojshëm për pastrimin e lavamanëve e të banjës (më mirë të pastrohen çdo herë në qoftë se përdorimi është bashkë me persona të tjerë);

- » këshillohet përdorimi i sapunëve të lëngshëm në shishet përkatëse e jo sapunët normalë, sepse këta janë shpesh burim infeksionesh (disa mikrobe shumohen brenda tyre e shpesh hapësirat e lavamanëve ku ato mbështeten bëhen kultura mikrobesh);
- » peshqirët, furça e dhëmbëve, brisku i rrojës, krehri e furça nuk duhen shkëmbyer për të mos marrë sëmundje si hepatiti, zgjebja, kërpudhat e lëkurës etj.;
- » enët që jepen në burg janë shpesh plastike pra pak higjienike.

Është mirë të lahen me kujdes me ujë të ngrohtë e të shpëlahen për të shmangur mbetjen e gjurmëve të deterсивit

## E drejta e shëndetit në burg

Me DPCM datë 1 prill 2008 iu transferuan Shërbimit shëndetësor kombëtar të gjitha funksionet shëndetësore të zhvilluara nga Departamenti i administratës së burgut e nga Departamenti i drejtësisë për të miturit i Ministrisë së Drejtësisë. Pas reformës në fjalë në burgjet krahinore asistencë shëndetësore jepet nga Krahina Emilia-Romanja.

Me këtë reformë të shëndetësisë në burgje është afirmuar parimi për të cilin të burgosurit e të internuarit kanë të drejtë të përfitojnë nga shërbimet e parandalimit, diagnozës, kurimit e të rehabilitimit të parashikuara në nivelet thelbësore e uniforme të asistencës bars me qytetarët në gjendje lirie.

Në raportin për asistencën shëndetësore të kryer në burgjet krahinore në vitin 2011, nën kujdesin e asesoratit kompetent, lexohet se dënimi duhet të jetë i vëmendshëm ndaj nevojave njerëzore të të dënuarit në pritje të rifutjes së tij në shoqëri, e midis nevojave "njerëzore" parësore pa dyshim duhet të jetë mbrojtja e të drejtës së shëndetit. Rifutja në shoqëri e personit do të mund të jetë pozitive nëse bëhet me një gjendje mirëqenieje psiko-fizike. Gjykata Kushtetuese, me një sërë vendimesh, ka shprehur një koncept të së "drejtës së shëndetit" që nënkuptohet si pluralitet gjendjesh subjektive: e drejta për integritet psiko-fizik; e drejta për mjedis të shëndetshëm; e drejta e të sëmurve për kura falas; e drejta për informacion të gjendjes së vet shëndetësore e të trajtimeve që mjeku dëshiron të bëjë; e drejta për pjesëmarrje; e drejta për të përdorur strukturat; e drejta e të sëmurit për të komunikuar me të afërmit e vet; e drejta për të dhënë pëlqimin e vet të informuar për kontrollet e trajtimet shëndetësore që i propozohen.

Shërbimet shëndetësore organizohen në secilin burg për të dhënë asistencën parësore bazë, për shëndetin mendor, për varësitë patologjike e për barnat e specializuara.

Sipas nenit 11 të ligjit 354/1975 kur janë të nevojshme kura ose kontrolle diagnostikuese që nuk mund të kryhen nga shërbimet shëndetësore të burgjeve, të burgosurit transferohen në spitale civile ose në vende të tjera të jashtme kurimi.

Në çastin e hyrjes në burg subjektet i nënshtrohen vizitës mjekësore me qëllim që të kontrollohen sëmundje eventuale psikike ose fizike e një kontroll për sëmundjet infektive. Të dhënat shëndetësore janë të rezervuara dhe mjekët janë të lidhur nga sekretet profesional. Asistenca shëndetësore jepet nëpërmjet kontrolleve periodike pavarësisht nga kërkesat e të interesuarve.

Shërbimi shëndetësor jep barna për terapitë e këshilluara: infermieri nuk mund t'i ndryshojë dozat e caktuara nga mjeku dhe është e ndaluar të mbledhen barna e t'u jepen të burgosurve të tjerë. Mund të blihen barna, të dhëna me receta nga mjeku, nga ana e të burgosurit.

Të burgosurit mund të kërkojnë, pasi i bëjnë kërkesë drejtorisë, që të vizitohen me shpenzimet e tyre nga një mjek i besuar. Për të burgosurit në pritje të gjyqimit të parë, autorizim jepet nga autoriteti gjyqësor që procedon. Drejtoria shëndetësore e burgut merr informacionin e duhur për rastin.

Për t'u vizituar nga mjeku duhet bërë rezervimi në mbrëmje, duke i lënë mbiemrin e vet agjentit në shërbim në seksion: mjeku do të kalojë për vizitë ditën e mëpasshme.

Në qoftë se personi ndihet keq papritmas, duhet informuar menjëherë agjenti në shërbim në seksion, i cili do të thërrasë menjëherë mjekun për një vizitë urgjente.

Neni 11 i ligjit 354/1975 parashikon që asistenca shëndetësore duhet të jepet, gjatë qëndrimit në burg, me kontrolle periodike e të shpeshta, pavarësisht nga kërkesat e të interesuarve.

Mjeku duhet t'i vizitojë çdo ditë të sëmurët e ata që bëjnë kërkesë; duhet të sinjalizojë menjëherë praninë e sëmundjeve që kërkojnë analiza të veçanta e kura të specializuara; gjithashtu duhet të kontrollojë periodikisht përshtatshmërinë e personave sipas punës që u është ngarkuar.

## Ushqimi

Ushqimi sigurohet nga administrata e burgut, duhet të jetë i përshtatshëm me moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore, punën, stinën, klimën (neni 9 op) e parashikon tre vakte në ditë (neni 11 dpr 230/2000).

Sasia e cilësia rregullohen nga tabelat që miratohen për këtë qëllim me dekret të ministritë.

Të burgosurit mund të kërkojnë, me kërkesë të posaçme me shkrim, që të kenë ushqim sipas fesë së tyre.

## SHËNIM

Ligji parashikon krijimin në çdo burg të përfaqësistë së të burgosurve e të internuarve të caktuar çdo muaj me hedhje në short që kontrollon zbatimin e tabelave e përgatitjen e ushqimit.

Ky komision, që përbëhet nga tre të burgosur/a, ku merr pjesë edhe një i deleguar nga drejtori, asiston "gjatë marrjes së artikujve të qejfit, kontrollon cilësinë e sasinë, verifikon që artikujt të përdoren plotësisht për ambalazhimin e ushqimit" (neni 9 op e neni 12, dpr 230/2000). Ky komision ka gjithashtu fuqinë për të kontrolluar cilësinë e çmimet e artikujve që shiten në dyqanin e brendshëm, që gjithsesi, me ligj, nuk mund t'ua kalojnë atyre që vihen zakonisht në komunën ku gjendet burgu. Çmimet kontrollohen në mënyrë periodike nga drejtorja e njoftohen të burgosurit.

Përfaqësuesit e të burgosurve kanë të drejtë t'ua shprehin vërejtjet e tyre drejtorit.

Për personat me probleme shëndetësore, parashikohet gjithnjë ushqim i posaçëm, ashtu si për gratë shtatzëna ose lehona. Për të kërkuar ushqim posaçërisht të përshtatshëm me gjendjen e vet shëndetësore është mirë të flisni me mjekun, i cili mund të porosisë dietë të duhur të cilën administrata duhet ta përmbushë.

## Shpenzimet e procesit gjyqësor e të qëndrimit në burg

Këto kosto, të kthyeshme, janë ato që shteti ka bërë për zhvillimin e procesit e për mbajtjen në burg të të burgosurit. Kuota ditore e këtyre shpenzimeve është caktuar aktualisht në rreth 1,80 euro e përfshin koston e ushqimit e atë të përdorimit të pajisjeve personale, që jepen nga administrata e burgut (dysheku, çarçafët, pjatat, lugët, pirunët, etj.).

Për të përfituar faljen e borxhit personi duhet të jetë në vështirësi ekonomike e duhet të ketë pasur sjellje të mirë gjatë burgut; në rast se kërkesa pranohet, personi nuk duhet të paguajë shpenzimet e mësipërme e do të ngarkohen vetëm shpenzimet e mbajtjes për muajt e burgut kur është bërë veprimtari pune. Kërkesa për faljen e borxhit i duhet paraqitur gjykatësit mbikëqyrës e sapo merret njoftimi për pagesën, dhe kjo shkakton pezullimin e përkohshëm të

procedurës për rikuperimin e shumave të detyruara.

Kur dënimi do të përfundojë, gjykatësi mbikëqyrës do të vlerësojë nëse ekzistojnë kushtet për faljen efektive të borxhit. Paga për personat e burgosur në mënyrë definitive për punën e bërë në burg do të ndahet midis fondit të disponueshëm (katër të pestat) e fondit të kushtëzuar (një i pesti).

Paratë e fondit të kushtëzuar do të jenë të disponueshme në fund të dënimit, por në rast nevojë të motivuar që nuk mund të përmbushet nga fondi i disponueshëm mund të kërkohet zhbllokimi duke përdorur formularin e posaçëm, të vendosur në seksion, që t'i dërgohet drejtorit.

## E drejta e votës

Personat e burgosur, si për ekzekutimin e dënimit ashtu edhe në paraburgim, që e kanë mbajtur të drejtën e votës, duhet që të kenë mundësi ta ushtrojnë këtë të drejtë themelore për jetën demokratike.

Për ta bërë këtë gjë, burgjet duhet të përgatisin në kohë, sapo të fillojnë tubimet elektorale, një sistem kapilar komunikimi për personat në burg, përfshirë ata që do të hyjnë më pas, me informacione të domosdoshme për ushtrimin e të drejtës së votës.

Siç dihet, personat në burg në çastin e zgjedhjeve mund ta ushtrojnë të drejtën e votës në vendin e burgimit, sipas neneve 8 e 9 ligji 23 prill 1976, n. 136, që ndodh me anë të krijimit të një qendre të posaçme votimi. Ushtrimi i kësaj të drejte kushtëzohet nga disa përmbushje, që kërkojnë kohë e nuk mund të bëhen përveçse nëpërmjet një njohje të mëparshme të tyre.

Në veçanti i burgosuri duhet t'i dërgojë kryetarit të komunës, në listat zgjedhore të të cilit është i regjistruar, një deklaratë të vullnetit të vet për të shprehur votën në vendin ku gjendet, me vërtetimin në fund të drejtorit të burgut që vërteton burgimin e tij, me qëllim që ta mundësojë kryetarin e komunës që ta regjistrojë kërkuesin në listën e posaçme, e të jetë i pajisur gjithashtu me librezën e vet të zgjedhjeve. Kërkesa mund t'i arrijë Kryetarit të komunës jo më vonë se dita e tretë para votimeve, por është thelbësor informimi i të burgosurve për nevojën e këtyre përmbushjeve, në mënyrë që të mund të aktivizohen.

Informimi në kohë mund të favorizojë ushtrimin e së drejtës themelore për pjesëmarrjen e të burgosurve në jetën politike të vendit tonë, që kurrë më shumë se në këtë çast, kanë nevojë t'u njihet e drejta e qytetarisë

## Feja dhe praktikat e kultit (neni 26 o.p.)

Të burgosurit e të internuarit janë të lirë të ndjekin besimin e vet fetar, të arsimohen me të e të praktikojnë kultin. Në burgje sigurohet edhe celebrimi i riteve të kultit katolik. Në çdo burg ka të paktën një kapelan.

Ata që bëjnë pjesë në fe të ndryshme nga ajo katolike kanë të drejtë të marrin, me kërkesë të tyre, ndihmën e priftërinjve të kultit të vet e të celebrjnë ritet.

## Rregullat e sjelljes

Neni 69 – informacione për normat e dispozitat që rregullojnë jetën në burg – të dpr 230/2000 parashikon që në çdo burg duhet të mbahen, pranë bibliotekës ose në lokal tjetër ku të burgosurit mund të futen, tekstet e ligjit 354/1975 (ligji i burgut) e të dpr 230/2000, të rregullores së brendshme si dhe të dispozitave të tjera lidhur me të drejtat e detyrat e të burgosurve e të internuarve, disiplinën e trajtimin.

Paragrafi 2, siç është ndryshuar nga dpr 5 qershor 2012, n. 136 që ka ndryshuar dpr 230/2000, në lëmin e kartës së të drejtave e të detyrave të burgosurit e të internuarit, parashikon që gjatë hyrjes, secilit të burgosur ose të internuar, i dorëzohet karta e të drejtave dhe të detyrave të të burgosurve e të internuarve, që përmban të drejtat e detyrat, strukturat e shërbimet që u rezervohen (ligji parashikon që përmbajtja e kartës përcaktohet me dekret të Ministrisë të Drejtësisë, që duhet të merret brenda 180 ditëve duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj dispozite).

Respektimi i ligjeve dhe i dispozitave që rregullojnë jetën e burgut nga ana e të burgosurve duhet të arrihet edhe nëpërmjet sqarimit të arsyeve të tyre.

Sjelljet që nuk lejohen e për të cilat parashikohen sanksione disiplinore renditen në nenin 77 të dpr 230/2000, që përbën rregulloren e ekzekutimit të ligjit të burgut.

Rregullat që sanksionohen nga ky ligj duhet të respektohen. Në veçanti është e domosdoshme:

- » të respektohen ligjet që rregullojnë jetën në burg;
- » të respektohen dispozitat e dhëna nga personeli;
- » të mbahet një sjellje që i respekton të gjithë.

### *Shkelje disiplinore (neni 38 op e 77 d.p.r. 230/2000)*

Të burgosurit e të internuarit nuk mund të ndëshkohen për një fakt që nuk është parashikuar shprehimisht si shkelje në rregullore.

Nuk mund të jepet asnjë sanksion përveçse me vendim të motivuar pasi i komunikohet të interesuarit, i cili mund të paraqesë shfaqësimet e veta.

Në zbatimin e sanksioneve duhet pasur parasysh, përveçse natyra e rëndësia e faktit, sjellja e kushtet personale të subjektit.

Sanksionet jepen duke respektuar personalitetin.

Neni 77 i dpr 230/2000 parashikon në veçanti që sanksionet disiplinore t'u jepen të burgosurve e të internuarve që janë bërë përgjegjës për:

- 1) neglizhencë në pastrimin e rregullimin e personit ose të dhomës;
- 2) braktisje të pajustificuar të vendit të caktuar;
- 3) mospërbushje të vullnetshme të detyrimeve të punës;
- 4) qëndrime e sjellje bezdisëse ndaj komunitetit;
- 5) lojëra ose veprimtari të tjera që nuk lejohen nga rregullorja e brendshme;
- 6) simulim të sëmundjes;
- 7) trafikim të mirash që lejohen të mbahen;
- 8) mbajtje ose trafikim sendesh të palejueshme ose parash;
- 9) komunikime mashtruese jashtë ose brenda, në rastet e treguara në numrat 2) e 3) të paragrafit të parë të nenit 33 op;
- 10) akte të turpshme ose publikisht të pahijshme;
- 11) kërcënim ndaj shokëve ose dhunë ndaj tyre;
- 12) falsifikim dokumentesh që vijnë nga administrata e që i besohen për ruajtje të burgosurit ose të internuarit;
- 13) përvetësim ose dëmtim i të mirave të administratës;
- 14) mbajtje ose trafikim mjetesh që mund të dëmtojnë;
- 15) qëndrim fyes ndaj operatorëve të burgut ose personave të tjerë që hyjnë në burg për arsye pune ose për vizitë;
- 16) mosrespektim urdhrash ose rregullash ose vonesë e pajustificuar në zbatimin e tyre;
- 17) vonesa të pajustificuara në kthim sipas neneve 30, 30-ter, 51, 52 e 53 op;
- 18) pjesëmarrje në rrëmuja ose në revolta;
- 19) nxitje rrëmujash ose revoltash;
- 20) arratisje;
- 21) fakte që parashikohen në ligj si vepër penale, të kryera në dëm të shokëve, të operatorëve të burgut ose të vizitorëve.

Sanksionet disiplinore jepen edhe në rast tentative shkeljesh të lartpërmendura. Sanksioni i përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta nuk mund të jepet për shkeljet e parashikuara në numrat nga 1) deri 8) të paragrafit 1, përveç rasteve kur shkelja është bërë brenda tre muajve nga kryerja e një shkeljeje tjetër e të njëjtës natyrë.

Për sanksionet që i jepen të pandehurit njoftohet edhe autoriteti gjyqësor që

procedon.

### ***Sanksionet disiplinore (neni 39 o.p.)***

Çdo shkelje e rregullores shkakton një sanksion, që mund të jetë:

- » tërheqja e vëmendjes nga ana e drejtorit (është sanksioni më i lehtë);
- » qortimi;
- » përjashtimi nga veprimtaritë zbavitëse e sportive deri 10 ditë maksimumi;
- » izolimi gjatë qëndrimit në ajër të pastër, jo më shumë se për dhjetë ditë;
- » përjashtimi nga veprimtaritë e përbashkëta deri në pesëmbëdhjetë ditë maksimumi (është sanksioni më i rëndë).

Sanksionet e tërheqjes së vëmendjes e të qortimit vendosen nga drejtori; të tjerat nga këshilli disiplinor i përbërë nga drejtori, nga një mjek e nga një edukator.

### ***Izolimi (neni 73 d.p.r. 230/2000)***

Izolimi i vazhdueshëm për arsye shëndetësore këshillohet nga mjeku në rastet me sëmundje infektive. Ai bëhet, sipas rrethanave, në lokale të posaçme të infermierisë ose në klinikë. Gjatë izolimit, nga ana e personelit i kushtohet kujdes i veçantë të sëmurit edhe për ta mbështetur moralisht. Izolimi duhet të marrë fund porsa të përfundojë gjendja infektive.

Izolimi i vazhdueshëm gjatë ekzekutimit të sanksionit të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta bëhet në një dhomë të zakonshme, përveç rasteve kur sjellja e të burgosurit ose e internuarit është e tillë sa e shqetëson ose e dëmton rendin e disiplinën. 3. Të burgosurve e të internuarve, gjatë periudhës së përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta, sipas paragrafit 2, u ndalohe të komunikojnë me shokët.

Izolimi ditor i të dënuarve me burg të përjetshëm nuk i përjashton ata nga puna, si dhe nga arsimit e formimi të ndryshëm nga kurset shkollore, e nga funksionet fetare.

Sigurohen ushqimi i zakonshëm dhe sasia normale e ujit.

Kushtet e personave që i nënshtrohen hetimeve paraprake që janë në izolim nuk duhet të ndryshojnë nga ato të burgosurve të tjerë, përveç kufizimeve të vendosura nga autoriteti gjyqësor që procedon.

Gjendja e izolimit të të burgosurve e të internuarve duhet të jetë objekt i vëmendjes së veçantë, me kontrolle të duhura të përditshme në vendin e izolimit, si nga ana e mjekut, ashtu edhe nga një anëtar i grupit të vëzhgimit e të trajtimit, e me kontroll të vazhdueshëm e të përshtatshëm nga ana e personelit të policisë së burgut.

Nuk mund të përdoren seksione ose reparte izolimi për raste të ndryshme nga



ato që parashikohen me ligj.

### ***Kontrollime (neni 74 d.p.r .230/2000)***

Veprimet e kontrollimeve të parashikuara në nenin 34 op bëhen nga personeli i policisë së burgut në prani të një pjesëtari të kësaj policie me gradë jo më të vogël se zv/sipërintendent. Personeli që bën kontrollimin e ai që asiston duhet të jetë i të njëjtit seks të subjektit që kontrollohet.

Kontrollimi mund të mos bëhet kur është e mundur të bëhet me mjete kontrolli.

Kontrollimet në dhomat e të burgosurve e të internuarve duhet të bëhen duke respektuar dinjitetin e të burgosurve si dhe të sendeve që u përkasin atyre.

Rregullorja e brendshme përcakton cilat janë situatat, me atë të parashikuar në nenin 83 dpr 230/2000, kur bëhen kontrollimet e zakonshme.

Për të proceduar me kontrollimet jashtë rasteve të zakonshme duhet urdhri i drejtorit.

Për veprimet e kontrollimit të përgjithshëm drejtori mund të ketë, në raste të jashtëzakonshme, bashkëpunimin e personelit të forcave të policisë e forcave të tjera në dispozicion të Prefektit, sipas paragrafit të pestë të nenit 13 të ligjit 10 prill 1981, n. 121.

Në raste urgjence të veçantë, personeli vijon në nismë të vet me kontrollimin, duke e informuar menjëherë drejtorin, duke specifikuar arsyet që shkaktojnë urgjencën.

## **Përdorimi i forcës fizike dhe i mjeteve shtrënguese (neni 41 o.p.)**

Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të burgosurve dhe të internuarve në qoftë se nuk është e domosdoshme për parandalimin ose ndalimin e akteve të dhunës, pengimin e tentativave për arratisje ose për të mposhtur rezistencën, edhe pasive, gjatë zbatimit të urdhrave të dhënë.

Personeli që për çfarëdolloj arsye ka përdorur forcë fizike ndaj të burgosurve ose të internuarve, duhet të njoftojë menjëherë drejtorin e burgut, i cili vendos pa vonesë kontrolle mjekësore e vijon me hetimet e rastit.

Nuk mund të përdoret asnjë masë detyrimi fizik që nuk është shprehimisht i parashikuar nga rregullorja e gjithsesi nuk mund të përdoren për qëllime disiplinore, por vetëm për shmangien e dëmeve ndaj personave ose sendeve ose për garantimin e pacenueshmërisë të vetë subjektit.

Përdorimi duhet të jetë i kufizuar gjatë kohës ngushtësisht të nevojshme e duhet kontrolluar vazhdimisht nga mjeku.

Agjentët në shërbim brenda burgjeve nuk mund të mbajnë armë përveç rasteve të jashtëzakonshme kur kjo urdhërohet nga drejtori.

## **Masa disiplinore mbrojtëse (neni 78 d.p.r. 230/2000)**

Në rast urgjence absolute, e shkaktuar nga nevoja për parandalimin e dëmeve ndaj personave apo sendeve, si dhe lindja ose përhapja e rrëmujave ose në prani të fakteve me rëndësi të madhe për sigurinë e rendin e burgut, drejtori mund të vendosë për qëllime mbrojtëse, me vendim të motivuar, që i burgosuri ose i internuari, që ka kryer shkelje të dënueshme me përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta, që nuk mund të zbatohet pa certifikimin me shkrim të lëshuar nga mjeku, që vërteton se subjekti mund ta durojë, të qëndrojë në një dhomë individuale, në pritje të thirrjes së këshillit disiplinor.

Menjëherë pas marrjes së masës mbrojtëse, mjeku e viziton personin dhe lëshon, sipas rastiit, certifikatën e parashikuar me ligj. Drejtori fillon e zhvillon sa më shpejt procedimin disiplinor, duke zbatuar udhëzimet e paragrafit 2 e vijuese të nenit 81 dpr datë 30 qershor 2000, n. 230.

Kohëzgjatja e masës parandaluese nuk mund të jetë më shumë se dhjetë ditë. Koha e kaluar me masë parandaluese hiqet nga kohëzgjatja e sanksionit që zbatohet eventualisht.

## **Procedimi disiplinor (neni 81 d.p.r. 230/2000)**

Kur një operator i burgut konstaton drejtpërdrejt ose merr dijeni se është kryer shkelje, përpilon një raport, duke shënuar të gjitha rrethanat e faktit. Raporti i transmetohet drejtorit me rrugë hierarkike.

Drejtori (ose dikush nga personeli drejtues), në prani të komandantit të repartit të policisë së burgut, ia njofton fajin të akuzuarit, me shpejtësi e brenda 10 ditëve, duke e informuar njëkohësisht për të drejtën që të shpjegojë shfajësimet e veta.

Drejtori, personalisht ose nëpërmjet personelit të punësuar, bën kontrollet për faktin e ndodhur.

Kur drejtori mendon se duhet dhënë një sanksion me tërheqje vëmendje (n. 1 paragrafi i parë neni 39 op - sanksionet disiplinore) e me qortim, nga ana e drejtorit në prani të disa anëtarëve të personelit e të një grupi të burgosurish e

të internuarish (n. 2 paragrafi i parë neni 39 op) thërret, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit, të akuzuarin përballë vetes për vendimin disiplinor. Përndryshe cakton, me të njëjtën mënyrë, ditën e orën e thirrjes së të akuzuarit përballë këshillit disiplinor. Thirrja i njoftohet të interesuarit me format sipas paragrafit 2. Gjatë seancës së këshillit disiplinor i akuzuari ka mundësi të dëgjohet e të paraqesë personalisht shfaqësimet e veta.

Në qoftë se gjatë procedimit rezulton se fakti është ndryshe nga sa është njoftuar e shkakton sanksion në kompetencë të këshillit disiplinor, procedimi i kthehet këtij të fundit.

Sanksioni vendoset e shpallet gjatë kësaj seance ose me procesverbalin eventual të përmbledhur.

Masa përfundimtare me të cilën vendoset masa disiplinore i komunikohet pa humbur kohë nga ana e drejtorisë të burgosurit ose të internuarit e gjykatësit mbikëqyrës e shënohet në dosjen personale.

Saktësojmë se procedimi për zbatimin e sanksionit ka faza të ndryshme: sinjalizimi i shkeljes zakonisht të nxitur nga operatori i burgut që merr dijeni për faktin e parregullt. Ky ia transmeton drejtorit raportin për rrethanat e faktit. Drejtori pasi vihet në dijeni për shkeljen është i detyruar ta njoftojë për fajin personin e interesuar, në prani të komandantit. Gjatë njoftimit drejtori duhet ta informojë të burgosurin për mundësinë që t'i shpjegojë shfaqësimet e veta, gjithashtu, ka të drejtë të zhvillojë kontrolle të mëtejshme për faktin e ndodhur, me qëllim që të vendosë sanksionin e përshtatshëm. Në këtë rast drejtori duhet ta thërrasë të interesuarin në një seancë të posaçme përballë tij ose këshillit disiplinor. Drejtori pra ka funksione si hetuese ashtu edhe gjykuese. Gjatë seancës i burgosuri mund të ushtrojë mundësinë e paraqitjes së shfaqësimeve të veta, që konfigurohet si një e drejtë e vërtetë mbrojtjeje. Edhe veprimtaria e njoftimit të fajit me formalitetet e parashikuara nga rregullat e burgut merr vlerë të veçantë midis garancive të procedimit e përbën detyrim për drejtorin për zbatimin e plotë të debatit gjatë procedimit disiplinor.

Akti i njoftimit, siç parashikohet shprehimisht nga rregullat, parashikon praninë e dy personave, drejtorin e komandantit, si garanci për çka përmban procesverbali, ku i burgosuri mund të japë menjëherë deklaratë për shfaqësimin e vet.

Drejtori mund ta delegojë këtë detyrë, por në atë mënyrë që të garantohet gjithnjë prania e dy personave, duke respektuar rregullat e burgut, në mënyrë që mos t'u besohen të njëjtit subjekt disa funksione të papajtueshme.

Akti i njoftimit që bëhet jo sipas formave të parashikuara nga rregulloret është i paligjshëm e mund të vihet në bazë të një ankese drejtuar gjykatësit mbikëqyrës kundër sanksionit të dhënë e të kërkojë anulimin e tij.

## SHËNIM

Ndonjëherë në përvojën e jetës në burg, gjatë seancës së këshillit disiplinor, e në veçanti kur i akuzuari dëgjohej e shpjegon personalisht shfaqjesimin e vet, duke treguar ngjarjet sipas pikëpamjes së vet, është vënë re prania e personelit të policisë së burgut, ndonjëherë edhe të vetë operatorit që ka përpiluar raportin disiplinor.

Për këtë praktikë, gjithsesi jo e përhapur, saktësohet se, atëherë kur nuk vihen re kërkesa të rënda e të veçanta sigurie, do të ishte mirë që zhvillimi i plotë i seancës së këshillit disiplinor të bëhej vetëm me praninë e anëtarëve të këshillit disiplinor e të akuzuarit.

## E drejta e ankesës (neni 35 o.p.)

Të burgosurit e të internuarit mund të bëjnë kërkesa ose ankesa me gojë ose me shkrim, edhe me zarf të mbyllur:

- 1) drejtorit të burgut, përgjegjësit krahinor, shefit të departamentit të administratës së burgut dhe Ministrit të drejtësisë;
- 2) autoriteteve gjyqësore e shëndetësore që vizitojnë burgun;
- 3) garantit kombëtar dhe garantëve krahinorë ose vendorë për të drejtat e të burgosurve;
- 4) presidentit të juntës krahinore;
- 5) gjykatësit mbikëqyrës;
- 6) Kryetarit të shtetit.

## SHËNIM

D.L. datë 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014, n. 10, e ka ndryshuar nenin 35 O.p. duke futur edhe Garantët territorialë midis marrësve të ankesave "të përgjithshme" të të burgosurve.

## Ankesa juridiksionale (neni 35 bis o.p.)

D.L. 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014 n. 10 ka futur nenin 35bis O.p., që disiplinon vendimin e gjykatësit mbikëqyrës në selinë juridiksionale për ankesat e të burgosurve për kushtet e ushtrimit të pushtetit disiplinor, përbërjen e kompetencën e organit disiplinor, kundërshtimin e fajeve dhe mundësinë e shfaqjesimit - neni 69 par. 6 shk. a) O.p. -; përveç kësaj, vendos për ankesat lidhur me mosrespektimin nga ana e administratës të dispozitave të parashikuara nga ligji, nga i cili t'i vijë të burgosurit ose të internuarit një dëm aktual e i rëndë ndaj ushtrimit të të drejtave, sipas asaj që parashikon

neni 69 par. 6 shkr. b) O.p., edhe ai i ndryshuar nga normativa në shqyrtim.

Në lëmin disiplinor afati për ankesën është gjithnjë prej 10 ditësh nga komunikimi i masës.

Në rast pranimit gjykatësi i mbikëqyrjes vendos anulimin e masës së dhënies së sanksionit disiplinor.

Kundër vendimit të gjykatësit mbikëqyrës pranohet ankesa tek gjykata e mbikëqyrjes në afatin prej 15 ditësh nga njoftimi ose komunikimi i njoftimit të depozitimit të vetë vendimit.

Vendimi i gjykatës së mbikëqyrjes është i apelueshëm në kasacion për shkelje të ligjit në afatin prej 15 ditësh nga njoftimi ose komunikimi i njoftimit të depozitimit të vetë vendimit.

Në rast ankesash kundër akteve të konsideruara dëmtuese, pasi vërtetohet ekzistenca e aktualiteti i dëmit, parashikohet që gjykatësi ta urdhërojë administratën e interesuar që ta ndreqë brenda afatit të treguar.

Në rast se nuk bëhet ekzekutimi i masës që nuk është më subjekt kundërshtimi, i interesuari ose avokati mbrojtës i pajisur me prokurë të posaçme mund të kërkojë respektimin gjykatësit mbikëqyrës që ka nxjerrë masën, që mund ta urdhërojë duke treguar mënyrën e afatit e përmbushjes, duke pasur parasysh programin zbatues të përgatitur nga administrata me qëllim që të zbatohet masa, gjithnjë nëse ky program është i pajtueshëm me plotësimin e së drejtës. Mund t'i deklarojë pa vlerë aktet eventuale në shkelje ose eluzion të masës së mbetur e pa zbatuar.

Mund të emërojë edhe një komisar ad acta.

Kundër masës së nxjerrë gjatë respektimit pranohet gjithnjë apel në kasacion për shkelje të ligjit.

Procedimi i ankesë zhvillohet në dhomën e këshillit me garanci më të mëdha kundrejt formulimi të mëparshëm, duke qene e parashikuar skema e procedimit tipik të parashikuar për procedimin e mbikëqyrjes sipas neneve 666 e 678 kpp e administrata e interesuar, pasi njoftohet për datën e seancës, ka të drejtë të paraqitet ose të transmetojë vërejtje e kërkesa.

## **Ankimi tek gjykatësi mbikëqyrës (neni 69 paragrafi 6 o.p.)**

D.L. 23/12/2013 n. 146 konv. në L. 21/2/2014 n. 10 e ka zëvendësuar paragrafin 6 të nenit 69 O.p., duke përcaktuar se Gjykatësi Mbikëqyrës merret sipas nenit 35-bis me ankesat e të burgosurve e të internuarve lidhur me: a) kushtet e ushtrimit të pushtetit disiplinor, përbërjen e kompetencën e organit

disiplinor, kundërshtimin e fajeve dhe mundësinë e shfaqjesimit; në rastet sipas nenit 39, paragrafi 1, numri 4 e 5 (ose lidhur me sanksionin disiplinor të izolimit gjatë qëndrimit jashtë për jo më shumë se 10 ditë e të sanksionit disiplinor të përjashtimit nga aktivitetet e përbashkëta për jo më shumë se 15 ditë), vlerësohet edhe brendia e masave të adoptuara; b) mosrespektimin nga ana e administratës të dispozitave të parashikuara nga ky ligj e nga rregullorja përkatëse, nga i cili t'i vijë të burgosurit e të internuarit një dëm aktual e i rëndë në ushtrimin e të drejtave.

Saktësohet se neni 69 paragrafi 6 i ligjit 354/1975 ia njej gjykatësit mbikëqyrës të drejtën e ushtrimit vetëm të kontrollit të ligjshmërisë, e jo të brendisë, rreth ushtrimit të pushtetit disiplinor nga ana e autoriteteve titullare të veprimit disiplinor brenda burgjeve. Pasoja praktike e kompetencës lidhur vetëm me aspektin e ligjshmërisë është se në rast se ankesa bazohet tek aspektet e brendisë, të cilat janë të pahetueshme, gjykatësi do ta shpallë ankesën të papranueshme.

Përjashtohen rastet sipas nenit 39, paragrafi 1, numrat 4 e 5 (ose lidhur me sanksionin disiplinor të izolimit gjatë qëndrimit jashtë për jo më shumë se 10 ditë e të sanksionit disiplinor të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta për jo më shumë se 15 ditë) kundrejt të cilëve, në formulimin e ri të paragrafit 6 të nenit 69 O.p., siç është futur nga D.L. 23/12/2013 n. 146 konv. L. 21/2/2014 n. 10, gjykatësi mbikëqyrës mund të vlerësojë edhe brendinë e masave të adoptuara.

Duke iu referuar ligjeve në fjalë, jepen disa shembuj gjykimi të gjykatësit mbikëqyrës vetëm me aspekte ligjshmërie:

- » kushtet e ushtrimit të pushtetit disiplinor (p.sh. ankuesi e kupton dhënien e sanksionit disiplinor në lidhje me një fakt jo të parashikuar shprehimisht si shkelje e rregullores; ankuesi vëren mungesë motivimi të vendimit me të cilin është dhënë zbatimi i sanksionit ndaj tij);
- » krijimi i organit disiplinor (p.sh. përbërja e paligjshme e këshillit disiplinor, që duhet të përbëhet nga drejtori, që e kryeson, ose në rast pengese të këtij, nga nëpunësi me gradë më të lartë, një edukator e një mjek);
- » kompetenca e organit disiplinor (p.sh. sanksioni që është në kompetencën e këshillit disiplinor, por është dhënë nga drejtori);
- » njoftimi i fajeve (p.sh. mungesa e njoftimit në rastet e paligjshme që synohen të sanksionohen).
- » mundësia për t'u shfaqësuar (p.sh. në rastet kur cenohet e drejta e paraqitjes së shfaqësimeve).

I burgosuri mund t'i kërkojë Drejtorisë që të shikojë aktet e procedimit disiplinor në veçanti kopjen e raportit disiplinor e të procesverbalit të këshillit disiplinor (me omissis-et e rastit, duke iu referuar emrave e mbiemrave të operatorëve të burgut që kanë përpiluar raportin disiplinor e të anëtarëve të këshillit disiplinor). Kërkesa për t'i konsultuar aktet është e ligjshme nga fakti se i burgosuri është titullar i interesit juridikisht të rëndësishëm siç është ai i të burgosurit që synon të ankohet kundër masës disiplinore.

## **Ndreqje dëmshpërblyese pas shkeljes së nenit 3 të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të lirive themeltare ndaj personave të burgosur ose të internuar (neni 35 ter o.p.)**

D.L. 26/06/2014 n. 92 konv. në L. 11/08/2014 n. 117 ka përcaktuar se kur dëmi sipas nenit 69, paragrafi 6, shk. b) – ose ka të bëjë me mosrespektimin nga ana e administratës të dispozitave të parashikuara nga ky ligj (L. 354/75) e nga rregullorja përkatëse (DPR 230/2000), nga i cili t'i vijë të burgosurit ose të internuarit një dëm aktual e i rëndë në ushtrimin e të drejtave -, qëndron, për një periudhë kohore jo më të vogël se 15 ditë, në kushte burgimi të tilla sa të shkelin nenin 3 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e të lirive themelore (neni 3 i CEDU parashikon se asnjë nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese), e ratifikuar sipas ligjit 4 gusht 1955, n. 848, siç është interpretuar nga Gjykata europiane e të drejtave të njeriut, me kërkesë të paraqitur nga i burgosuri, personalisht ose me anë të avokatit mbrojtës të pajisur me prokurë të posaçme, gjykatësi mbikëqyrës vendos, si dëmshpërblim, një ulje të dënimit me heqje lirie akoma për t'u vuajtur baras, lidhur me kohëgjatësinë, me 1 ditë për çdo 10 gjatë të cilit kërkuesi ka besuar dëmin.

Kur periudha e dënimit akoma për t'u vuajtur është e tillë sa që nuk e mundëson uljen e tërë masës në përqindje sipas paragrafit 1, gjykatësi mbikëqyrës i likuidon gjithashtu kërkuesit, në lidhje me periudhën e mbetur e si dëmshpërblim, një shumë parash baras me 8,00 euro për çdo ditë gjatë të cilës ky ka pësuar dëmin. Gjykatësi mbikëqyrës vendos në të njëjtën mënyrë në rast se periudha e heqjes së lirisë e vuajtur në kushte jo në përputhje me kriteret sipas nenit 3 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e të lirive themelore të ketë qenë më pak se 15 ditë.

Ata që e kanë pësuar dëmin në gjendje paraburgimi që nuk mund të llogaritet në përcaktimin e dënimit për t'u vuajtur ose ata që kanë mbaruar së vuajturi dëminin e heqjes së lirisë në burg mund të propozojnë veprim, personalisht

ose nëpërmjet avokatit mbrojtës të pajisur me prokurë të posaçme, përballë gjykatës së kryeqendrës së qarkut në territorin e të cilit kanë rezidencën.

Veprimi duhet të propozohet brenda 6 muajve nga mbarimi i gjendjes së heqjes së lirisë ose e paraburgimit, përndryshe e humbet të drejtën. Gjykata vendos me përbërje monokratike sipas formave në bazë të nenit 737 e vijuese të kodit të procedurës civile. Dekreti që e përkufizon procedimin nuk mund të bëhet objekt ankimi. Dëmshtëpërblimi likuidohet në masën prej 8.00 eurosh për çdo ditë në të cilën i burgosuri ka pësuar dëm.

Ata që, në datën e hyrjes në fuqi të D.L. 26/06/2014 n. 92 konv. L. 11/08/2014 n. 117, kanë përfunduar së vuajturi dënimin me heqje lirie ose nuk janë më në gjendje paraburgimi, mund ta propozojnë veprimin sipas nenit 35-ter, paragrafi 3, i ligjit 26 korrik 1975, n. 354, brenda afatit të humbjes së të drejtës prej 6 muajsh që fillojnë nga e njëjta datë.

Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të D.L. 26/06/2014 n. 92 konv. L. 11/08/2014 n. 117, të burgosurit e të internuarit që kanë paraqitur prej kohësh apel Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut, nga pikëpamja e mosrespektimit të nenit 3 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e të lirisë themelore, e ratifikuar sipas ligjit 4 gusht 1955, n. 848, mund të paraqesin kërkesë sipas nenit 35-ter, ligjit 26 korrik 1975, n. 354, në rast se nuk është marrë vendim për pranimin e apelit nga ana e Gjykatës së lartpërmendur. Në këtë rast, kërkesa duhet të përmbajë, përndryshe nuk pranohet, datën e paraqitjes së apelit në Gjykatën europiane të të drejtave të njeriut. Kancelaria e gjykatës të cilit i është bërë apeli (rekursi) informon pa vonesë Ministrinë e punëve të jashtme për të gjitha kërkesat e paraqitura, brenda afatit prej 6 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të D.L. 26/06/2014 n. 92 konv. në L. 11/08/2014 n. 117.





## TË BURGOSURIT E HUAJ

Qytetarëve të shteteve që nuk bëjnë pjesë në Bashkimin Europian u zbatohet **D.L.v datë 25 korrik 1998 n. 286 e ndryshimet e mëpasshme.**

### I burgosuri i huaj pa lejeqëndrim

Quhet i huaj qytetari i një vendi që nuk bën pjesë në Bashkimin Europian. I burgosuri i huaj është pa lejeqëndrim kur:

- » ka hyrë në Itali duke shkelur ligjet për hyrjen në vend;
- » ka hyrë rregullisht, por më pas nuk e ka kërkuar përsëri lejeqëndrimin;
- » lejeqëndrimi i është hequr;
- » lejeqëndrimi nuk është ripërtërirë.

Për të huajin në burg ligji italian parashikon dëbimin që mund të ndodhë kur nxirret nga burgu ose kur duhet të vuajë një dënim përfundimtar jo më shumë se dy vjet (në këtë rast dëbimi vendoset nga gjykatësi mbikëqyrës e i burgosuri mund ta kundërshtojë brenda dhjetë ditëve nga vendimi). Dëbimi mund të ndodhë edhe në fund të paraburgimit.

Ligji n. 161 i 30 tetorit 2014 i ka ndryshuar, duke i ulur kundrejt normativës që ishte më parë në fuqi, afatet maksimale të mbajtjes pranë qendrave CIE duke përcaktuar se, para se dëbimi të kryhet efektivisht i huaji mund të mbahet për një periudhë maksimale prej 90 ditësh në një qendër identifikimi e dëbimi (CIE).

Para se dëbimi të zbatohet efektivisht i huaji mund të mbahet maksimumi për 18 muaj në një qendër për identifikimin e dëbimin (CIE).

Në këtë rast parashikohet një seancë përballë gjykatësit të paqes në prani të avokatit, i cili mund të kërkojë që mbajtja në qendër të mos vijojë e që mund ta kundërshtojë vendimin e dëbimit. Ligji parashikon që avokati të paguhet nga shteti, edhe kur është avokat i besuar.

Gjithnjë Ligji n. 161 i 30 tetorit 2014 ka përcaktuar se i huaji që është mbajtur prej kohësh pranë strukturave të burgut për një periudhë baras me nëntëdhjetë ditë mund të mbahet pranë qendrës për një kohë maksimale prej tridhjetë ditësh. Për të huajin që mbahet i burgosur për çfarëdo arsye, drejtoria e strukturës së burgut i kërkon kuestorit të vendit informacionet për identitetin e për kombësinë e tij. Në të njëjtat raste kuestori fillon procedurën e identifikimit duke interesuar autoritetet diplomatike kompetente.

Dëbimi mund të konsistojë edhe në një urdhër për të ikur nga Italia brenda shtatë ditëve e në qoftë se i huaji nuk largohet e kapet, parashikohet dënimi me gjobë.

Edhe kundër këtij vendimi të dëbimit mund të bëhet rekurs tek gjykatësi i paqes; gjithashtu në këtë rast ligji parashikon që avokati të paguhet nga shteti.

Ka raste kur i huaji pa lejeqëndrim nuk mund të dëbohet.

Këto raste janë:

- 1) në qoftë se në vendlindje personi mund të jetë objekt persekutimi për arsye të racës, gjinisë, gjushës, shtetësisë, fesë, mendimeve politike, gjendjes personale ose shoqërore;
- 2) në qoftë se personi është më pak se tetëmbëdhjetë vjeç;
- 3) në qoftë se personi bashkëjeton me të afërm italianë deri në shkallën e dytë ose me bashkëshort italian;
- 4) në qoftë se është i martuar me grua shtatzënë ose deri në gjashtë muaj nga lindja e fëmijës.

Në qoftë se i huaji gjendet në këto situata mund të kërkojë lejeqëndrim e ta kundërshtojë dëbimin.

Një rast tjetër kur i huaji mund ta marrë lejeqëndrimin është kur tregon se dëshiron t'u largohet kushtëzimeve të organizatave kriminale e për këtë arsye mund të kalojë rreziqe. Në këtë rast, normalisht me propozim të prokurorit, lëshohet një lejeqëndrim i vlefshëm për gjashtë muaj, që mund të ripërtërihet nëse i huaji ndjek programin e rifutjes të bashkërenduar më parë.

Edhe i huaji që ka kaluar një situatë shfrytëzimi të veçantë në punë mund ta marrë lejeqëndrimin me propozim të prokurorit ose me mendimin e tij të favorshëm.

Lejeqëndrimi i lëshohet – në fund të dënimit – edhe të huajit që ka vuajtur një dënim për një vepër të kryer kur ishte i mitur e që të ketë dhënë prova të pjesëmarrjes në programet e asistencës e integritit të bashkërenduar me edukatorët.

I huaji në paraburgim mund të marrë edhe masa shtrënguese jo me burg, si arrest në shtëpi, detyrim për qëndrim në një vend të caktuar ose paraqitja tek një post policie. Në këtë rast, nuk mund të dëbohet e mund të qëndrojë në Itali derisa të zgjasë masa shtrënguese.

I huaji në burg që vuan një dënim përfundimtar, në qoftë se ekzistojnë premiset e parashikuara me ligj, mund të kërkojë e të përfitojë uljen e dënimit me një masë alternative si qëndrimi në shtëpi ose vënia në provë tek shërbimi social. Edhe në këtë rast, i huaji nuk mund të dëbohet e mund të qëndrojë në Itali deri në çastin kur përfundon vuajtja e dënimit.

## I burgosuri i huaj me lejeqëndrim

Në qoftë se i huaji me lejeqëndrim arrestohet ose dënohet, nuk e humbet për këtë arsye automatikisht lejeqëndrimin.

Ligji parashikon që kuestori mund ta revokojë, ose ta refuzojë, ripërtëritjen e lejeqëndrimin, kur mendon se i huaji është i rrezikshëm. Pasoja e mëtejshme është dëbimi nga Italia.

I huaji i dënuar (edhe në rast kompromisi) për disa lloje veprash penale nuk mund ta përfitojë ripërtëritjen e lejeqëndrimin, përveç rasteve kur ka rrethana të tjera që duhen vlerësuar nga kuestura.

Neni 4 i Tekstit të Vetëm për imigracionin i radhit këto lloje veprash penale (midis të tjerave, veprat për lëndët narkotike, dhunë seksuale, shfrytëzim i prostitucionit, favorizimi i imigracionit klandestin). Edhe dënimi përfundimtar për vepra kundër të drejtës së autorit (për shembull: shitja e cd-ve të kopjuara ose të çantave ose veshjeve me marka të falsifikuara) shkakton humbjen e lejeqëndrimin.

Mund të bëhet rekurs kundër revokimit ose refuzimit të ripërtëritjes së lejeqëndrimin. Rekursi duhet paraqitur me anë të një avokati në gjykatën administrative krahinore.

Në qoftë se gjatë periudhës së burgut lejeqëndrimi skadon, është mirë që i burgosuri ta kërkojë ripërtëritjen. Shpesh kuesturat, duke zbatuar një qarkore të vjetër të Ministrisë së Brendshme, e refuzojnë ripërtëritjen, por është mirë gjithsesi të bëhet kërkesa.

## Lejeqëndrim për arsye të drejtësisë

Mund të jepet me kërkesë të autoritetit gjyqësor, kur prania e të huajit konsiderohet e domosdoshme për të kryer një proces për vepra të rënda penale. Është lejeqëndrim prej tre muajsh, por mund të shtyhet.

I huaji që gjendet jashtë shtetit e që dëshiron të hyjë në Itali për të marrë pjesë në një proces që po bëhet kundër tij, ose në të cilin ai është pjesë e lënduar, edhe pse është dëbuar, mund ta kërkojë autorizimin për t'u kthyer në Itali. Autorizimi është i kufizuar për kohën e procesit gjyqësor dhe jepet nga Kuestori i vendit ku bëhet procesi.

Verprimtaria kërkimore, përpunimi dhe përpilimi i tekstit nën kujdesin e  
Desi Bruno, Garant i personave që i nënshtrohen masave shtrënguese ose kufizuese  
të lirisë personale – Krahina Emilia-Romanja

Antonio Ianniello

Giulia Cella

Massimo Cipolla

Giulia Magri

Botimi e koordinimi i redaksisë

Cinzia Monari

Federica Grilli

Përkthimi

INTRAS Congressi Srl

Shtypja

Centro Stampa Regione Emilia-Romagna

Maj 2013

Nëntor 2013 - Ribotim updated

Nëntor 2016 - Ribotim updated

Asambleja Legjislative e Krahinës Emilia-Romanja

Shërbimi i Injtituteve të Garancisë

Garant i personave që i nënshtrohen masave shtrënguese ose kufizuese të lirisë  
personale

Viale Aldo Moro, 50 – 40127 Bologna

[www.assemblea.emr.it/garanti/attivita-e-servizi/detenuti](http://www.assemblea.emr.it/garanti/attivita-e-servizi/detenuti)